

2023




KOMUNA OBILIQ

OPSTINA OBILIQ

MUNICIPALITY OBILIQ

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT TË KOMUNËS DHE EKZEKUTIVIT KOMUNAL



Janar –Dhjetor 2022

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT TË KOMUNËS DHE EKZEKUTIVI KOMUNAL 2022

FJALA HYRËSE E KRYETARIT TË KOMUNËS

XHAFER GASHI

.....

Qytetarë të Obiliqit ,

Anëtar të Kuvendit ,

Si rezultat të punës dymbëdhjetë mujore të angazhimit maksimal në shërbim të qytetit dhe fshatrave , ju paraqes raportin vjetor për vitin 2022 para jush dhe Kuvendit Komunal .

Raport ky i projekteve dhe të arriturave dhe sfidave të cilat na presin së bashku ! Raport ky që së bashku hartuam buxhet , mbikëqyrëm së bashku dhe së bashku ju gëzuam investime

Ky raport pasqyron angazhimet tona të përbashkëta për aktivitetet , arritjet, sfidat dhe planet për të ardhmen e qytetit tonë.

Raporti vjetor i punë sonë është mjet i rëndësishëm për transparencën tonë të plotë dhe llogaridhënien para jush .

Viti që lamë pas ishte vit i vështirë për të gjithë ne , por së bashku me ju kemi arritur që të përmbushim obligimet karshi jush , duke qene së bashku kemi arritura të kalojmë të gjitha sfidat së bashku .

Vit ky që u prekum nga kriza globale e rritjeve të çmimeve dhe inflacionit , ishte viti më i rëndë pas pandemisë , kur ekonomia kosovare dhe shoqëria jonë u sfidua edhe me këtë sfidë, në qeverisje lokale dhe ajo nacionale jemi munduar të jemi të pran jush.

Ne me vendimet e marra jemi munduar që sa do pak të zbusim këtë krizë, që nga lindja, shkollimit , udhëtimi , transporti , subvencionet deri tek shërbimet mortore .

- *Viti 2022 ishte vit i sfidave dhe suksese tona të përbashkëta .
Ne raportimet tona me ju ne dy here brenda viti ju kemi informuar për punën dhe sfidat e përbashkëta*

Bazuar në Grantin e Performancës së Komunave të Kosovës

- *Komuna Obiliqi - vendi i IV-të , 2021/2022*
- *Komuna Obiliqi - vendi i III-të , 2022/2023*
- *Synimi ynë në vitin vijues të jemi vendi I-rë.*
-

Këto të arritura janë fal jush me kontributin e dhënë në dëgjimet buxhetor e takimet tjera , ku ju keni kryet obligimet qytetare duke bërë që buxheti ynë i planifikuar të rritet dhe të ketë tejkalime , puna e pa lodhshme e zyrtarëve komunal dhe ekipit mbështetës .

Trasfomimi i qyteti në zonë urban moderne .

Ka filluar projekti më madhore deri me tani “ Koogjenerimi –Shtrirja e rrjetit të Sistemi të ngrohjes qendrore në Obiliqi “

Plani Zhvillimor i Komunës së Obiliqi 2022-2030 – , Zgjerimi i Sheshit të Qytetit .Veqova këto tre aktivitete më madhore duke mos lënë anash edhe tjerat.

Kemi vazhduar me investimet kapitale ne infrastrukturë, arsim, shëndetësi , kulturë , rini sport etje .

Qyteti i Kulturës – ishte vit i aktivitetit të mëdha kulturore për qytetin dhe qytetarët .

Bashkëpunimi me Institucionet Qendrore , donatorët , e organizata tjera i vazhdueshëm .

Parteritet me USIAD , OSBE , DEMOS , Ambasadat ,Bankën Botërore ,BE-në .

Të nderuar anëtar të Kuvendit Komunal së bashku me ju kemi arritur që planin vjetor të punës ta realizojmë dhe buxhetin e planifikuar ta menagjojmë ne mënyrën me të mirë të mundëshem .Po ashtu ju kemi raportuar ne baza tre mujore për gjendje financiare dhe raportin vjetor .

Përmbledhje

Fjala e Kryetarit	2
Drejtoria e Administratës së Përgjithshme- DKRS –	4 15
DREJTORIA E ARSIMIT -	31
DSHMS -	47
Drejtoria e Inspektionit	72
DSHPE –	74
DMM –	82
DBZHR -	83
Drejtoria e Infrastrukturës Lokale –	85
DEFZH –	93
DPUPK –	101
Njësia e Burimeve Njerëzore –	160
Zyra ligjore -	165
Zyra për Integritet Evropian -	167

DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME

SEKTORI I ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME

Sektori i Administratës kryen të gjitha punët profesionale, juridike të Kuvendit dhe Komiteteve obligative dhe mbikëqyrë punët në QSHQ (Qendra e Shërbimit për Qytetarë).

Ky sektor përgatit të gjitha vendimet sipas kërkesës së Kryetarit të Komunës, prokurimit dhe njësive kërkuese, si dhe kthen përgjigje në të gjitha kërkesat e qytetarëve drejtuar Kryetarit dhe bordit të drejtorëve.

Po ashtu kemi bërë lëshimin e vërtetimeve për qëndrim në Kosovë për qytetarët e diasporës, kugjithsejanë lëshuar 48vërtetime.

KUVENDI KOMUNAL

Kuvendi Komunal ka mbajtur 12 seanca të rregullta ku gjatë këtyre seancave të mbajtura ka nxjerrë 74 vendime të miratuara dhe 7 rregullore. Rregulloret e aprovuara në këtë gjashtë mujor janë:

- 1. Rregullorja për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së bizneseve në Komunën e Obiliqit;*
- 2. Rregullorja për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Obiliqit.*
- 3. Rregullorja për Organizimin, Riorganizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës në administratën komunale të Obiliqit.*
- 4. Rregullorja për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale në Komunën e Obiliqit.*
- 5. Ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores për varreza, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre në Komunën e Obiliqit.*
- 6. Rregullorja për menaxhimi e mbeturinave në Komunën e Obiliqit.*
- 7. Plani tre vjeçar i banimit social.*

Nga këto rregullore, rregulloret me nr. rendor 4 dhe 5, janë kthyer në rishqyrtim.

Gjithashtu gjatë këtij gjashtë-mujori janë mbajtur 2 mbledhje solemne.

Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur 12 seanca;

Komiteti për Komunitete ka mbajtur 12 seanca;

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) ka mbajtur 6 mbledhje

DËGJIMET PUBLIKE

Sa i përket dëgjimeve publike të Komunës së Obiliqit, janë mbajtur 20 dëgjime publike, si më poshtë:

- Me datë 03.06.2022 është mbajtur dëgjimi buxhetor komunal për vitin 2023 -2025.
- Me datë 20.06.2022, është mbajtur takimi publik për Draft-Rregulloren për organizimin,riorganizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në administratën komunale të Obiliqit.
- Me datë 15.06.2022, është mbajtur debati publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2023-2025.
- Me datë 10.06.2022 është mbajtur debat me drejtorët e shkollave fillore dhe të mesme për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2023-2025.
- Me datë 06.05.2022 është mbajtur debati publik për Rregulloren për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunave me fshatrat vendbanimet dhe lagjet urbane.
- Me datë 28.05.2022 është mbajtur debati i thirrur nga Kryesuesja e KK me anëtarët e Kuvendit, Kryetarin, nënkryetarin, nënkryetarin për komunitete dhe ekzekutivin për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2023-2025.
- Me datë 29.05.2022 është mbajtur debat i thirrur nga Kryesuesja e KK me anëtarët e Kuvendit, Kryetarin, nënkryetarin, nënkryetarin për komunitete dhe ekzekutivin për Kornizën Afatmesme buxhetore 2023-2025.
- Me datë 23.03.2022 është mbajtur debati publik për Rregulloren për subvencionimin e energjisë elektrike dhe caktimin e kuotës më të ulët për çmimin e energjisë elektrike ne zonën e rrezikuar mjedisore ne Komunën e Obiliqit.
- Me datë 08.04.2022, është mbajtur debati publik për Rregulloren për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës se bizneseve në Komunën e Obiliqit.
- Me datë 13.05.2022 është mbajtur Debat Publik për Rregulloren për menaxhimin e mbeturinave.
- Me datë 02.07.2022 është mbajtur debat publik për Zgjerimin e sheshit të qytetit.
- Me datë 15.07.2022 është mbajtur debati publik për informimin e qytetarëve rreth gjashtë mujorit të parë të punës së ekzekutivit për vitin 2022.
- Me datë 17.08.2022 është mbajtur debati publik për planifikimin e buxhetit për vitin 2023 dhe parashikimet për vitin 2024-2025.
- Me datë 19.08.2022 është mbajtur debati publik për Draft-rregulloren për tarifa, ngarkesa dhe gjoba në Komunën e Obiliqit.
- Me datë 26.08.2022 është mbajtur debati publik për planifikimin e buxhetit për vitin 2023 dhe parashikimet për vitin 2024-2025.

- Me datë 10.10.2022 është mbajtur debati publik për Draft-rregulloren për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimi dhe mirëmbajtja e tyre.
- Me datë 21.10.2022 është mbajtur debati publik për vlerësimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera për territorin e Komunës së Obiliqit.
- Me datë 21.10.2022 është mbajtur debati publik për Projekt-Planin Komunal për Integritet 2023-2026.
- Me datë 31.10.2022, është mbajtur debati publik për Planin tre vjeçar të banimit social.
- Me datë 28.12.2022 është mbajtur debati publik për informimin e qytetarëve rreth gjashtë mujorit të dytë të punës së ekzekutivit për vitin 2022.

Gjatë periudhës raportuese kemi pasur 25kërkesa për qasje në dokumentet publike zyrtare, të gjitha tëaprovuara.

Gjithashtu në kuadër të Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme bëhet edhe përkthimi shqip-serbisht dhe anasjelltas i të gjitha materialeve për KK dhe komitetetobligative,rregulloreve, vendimeve dhe materialeve tjera sipas kërkesave të drejtorive.

ARKIVA

Zyra e arkivës (shkrimorja) e komunës mbahet në mënyrë elektronike-manuale, ku gjatë kësaj periudhe 1 vjeçare ka proceduar **10,084 lëndë**.

Zyrtari për saktësime i ka proceduar11saktësime, nga posta janë pranuar 644 lëndë të cilat janë shpërndarë nëpër Drejtoritë përkatëse, ndërsa janë dorëzuar 293 lëndë në institucionet e jashtme.

QENDRA E SHËRBIMEVE PËR QYTETARËT

Sa i përket QSHQ (Qendra e shërbimit për qytetarët), janë kryer punët e përditshme në pranidorëzimin e kërkesave të qytetarëve, dhënia e informacioneve qytetarëve, ndihma dhe këshillat e nevojshme për realizimin e kërkesave dhe ankesave të tyre.

Këto punë (lëndë) kryhen përmes intranetit dhe librave përkatëse,kupër periudhën raportuese paraqesim statistikat sipas programit, si më poshtë:

- pranuar–**27** lëndë;
- në proces-**298** lëndë;

- të miratuara–**14,755** lëndë;
- të refuzuara–**1,008** lëndë;
- të hedhura poshtë – **32** lëndë;
- të pezulluara – **51** lëndë;
- të ceduara -**9**lëndë;
- të anuluarat-**174** lëndë;
- të përfunduara–**21,217** lëndë;
- Gjithsej –**37,571 lëndë.**

Sa i përket sistemit Intranet, afati për shqyrtimin e kërkesave është 30 ditë, mirëpo meqenëse drejtoritë përkatëse në Komunën e Obiliqit, çdo vit ndajnë subvencione të natyrave të ndryshme, është e pamundur që të gjitha kërkesat të shqyrtohen brenda afatit të sistemit. Kjo vjen si pasojë e faktit se kërkesat grumbullohen deri në përfundim të afatit për aplikim, dhe pas mbylljes së afatit fillon shqyrtimi i tyre.

Zakonisht, kërkesat e shqyrtuara jashtë afatit, janë të Drejtorisë së Arsimit, Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, dhe të gjitha drejtorive të tjera që ndajnë subvencione për qytetarët e Komunës së Obiliqit.

Meqenëse, në bazë të ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, afati për shqyrtimin e kërkesave është 45 ditë, afati në sistemin e intranetit është vetëm 30 ditë, gjë e cila është në kundërshtim me ligjin dhe këtë problem e kemi ngritur disa herë pranë Ministrisë përkatëse.

OFIQARIA

Në zyrën e Ofiqarisë gjatë periudhës janar-dhjetor/2022, janë kryer të gjitha detyrat sipas përgjegjësive të nëpunësve civil dhe ligjeve në fuqi, ku gjithsej janë dorëzuar:

Ekstrakt të lindjes	14,456
Certifikata të lindjes	6,018
Certifikata të martesës	3,654
Certifikata të vdekjes	927
Certifikata të vendbanimit	538
Certifikata të bashkësisë familjare	2,927
Certifikata të gjendjes martesore	522
Certifikata të shtetësisë	191
Vërtetim nga arkiva	183

Gjithsej

29,416

Numri i qytetarëve që kanë kaluar në regjistrin qendror

266

LOGJISTIKA

Nga zyrtarja e logjistikës në Drejtorinë e Administratës, janë realizuar Hyrje-Dalje nga depoja për administratën komunale, institucionet arsimore si dhe institucionet shëndetësore. Po ashtu janë realizuar kërkesat për material administrativ hyrje-dalje në sistemin E-pasurisë gjithashtu edhe hyrjet në thesar, për të gjitha lëndët e prokurimit.

Gjithsej lëndë për SFMK gjatë kësaj periudhe, kanë qenë 296 lëndë.

TEKNOLOGJIA INFORMATIVE (IT)

Në sektorin e IT-së gjatë kësaj periudhe janë bërë 55 formatizime dhe janë bërë intervenime tek Drejtoritë Komunale sipas kërkesave. Gjithashtu është punuar edhe në institucionet shëndetësore dhe arsimore të Komunës së Obiliqit.

Sa i përket Institucioneve arsimore, janë bërë shumë punë tjera duke përfshirë krijimin e profileve në SIMBNJ, 45 kyçje në sistem dhe 130 qasje në HRM SYSTEM .

Nga lëmi i servisimit të pajisjeve të IT janë servisuar shumë pajisje, si pasojë e problemeve me rrymë gjë e cila ka shkaktuar dëme në pajisje të IT-së. Janë djegur 13 PowerSuply (pajisje të furnizimit me rrymë) dhe janë përforcuar 25 kompjuterë me ram memorie pasi që na është dashur të kalojmë nga sistemet e vjetruara në të avancuara.

Janë bërë incizimet e mbledhjeve të kuvendit si dhe transmetimi drejtpërdrejtë me teleprezencë në MAPL dhe është bërë edhe kyçja në CMS.

Në web faqen zyrtare të Komunës së Obiliqit është bërë postimi i Rregulloreve të cilat nuk kanë qenë të postuara. Gjithashtu në CMS është bërë dizajnimi i ballinës dhe shumë ndryshime si në CMS (Content Management System) ashtu edhe në CSS .

Zyra e IT-së ka qenë e angazhuar me punë edhe jashtë orarit, për të gjitha organizimet që ka pasur Komuna e Obiliqit, duke menaxhuar zërimin. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe, zyrtari i IT-

së, ka qenë i angazhuar në komisionin për vlerësimin e dëmeve në Drejtorinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Zyrtari i IT-së, ka qenë i angazhuar edhe në menaxhim të disa kontratave : kamerat e qytetit, kamerat në shkollë , zërimi në xhami, Menaxhimi i Radhës ,zërimi në sallën e Kuvendit Komunal .

Vlen të ceket se si pasojë e problemeve me energji elektrike është djegur serveri Dell PowerEdge 2950 dhe tani është kthyer në sistem, mirëpo rryma po shkakton shumë probleme dhe po kemi pengesa edhe në punët e përditshme pasi që vazhdimisht po ka prishje tëPowerSuply.

Aplikacionet komunale në të cilën bëhet administrimi i tyre nga zyrtari i IT-së janë:

1. Intraneti;
2. E-arkiva;
3. E-pasuria;
4. Simbnj;
5. SMVP;
6. Domeininmun.gov.irk.rks;
7. CMS;
8. Free BalanceWeb Aplikacion;
9. Sistemin e MPB për riadhesim;
10. Softwerin për Përkthim donacion nga USAID;
11. Menaxhimin e të dhënave personale i caktuar nga ASHMDHP (MPB) gjithsej 12 raste;
12. Menaxhimin e softuerit për Hapjen dhe caktimin e orarit të dyerve për hyrje dhe dalje;
13. Mbrojtja e të Dhënave Personale dhe Konsultimi me Agjencionin për Mbrojtjen e të dhënave personale për qasje në të dhënat e kërkuara nga Organizatat dhe shoqëria civile.

Ndërsa në QKMF është bërë menaxhimi i SISH Aplikacionit, e në Arsim aplikacioni E-Shkollë në të cilin është duke u bërë analiza për fillimin dhe implementimin nga MASHT.

Në kemi marrë pjesë në fazën e testimeve dhe kemi qenë në shkollat ku është bërë testimi.

NJËSIA PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Kjo njësi ka pasur aktivitete të ndryshme gjatëkëtij viti, të cilat janë të shtjelluara mëgjerësisht mëposhtë:

Gjatë muajit Janar kemi pasur këto aktivitete:

Pjesëmarrja në takim online me temën “Fuqizimi ekonomik i gruas”organizuar nga UNËOMEN Mbledhja e të dhënave në raportin gjinor për vitin 2021.

Trajtimi i një rasti nga radhët e komunitetit romë ,rasti në fjalëkërkon ndihme dhe asistencë tek zyrat e KEC.

Raportimi vjetor tek Agjensioni për Barazi Gjinore zyra e kryeministrit (për vitin 2021).

Raport vjetor tek Divizioni për të Drejtat e Njeriut MAPL

Përgatitje për implementimin e projektit të Programit për të Drejtat Civile në Kosovë (CRP/K,Ngritja e kapaciteteve të autoriteteve lokale dhe pjesëtarëve të komuniteteve pakicë për të identifikuar, raportuar dhe trajtuar praktikak diskriminuese në Kosovë”.

*Ky grant është mundësuar nga ‘Programi i shoqërisë civile për Shqipërinë dhe Kosovën’, financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) në partneritet me Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim (PA).**

Pjesëmarrja në trajnim ditor “shëndeti mendor” organizuar nga Shtëpia e Shpresës

Në bashkëpunim me Drejtorinë e Administratës dhe të shëndetësisë kemi realizuar një vizitë punenë Strehimore, ku u njoftuam me stafin,nevojat dhe planet në të ardhmen për sigurimin e shërbimeve kualitative për viktimat gradhe viktimat e dhunës në familje.

Pjesëmarrja në takimin për themelimin e komitetit për komunitete me komunitetin Rom.

Pjesëmarrja në takimin për themelimin e komitetit për komunitete me komunitetin Ashkali.

Pjesëmarrja në takimin për themelimin e komitetit për komunitete me komunitetin Serb.

Pjesëmarrja në takimin për themelimin e komitetit për komunitete me komunitetin Boshnjak.

Pjesëmarrja në takimin për themelimin e komitetit për komunitete me komunitetin Egjiptas.

Pjesëmarrja në takim Online me ABGJ,koordinimii aktiviteteve për 8 mars në nivel lokal.

Gjatë muajit Shkurt, kemi mbajtur këto aktivitete:

Në komunën tonë u mbajtë punëtorja e parë me titullin “Ngritja e kapaciteteve të autoriteteve lokale dhe pjesëtarëve të komuniteteve pakicë për të identifikuar,raportuar dhe trajtuar praktikak diskriminuese në Kosovë”, i organizuar nga njëprogram për të drejtat Civile në Kosovë.

Pjesëmarrjaonline në konferencën e nivelit të lartë me temë “Përmirësimi qasjes së të mbijetuarave të dhunës me bazë gjinore (DHBGJ) në nisma për banim social dhe fuqizim ekonomik”,organizuar nga OSCE.

Takim me një grup të komunitetit rom në Plemetin, për nevojat dhe prioritetet e tyre.

Takim me drejtoreshën e organizatës “Islamic Relief”, ku takimi kishte për qëllim ndihmë nënave vetushqyese.

Takim me përfaqësues të OSCE-së,takimi kishte për qëllim bashkërendimin për aktivitetet tona të përbashkëta për vitin 2022.

Pjesëmarrja në takim online me të gjitha zyrtaret për barazi gjinore ,organizuar nga ABGJ.

Trajtimi i një rasti nga komuniteti rom,i cili ka kërkuar ndihmë për rregullimin e dokumentacionit për social.

Takim me Qendrën Rinore lidhur me aksionin me rastin e 8 Marsit.

Pjesëmarrja në takim online me të gjitha zyrtaret për barazi gjinore ,organizuar nga ABGJ.

Pjesëmarrja në dhurimin e donacionit nga drejtoria e Shëndetsisë për Qendrën për Mbrojten e grave dhe Fëmijëve në Prishtinë .

Takim me përfaqësues të OSCE-së lidhur me koordinimin e aktiviteteve për muajin Mars.

Pjesëmarrja në komisionin për persona të riatdhesuar.

Gjatë muajit Mars janë mbajtur aktivitetet si më poshtë:

Takim me drejtoreshën e Strehimores lidhur me aktivitetin me rastin e muajit mars- muaji i gruas.

Shënimi i 8 marsit- ditës ndërkombëtare të Gruas.

U mbajt punëtorja “Ndikimi i pandemisë në dhunën në familje”.

Marshojmë kundër vrasjes së grave!

Simbolika e këpucëve të kuqe të vendosura në qendër të Obiliqit!

Gjatë muajit prill u mbajtën aktivitetet si më poshtë:

Monitorimi i regjistrimit për komunitetin Rom, Ashkali dhe Egjiptas.

Takim me një grup grash , aktiviste për humanizëm në komunën tonë.

Takim me përfaqësuesit të OJQ të grave Mimfa.

Takim me përfaqësues të OSCE-së.

Gjatë muajit Maj, aktivitetet që janë mbajtur janë këto:

Takim me anëtarët e me kanizmit koordinues kundër dhunës në familje.

Kryetari i komunës Xhafer Gashi, së bashku me njësinë në fjalë, ka pritur përfaqësues të OJQ “ReplayPeace”, duke u bashku në organizmin e minimaratonës “Vrapo për Autizëm”.

Përpos që komuna ka kontribuar në marrjen e numrave, ka ndarë edhe buxhet për këtë aktivitet.

Gjatë muajit Qershor, aktivitetet që janë mbajtur janë këto:

U mbajt punëtori dy ditore në Prevallë me temën “Buxhetimi përgjegjshëm gjinor në nivel local” ku komuna jonë ishte në mesin e 6 komunave model për raportin e buxhetimit gjinor.

Takim me Grupin e grave.

Gjatë muajit Korrik, aktivitetet që janë mbajtur janë këto:

Takim me OJQ- RUKA RUCI, takim ky i cili ka për qëllim organizimin e fushatës me gratë-Gratë në vendimarrje.

Takim me përfaqësues të OSCE-së, lidhur me hartimin e PLV, për mekanizmin koordinues kundër dhunës në familje.

Takim me kryesuesin e komitetit për komunitete, për bashkëpunim mes komunës dhe minoriteteve.

Takim në bashkëpunim me Qendrën për të Drejtat e Grave-Drenas dhe Shoqatën drejtësi për të gjithë, kemi organizuar tryezë me temën “Hulumtimi, dokumentimi dhe identifikimi i rasteve që kanë përjetuar dhunë seksuale gjatë luftës kanë nevojë për më shumë përkrahje shoqërore, institucionale (ky projekt do të vazhdoj takimet me gratë e viseve rurale, me gratë në biznes dhe me rininë e komunës sonë).

U mbajt trajnimi për Procedurat Standarde të Veprimit për mbrojtje nga Dhuna në Familje. Kjo punëtori u realizua me kërkesë të njësisë në fjalë, në bashkëpunim me Agjensionin për Barazi Gjinore mbështetur nga ZKM.

Gjatë muajit Gusht, aktivitetet që janë mbajtur janë këto:

Në kuadër të projektit rritja të autoriteteve lokale dhe të pjesëtarëve të komuniteteve pakicë, është mbajtur sesioni informues në fshatin Plemetin, për rolin dhe rëndësinë e trajtimit të barabartë në shoqëri.

Gjatë muajit Shtator, aktivitetet që janë mbajtur janë këto:

Pjesëmarrja në punëtorinë dy ditore me të gjitha zyrtaret për barazi gjinore të komunave të tjera, me temën “Barazia Gjinore në shoqërinë tonë”

Gjatë muajit Tetor, aktivitetet që janë mbajtur janë këto:

Në kuadër të projektit rritja e kapaciteteve të autoriteteve lokale dhe pjesëtarëve të komuniteteve pakicë për të identifikuar, raportuar dhe trajtuar praktikën Diskriminuese është mbajtur puntëori me përfaqësues të ZKM, ABGJ, Avokati i popullit .

Në bashkëpunim me drejtorinë e shëndetësisë është hap fushata kundër kancerit të gjirit me moton “Zbulimi i hershëm, shpëton jetë”.

Në bashkëpunim me Qendrën për Mbrojtjen e grave dhe Fëmijëve dhe me akterët e mekanizmit koordinues kundër dhunës në familje është mbajtur tryezë diskutimi i draftit “Protokolli Shtetëror për Trajtimin e Rasteve Kundër Dhunës Seksuale”

Në bashkëpunim me Grupin e Grave kemi zhvilluar një vizitë në Qendrën për Promovimin e të Drejtave të Grave në Drenas.

Takim me përfaqësues të KFOR-it zviceran, qëllimi i takimit ishte barazia gjinore në komunën e Obiliqit.

Takim me përfaqësues të UNMIK-ut, qëllimi i takimit ishte bashkëpunimi mes ZBGJ dhe UNMIK-ut , me rastin e fushatës “16 ditët e aktivizimit”.

Gjatë muajit Nëntor, aktivitetet që janë mbajtur janë këto:

U mbajtë takimi i parë i Këshillit komunal për Persona me Aftësi të Kufizuara.

Në bashkëpunim me organizatën ‘RUKA RUCI’ është organizuar punëtori me gratë asambleiste, gra të viseve rurale me temën “Forcimi i Pjesëmarrjes së Grave në Politikë”.

Pjesëmarrja në punëtorinë me temën “Ndihma Juridike Falas për Gratë”

Pjesëmarrja në takimin e rregullt të organizuar nga ABGJ.

Pjesëmarrja në konferencën “Rrjeti i sigurisë së Grave” e organizuar nga OSCE-ja.

Hapja e fushatës 16 ditët e aktivizimit në komunën tonë u shënuan me këto aktivitete:

Hapja e fushatës “ vënia e kordeles së bardhë në administratën komunale”.

Organizimi i tryezës në bashkëpunim me qendrën kosovare për studime të sigurisë me temën “Gjinia, Paqja dhe Siguria”

Takim me gra të viseve rurale “Si të fillojmë një Agrobiznes”


Shfaqja e filmit kundër martesave të hershme.

Përmbyllja e fushatës me lansimi e kalendarit për vitin 2023 , me motive kundër dhunës në familje, dhe shënimi i datave të rëndësishme.

Zyra jonë ka marrë pjesë në të gjitha seancat e Kuvendit Komuna dhe Komiteteve të Komunës së Obiliqit.

Gjithashtu gjatë kësaj periudhe kemi pasur një rast të dhunës në familje të cilin e kemi trajtuar.

DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT



PËRMBLEDHJE

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e Komunës së Obiliqit, gjatë periudhës njëvjeçaretë punës (janar-dhjetor 2022), ka përfunduar aktivitetet të planifikuara në kuadër të Planit vjetori të Punës për vitin 2022, bazuar në kompetencat, objektivat dhe synimet e përgjithshme të drejtorisë duke udhëhequr me resurset (burimet) lokale kulturore, sportive e rinore të komunës së Obiliqit.

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e Komunës së Obiliqit, e përbërë prej sektoreve: Kulturë, Rini dhe Sport dhe ai i Bibliotekës, me një buxhet të planifikuar për vitin 2022, ka realizuar aktivitete e projekte në kuadër të këtyre tri sektoreve.

Aktivitetet e realizuara nga Drejtoria e Kulturë, Rinisë dhe Sportit, janë të bazuara në objektivat e përgjithshme të drejtorisë dhe në misionin e saj për zhvillimin e aktiviteteve kulturor-artistike, sportive, rinore, fuqizimin e rinisë dhe pjesëmarrjen e saj në aktivitete, ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe artitektonike, shënimin e datave të rëndësishme historike, respektimin dhe

nderimin e vlerave të luftës çlirimtare, promovimin e identitetit të komunës dhe përkrahjen e sportistëve e të rinjve.

Personeli i DKRS-së, ka bërë përpjekje maksimale në kuadër të kompetencave të drejtorisë, duke përmbushur planin e punës, qëllimet dhe objektivat për vitin 2022. Bashkëpunimi me OJQ-të, strukturat e nivelit lokal, institucionet kulturës dhe artit të nivelit qendror, ka qenë konstruktiv dhe ka rezultuar me sukses në disa prej aktiviteteve të realizuara gjatë kësaj periudhe.

Në këtë raport njëvjeçar (janar-dhjetor) të punës janë të përfshira aktivitetet e zhvilluara në drejtori, duke përfshirë aktivitetet e projektet në fushën e kulturës, trashëgimisë kulturore e historike, sportit dhe rinisë.

Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport konsideron se ka arritur me sukses realizimin e objektivave të planifikuara gjatë vitit, duke realizuar mbi pesëdhjetë e pesë (55) aktivitete gjatë vitit 2022.

Aktivitetet e DKRS-së në periudhën raportuese Janar-Dhjetor 2022:

➤ ***Përgaditja dhe hartimi i Planit të Punës së Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport për vitin 2022***

Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport duke u bazuar në synimet dhe objektivat e përgjithshme, ka hartuar një Plan të pasuruar të Punës për vitin 2022, duke planifikuar një sërë aktivitesh kulturore, artistike, sportive e rinore, të cilat janë realizuar në bashkëpunim me OJQ-të e komunës së Obiliqit.

➤ ***Formimi i Këshillit Organizativ për organizimin e të gjitha aktiviteteve të planifikuara sipas Planit të Punës së DKRS-së për vitin 2022***

Me vendim të Kryetarit të Komunës, është formuar Këshilli Organizativ për organizimin e të gjitha aktiviteteve të planifikuara sipas Planit të Punës së DKRS-së për vitin 2022, me qëllim të bashkërendimit, koordinimit të mirëfilltë në realizimin sa më të suksesshëm të aktiviteteve.

➤ ***Kontrollimi i raporteve të projekteve të subvencionuara nga DKRS-ja nga viti paraprak:*** Zyrtarët e DKRS-së, kanë pranuar raportet financiare dhe narrative të ojq-ve kulturore, sportive e rinore që kanë qënë përfituese nga thirrjet publike për subvencionim gjatë vitit 2021.

➤ ***Në bashkëpunim me Drejtorinë e Infrastrukturës Lokale, DKRS-ja ka hartuar projektet kapitale lidhur me investimet e nevojshme në fushën e Kulturës, Trashëgimisë, Sportit dhe Rinisë.***

- Në fushën e trashëgimisë kulturore dhe arkitektonike, është realizuar **projekti “Rikonstruktimi i krojeve në fshatin Shipitullë”**, vlera totale e projektit: 30,328.20€, projekti është realizuar sipas planit dinamik të paraprë.
- Në fushën e sportit, është realizuar projekti në bashkëpunim me Drejtorinë për Mbrojtje dhe Mjedis, ku është bërë rregullimi i dy fushave sportive: Fusha sportive tek parku në Llazarevë, vlera e projektit: 22,735.45€ dhe fusha sportive tek parku në rrugën “Mbretresha Teutë”, vlera e projektit: 43,091.38€

➤ ***Përgaditja e planit të prokurimit për projektet kapitale.***

➤ ***Përgaditja e projekteve në kategorinë Mallra dhe shërbime***

- DKRS-ja, gjatë vitit 2022 ka patur të planifikuara 51,789.00€ , të cilat i ka shpenzuar në total për realizimin e projekteve për nevojat e institucionit.

➤ ***Shpallja e Thirrjes Publike për subvencionim nga DKRS-ja për vitin 2022***

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, në kuadër të kategorisë së subvencionimit, për vitin 2022 ka planifikuar vlerën prej 45 mijë euro, ku ë përmes dy thirrjeve publike (Thirrja e I:

XIV-35 me datë 17.03.2022 dhe Thirrja e II:XIV-103 me datë 10.06.2022), ka ofruar mbështetje financiare të gjitha organizatave jo-qeveritare kulturore, sportive, rinore si dhe individëve të regjistruar në Republikën e Kosovës, që veprojnë në komunën e Obiliqit, programi i të cilave është i fokusuar në ruajtjen e traditës kulturore, fuqizimin dhe avancimin e të rinjëve dhe sportit.

➤ ***Organizimi i takimeve me OJQ-të, klubet sportive e shoqatat kulturore si dhe vizita e klubeve sportive, ojq-të rinore dhe kulturore***

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, përveç takimeve të vazhdueshme me palë, me qëllim të koordinimit të vazhdueshëm në realizimin e aktiviteteve të shumta sportive, rinore e kulturore, ka organizuar takime me OJQ-të, klubet sportive e shoqatat kulturore që veprojnë në komunën e Obiliqit (tri takime gjatë vitit), si dhe përt'u njoftuar nga afër me sfidat, vështirësitë por edhe të arriturat e tyre Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka realizuar vizita në teren në klubet sportive, ojq-të rinore dhe kulturore.

➤ ***Shënimi i 14- vjetorit të Pavarësisë së Republikës së Kosovës***

Për nder të 17 Shkurtit- Ditës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës, nën përkujdesjen e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport është shënuar kjo datë me një sërë aktivitete:

- Ceremonia e homazheve pranë Pllakës Përkujtimore të Dëshmoreve të Kombit në Sheshin e qytetit të Obiliqit.
- Ceremonia e homazheve në Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz.
- Fluturimi i paragllajdistëve “Shqiponjat e Kastriotit” mbi qiellin e qytetit të Obiliqit.
- Mbajtja e manifestimit kulturoro-artistik në Shtëpinë e Kulturës “Xhavit Haziri”, ky program i pasur kulturor u realizua në bashkëpunim me nxënësit e Gjimnazit “17 Shkurti”, nën tingujt e këngeve dhe valleve nga AKV “Qyteti i Obiliqit” dhe të rinjtë nga Qendra Rinore.
- Nën patronatin e Kryetarit të Komunës së Obiliqit, Xhafer Gashi, nën përkujdesjen e DKRS-së, është organizuar takimi me akterë të ndryshëm që ndër vite kontribuan në

jetën teatrale në Komunën e Obiliqit, qoftë aktorë, regjisorë, punonjës tjerë të kësaj fushe, ku për të gjithë këta kontributdhënës u ndan mirënjohje nga komuna e Obiliqit.

➤ ***Shënimi i 8 Marsit - Ditës Ndërkombëtare të Gruas***

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport ka shënuar 8 Marsin – Ditën Ndërkombëtare të Gruas më aktivitete të shumta duke përcjellur mesazhe të fuqishme për gratë;

- Realizimi i aktivitetit "Këpucët e kuqe" - me iniciativë nga Rrjeti i Grave të Kosovës, organizuar nga DKRS-ja dhe Qendra Rinore, ku në amfiteatrin e Sheshit të qytetit "Dëshmoret e Kombit" janë vendosur 48 këpucë të kuqe që simbolizojnë 48 gra të vrara nga dhuna në familje. Ky aktivitet sensibilizues dha mesazhin e qartë, se gratë e komunës së Obiliqit, kundërshtojnë çdo dhunë që cenon dinjitetin e gruas e deri marrjen e jetës.
- Forum-teater, i veprës "Jam unë ajo" – Drejtoria e Kulturës, në bashkëpunim me dramaturget znj.Valmire Thaqi dhe znj.Diturie Neziraj, kanë realizuar forum-teatrin e veprës "Jam unë ajo", duke trajtuar një temë mjaft të ndjeshme, shumë pak të diskutuar në shoqërinë tonë, temën e depresionit pasnatal (paslindjes) tek gratë. Pas dhënies së shfaqjes teatrale, është realizuar diskutimi i hapur ku zonjat e pranishme kanë prezantuar përvojat e tyre jetësore në gjendjen pasnatale.

➤ ***Garat Komunale në Hendboll***

Në kuadër të kalendarit të garave sportive, DKRS-ja në bashkëpunim me DKA-në dhe Shoqatën e Pedagoqeve, kanë organizuar garat komunale në Hendboll, nën pjesëmarrjen e 5 ekipeve, ku fituese të kësaj gare dolën: Gjimnazi "17 Shkurti" dhe SHFMU "Dr.Ibrahim Rugova" me ekipin e vajzave dhe djemëve. Fituesit e këtyre gara kanë përfaqësuar komunën e Obiliqit në garat regjionale, ku kanë arritur rezultate maksimale duke u renditur në vendet e para.

➤ ***Shënimi i 6 Prillit- Dita Ndërkombëtare e sportit për zhvillim dhe paqe***

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në bashkëpunim me Komitetin Olimpik të Kosovës, ka shënuar 6 Prillin- Ditën Ndërkombëtare të sportit për zhvillim dhe paqe, kjo datë u realizua

nga klubet e sporteve të komunës së Obiliqit duke praktikuar sportet si; basketboll, karate, paragllajd, kickboks,etj.

➤ ***Dita e Filmit për Fëmijët***

Në Shtëpinë e Kulturës “Xhavit Haziri”, në bashkëpunim me Supervullnetaret “Fenerat e Ndrirshëm” është organizuar Dita e Filmit për Fëmijët, në dy termine me grupmoshat nga klasa e parë (I) deri në klasën e nëntë (IX). Kjo ditë e filmit u shënuar me 17 prill 2022.

➤ ***Maratona “Knowand address antigypsism”***

Drejtorja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në bashkëpunim me organizatën Teach For Kosova dhe VoRAE, kanë realizuar maratonën “Knowand address antigypsism”, mesazhi i kësaj maratone ishte sensibilizues për luftimin e pabarazive sociale dhe përkrahjen e komuniteteve jo-shumicë. Kjo maratonë u mbajt me 22 prill 2022.

➤ ***Shënimi i 5 Majit- Dita e Dëshmorëve të Kombit***

- Ceremonia e homazheve në nderim të Dëshmorëve të Kombit- Shënimi i 5 Majit “Dita e Dëshmorëve të Kombit” , pranë Pllakës Përkujtimore të Dëshmorëve në Sheshin e Qytetit “Dëshmoret e Kombit”.
- Nën patronatin e Kryetarit të Komunës së Obiliqit, Xhafer Gashi dhe nën përkujdesjen e Drejtorisë për Kulturë,Rini dhe Sport, është shënuar 5 Maji- “Dita e Dëshmorëve të Kombit” përmes një akademie përkujtimore e cila u përcoll më monolog nga nxënësja e Gjimnazit “17 Shkurti” Drilona Dedinca, deklamim poezish nga Teatri i Qytetit dhe valle e këngë nga AKV “Qyteti i Obiliqit”.

➤ ***Panairi i Shkencës***

Në Shtëpinë e Kulturës “Xhavit Haziri” është mbajtur Panairi i Shkencës, projekt i përkrahur nga Caritasi Zvicëran në kuadër të projektit INTERK. Në këtë Panair u zhvilluan eksperimente dhe aktivitete të tjera shkencore, edukative dhe argëtuese, ku pjesëmarrësve iu ofruan mundësitë e shkëmbimit të përvojave me njëri-tjetrin dhe u theksua rëndësia e orëve praktike në lëndët shkencore. Ky Panair u mbajt me 20 maj 2022.

➤ ***Festivali i Tenisit- “Tennis Festival”***

Në mesin e komunave të Kosovës, Federata e Tenisit të Kosovës (FTK) ka organizuar festivalin e Tenisit, nën pjesëmarrjen e 200 nxënësëve të grupmoshave nga 5 vjeç deri në 8 vjeç. Qëllimi i këtij festivali ishte masovizimi i sportit të tenisit si dhe identifikimi i talentëve të rinjë në këtë fushë. Ky festival u mbajt me 30 maj 2022.

➤ ***Diversiteti përmes Artit***

Në Shtëpinë e Kulturës “Xhavit Haziri” është shënuar aktiviteti “Diversiteti përmes Artit”, projekt i përkrahur nga Caritasi Zvicëran në kuadër të projektit INTERK. Në këtë aktivitet ishin pjesëmarrës 80 fëmijë dhe të rinjë nga shkollat e ndryshme dhe përmes këtij projekti është synuar përfshirja dhe ofrimi i barbartë i mundësive për pjesëmarrje dhe shprehje të ideve përmes diversitetit në art, muzik, letërsi dhe shkrim. Ky aktivitet u zhvillua me 27 maj 2022.

➤ ***Shënimi i 1 Qershorit – Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve***

Drejtoria për Kulturë, Rinë dhe Sport në bashkëpunim me Drejtorinë Komunale të Arsimit dhe Qendrën Rinore, u përkujdesen për shënimin e 1 Qershorit –Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve nën moton “Fëmijë të lumtur, prindërim i suksesshëm, shoqëri e realizuar” , duke përcjellur me aktivitete të shumta, fillimisht me këngë, lojëra e argëtim në Amfiteatrin e Sheshitte Qytetit “Dëshmorët e Kombit”, për të vazhduar në Shtëpinë e Kulturës “Xhavit Haziri” ku fëmijët kanë përcjellur film vizatimor.

➤ ***Takimi informues për projektin “Pjesëmarrja e të Rinjve të Kosovës -Kosovo Youth Participation” – KYP***

Në sallën e Kuvendit Komunal të Obiliqit, është mbajtur takimi informues për të rinjtë e Komunës së Obiliqit në lidhje me projektin “Pjesëmarrja e të Rinjve të Kosovës-Kosovo Youth Participation KYP”, i financuar nga BE-ja dhe zbatohet nga CARE Deutschland zyra për Kosovë. Në mesin e tetë (8) komunave të Kosovës, në këtë projekt përfshihet edhe komuna e Obiliqit dhe synimi i këtij projekti është rritja e pjesëmarrjes së të rinjve në proceset vendimarrëse në komunitetet lokale dhe nivel qendror. Përkatesisht, të rinjve dhe të rejave pjesëmarrëse do ju ofrohet mundësia për rritjen e kapaciteteve nga ekspertet e fushës në aftësitë e buta në temat: të drejtat e njeriut, teknikat e avokimit, aktivizimi rinor si dhe mundësi punësimi përmes komponentës së dytë të projektit masa Aktive e Tregut të Punës dhe në ndërmarrësi apo Start-up. Ky takim njoftues u mbajt me 7 qershor 2022.

➤ ***Shënimi i Javës Aerounatike të Kosovës- “Kastriot Open 2022”***

Në bashkëpunim me Klubin e paraglajding-ut “Shqiponjat e Kastriotit”, në Stadiumin “Agron Rama”, është shënuar Java Aerounatike e Kosovës “Kastriot Open 2022” nga 09 Qershori deri me 12 Qershor, kjo javë është shënuar me aktivitete të shumta që lidhen me këtë sport.

➤ ***Shënimi i 14 Qershorit – Ditës së Çlirimit të Komunës së Obiliqit***

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, nën patronatin e Kryetarit të Komunës së Obiliqit, z.Xhafer Gashi, ka shënuar aktivitete të shumta kulturore dhe sportive në shënimin e 14 Qershorit – Ditës së Çlirimit të Komunës së Obiliqit, duke organizuar aktivitetet si në vijim:

- 11 Qershori – Krisma e parë e Lirisë në fshatin Hamidi- në bashkëpunim me Shoqatat e Dalura nga Lufta të Komunës së Obiliqit, Vushtrisë dhe Fushë-Kosovës, është shënuar 24 vjetori i Betejës së Hamidisë, duke shënuar fillimin e Javës së Çlirimit të Komunës së Obiliqit. Ky program u përcoll me një evokim të kësaj ngjarje historike nga vajza e bashkëpjesmarrësit të kësaj beteje, Laura Saraqi për të vazhduar me një pikë artistike të interpretuar nga këngëtari z.Besim Haliti, kushtuar Betejës së Hamidisë.
- Ceremonia e homazheve pranë Pllakës Përkujtimore të Dëshmoreve të Kombit në Sheshin e Qytetit “Dëshmorët e Kombit” dhe ceremonia e homazheve në Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz.
- Turniri i Shahut- në bashkëpunim me Qendrën Rinore, është realizuar Turniri i Shahut, aktivitet ky i realizuar në Shtëpinë e të Moshuarve.
- Turniri i Boksit- në bashkëpunim me Klubin e Boksit “Kastrioti” dhe Federatën e Boksit të Kosovës është realizuar Turniri i Boksit në Amfiteatrin e Sheshit të Qytetit, nën pjesëmarrjen e 70 ekipeve. Prezent në këtë spektakel të jashtëzakonshëm ishte edhe boksieri z.Aziz Salihu.
- Akrobacion nga Klubi i Gjymnastikës “Obiliqi”- në Sheshin e Qytetit “Dëshmorët e Kombit” në shënim të 14 Qershorit, është dhënë spektakel i jashtëzakonshëm me akrobacione nga vajzat e zellshme të Klubit të Gjymnastikës “Obiliqi”.

- Manifestimi Qendror për Ditën e Çlirimit – Komuna e ka përmbyllur aktivitetet për Ditën e Çlirimit, me Manifestimin Qendror, i mbajtur në Shtëpinë e Kulturës “Xhavit Haziri”, manifestim ky i cili u përcoll me monologun “Trojet Shqiptare” nga nxënësja e Gjimanzit “17 Shkurti”, Vëtima Sadiku dhe me pikat artistike e këngë nga Ansambli i Këngëve dhe Valleve “AKV Qyteti i Obiliqit”.
- Përrurimi i Bibliotekës së Qytetit- në Ditën e Çlirimit të Komunës së Obiliqit 14 Qershorit, është bërë përrurimi i Bibliotekës së Qytetit, një projekt madhor dhe i mirëpritur nga të gjitha grupmoshat. Përrurimin e këtij projekti madhor e ka bërë Kryetari i Komunës së Obiliqit, z.Xhafer Gashi, së bashku me qytetarët të shumtë, nxënës dhe studentë.

➤ *Aktivitetet kushtuar “Ditëve të Diasporës”*

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport është përkujdesur që për nder të mërgatës shqiptare të organizojë aktivitete kushtuar pikërisht atyre, kësisoj është organizuar:

- **Koncerti “T’i këndojmë Diasporës”:** ky koncert është mbajtur në Sheshin e Qytetit “Dëshmorët e Kombit”, gjatë dy netëve (12 dhe 13 gusht 2022), ku gjatë natës së parë është përcjellur me muzikë nga dhjetë (10) artistët të Komunës së Obiliqit dhe nata e dytë nën muzikën e këngëtarës, Shkurte Gashi.
- **Festivali 1st NewBorn:** ky festival është organizuar në kuadër të Koncerti të Diasporës, në natën e 13 gusht 2022, në bashkëpunim me FIDAF Kosova.ku pjesëmarrës në këtë festival ishin tetë (8) shtete të botës: (Polonia, Turqia, Kolumbia, Kameruni, Argjentina, Bullgaria, Maqedonia, Sllovakia).

- **Defilimi i 200 motoçiklistëve nëpër qendër të qytetit**, duke sjellur adrenalinë dhe spektakel të jashtëzakonshëm në qytet, me pjesëmarrjen e motoklubeve nga Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia.
- **Aktiviteti sportiv:**Fluturimi i paragllajdistëve “Shqiponjat e Kastriotit” mbi qytet.

➤ ***Shënimi i 12 gushtit- Dita Ndërkombëtare e Rinisë***

- Punëtorja me të rinjët e komunës së Obiliqit dhe Graçanicës, mbi temën e mjedisit të pastër, përmes pikturimit dhe pasqyrit të ideve të të rinjve se si duhet të ruhet dhe mbrohet mjedisi, kjo punëtori është mbajtur në bashkëpunim me Qendrën Rinore dhe OSBE-në.
- Aktiviteti sportiv tradicional “Streetball 2022” edicioni i dytë, në Sheshin e Qytetit “Dëshmorët e Kombit” nën pjesëmarrjen e 12 ekipeve nga qytetit i Obiliqit dhe komunat përreth: Lipjani, Prishtina dhe Fushë-Kosova.
- Aktiviteti sportiv: Turniri në Basketboll me grupmoshat U16, në Palestrën Sportive “Adem Jashari”, prezent tetë (8) ekipe nga qytetet e Kosovës dhe nga qytetet nga Maqedonia e Veriut.

➤ ***Shënimi i aktivitetit “Dita pa Makina” –(19 shtator 2022)***

Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport në bashkëpunim me Drejtorinë për Mbrojtje dhe Mjedis dhe Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, kanë shënuar aktivitetin simbolik "DITA PA MAKINA" përmes biçikletave. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte ngritja e vetëdijesimit të qytetarëve duke ndikuar në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit duke shfrytëzuar sa më shumë lëvizje me biçikletë, transportin publik si dhe mjetet tjera alternative të cilat shkaktojnë sa më pak apo zero ndotje.

➤ ***Shënimi i Javës Rinore 2022 – (21 shtator – 30 shtator)***

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në bashkëpunim me Qendrën Rinore dhe OSBE-në, kanë shënuar Javen Rinore 2022, duke përcjellur me aktivitete të shumta, si vijon:

- Turnir në Basketboll me personat me nevoja të veçanta,
- Aktiviteti në shah, me të rinjtë dhe grupmoshën e pensionistëve,
- Aktiviteti në pingpong, me të rinjtë
- Kinema e hapur
- Ligjeratë vetëdijuese “Siguria e të rinjëve”

➤ ***Kampionati Individual në Boks – (21 tetor-22 tetor 2022)***

Në Palestrën Sportive "Adem Jashari", është mbajtur Kampionati Individual i Kosovës në Boks, organizuar nga Federata e Boksit të Kosovës, në bashkëpunim me Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport të Komunës së Obiliqit.

➤ ***Garat Komunale në Hendboll (03 nëntor 2022)***

Në kuadër të kalendarit të garave sportive, DKRS-ja në bashkëpunim me DKA-në dhe Shoqatën e Pedagoqeve, kanë organizuar garat komunale në Vollejboll, ku fituese të kësaj gare dolën: ekipi nga Gjimnazi “17 Shkurti”.

➤ ***Koncerti i Filharmonisë së Kosovës (10 nëntor 2022)***

Nën përkujdesjen e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport në bashkëpunim me Filharmoninë e Kosovës, për artdashësit e kulturës dhe artit, në skenën e Shtëpinë së Kulturës “Xhavit Haziri” u dha Koncerti madhështor i Orkestrës Frymore të Filharmonisë së Kosovës. Me një program të pasuruar artistik, me solist e artistë profesionistë, qytetarët e Obiliqit patën rastin të përcjellin tingujt e bukur të veprave nga artistë të shumtë. Ndër emrat e solistëve të pranishëm gjatë

mbrëmjes së djeshme ishte edhe Sopranoja njohur, znj. Adelina Paloja, e cila vjen nga qyteti i Obiliqit.

➤ ***Turniri tradicional në Kik-Boks – (20 nëntor 2022)***

Në kuadër të javës së shënimit të festës së flamurit- 28 Nëntorit, në Palestrën Sportive "Adem Jashari", është mbajtur turniri në Kik-Boks, i cili është organizuar nga Klubi i Kik-Boksit "Arbër" në bashkëpunim me Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport të Komunës së Obiliqit. Në këtë garë, ishin pjesëmarrës klube nga Kosova, Shqipëria dhe Mali i Zi.

➤ ***Shënimi i 28 Nëntorit- Ditës së Flamurit Kombëtar***

Për nder të 28 Nëntorit- Ditës së Flamurit Kombëtar, daljes së parë publike të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ditëlindjes së Komandantit Legjendar Adem Jashari, nën patronatin e Kryetarit të Komunës së Obiliqit, z.Xhafer Gashi dhe nën përkujdesjen e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport është shënuar kjo datë me aktivitetet si në vijim;

- Ceremonia e homazheve në Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz.
- Ceremonia e homazheve pranë Pllakës Përkujtimore të Dëshmoreve të Kombit në Sheshin e qytetit të Obiliqit.
- Manifestimi kulturor-artistik në Shtëpinë e Kulturës “Xhavit Haziri”, ky program i pasuruar kulturor u realizua në bashkëpunim me shkollën "Dr.Ibrahim Rugova", Ansamblin dhe Teatrin e Qytetit, nën tingujt e bukur me motive të festës së 28 Nëntorit, Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe Komandantit Legjendar Adem Jashari.

➤ ***Koncerti i Ansamblit Kombëtar të Këngëve dhe Valleve AKKV “SHOTA”- (30 nëntor 2022)***

Nën përkujdesjen e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport në bashkëpunim me AKKV “SHOTA”, në sallën e Shtëpisë së Kulturës “Xhavit Haziri” u dha koncerti i Ansamblit SHOTA, me peisazh koreografik “Retrospektivë 50 vjeçare e Koreografit Xhemali Berisha”.

➤ ***Shfaqja e dramës për fëmijë të filmit vizatimor “Tomi dhe Xheri” –(19 dhjetor 2022)***

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, në kuadër të aktiviteteve të saj, është përkujdesur që për fundvit të sjellë edhe aktivitete të shumta e argëtim për fëmijët e Komunës së Obiliqit. Me këtë rast, në sallën e Shtëpisë së Kulturës “Xhavit Haziri” u dha shfaqja e dramës të filmit vizatimor shumë të dashur për fëmijët “Tomi dhe Xheri”.

➤ ***Akademi Mirënjohjeje – shënimi i 40 vjetorit jubile tëi bashkimit politik tëi organizatave patriotike- Krijimi i LPK-së- (20 dhjetor 2022)***

Në bashkëpunim me shoqatën “Lëvizja” dhe nën përkujdesjen e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, është shënuar 40 vjetorit jubile tëi bashkimit politik tëi organizatave patriotike- Krijimi i LPK-së, përmes një akademie e përcjellur me njoftim të shkurtër lidhur me veprimtarinë e kësaj lëvizjeje dhe me pjesë artistike të deklamimit të poezive nga Teatri i Qytetit.

➤ ***Koncerti i Korit të Fëmijëve “Okarina” – (29 dhjetor 2022)***

Nën përkujdesjen e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe bashkëpunim me Korin e Fëmijëve “Okarina”, në Shtëpinë e Kulturës "Xhavit Haziri", për publikun dhe qytetarët e fëmijët e Obiliqit, u dha një koncert i përgaditur në vigjilje të festave të fundvitit.

➤ ***Festivali “Zjarr dhe Akull” – (21 dhjetor-30 dhjetor 2022)***

Në prag të festave të fundvitit, nën organizimin e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport të Komunës së Obiliqit, është organizuar Festivali “Zjarr dhe Akull” i cili është realizuar për herë të parë në Obiliq. Ky Festival ka zgjatur dhjetë (10) ditë (21- 30 dhjetor 2022), nga ora 19:00 në Sheshin e Qytetit “Dëshmorët e Kombit” në Obiliq, nën motive të magjisë festive dhe nën tingujt e bukur të këngëtarëve e bendeve të zhanreve të ndryshëm.

- Nata e parë (21 dhjetor): Nita Latifi&Band
- Nata e dytë (22 dhjetor): Adelina Berisha
- Nata e tretë (23 dhjetor): Ashikët
- Nata e katërt (24 dhjetor): Sidorela Band
- Nata e pestë (25 dhjetor): Rina Ramadani
- Nata e gjashtë (26 dhjetor): TNT

- Nata e shtatë (27 dhjetor): Asim Gashi
- Nata e tetë (28 dhjetor): Betim Alihajdari
- Nata e nentë (29 dhjetor): Kastriot Grajqevci
- Nata e dhjetë (30 dhjetor): Xhaner Gashi&Unisons.

➤ ***Aktiviteti i përvitshëm “Sportistit i Vitit 2022”***

Në aktivitetin e përvitshëm “Sportisti i Vitit”, nën përkujdesjen e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport u ndanë mirënjohjet për sportistët e dalluar të komunës së Obiliqit, të cilët me talentin, punën e përkushtimin tyre po arrijnë rezultate të jashtëzakonshme duke bërë krenar gjithë qytetin e Obiliqit. Për këtë vit, titulli “Sportisti i Vitit” i takoj karateistit, Islam Selmani, nga klubi i Karatesë “Besa-Obiliq”, Titulli Ambasador i takoj futbollistit i cili bëri krenar Obiliqin dhe gjithë Kosovën, Armend Thaqi, ndërsa mirënjohjen post-mortem i ndamë familjes së z.Izet Kastratit, po ashtu mirënjohje u ndan për sportistët që kontribuan ndër vite dhe për sportistët më me perspektiv.

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, menaxhon me objektet kulturore, sportive dhe Bibliotekës, ku gjatë tërë vitit është përkujdesur në ofrimin e kushteve të përshtatshme për realizimin e aktiviteteve sportive, kulturore e rinore:

➤ **Shtëpia e Kulturës “Xhavit Haziri”**

Në Shtëpinë e Kulturës “Xhavit Haziri” janë realizuar aktivitete kulturore-artistike të prezantuara mësipër, njëkohësisht janë mbajtur ushtrimet e rregullta nga AKV “Qyteti i Obiliqit” dhe ushtrimet skenike e teatrale të Teatrit të Qytetit dhe aktivitete të tjera nga OJQ-të e Komunës së Obiliqit.

➤ **Palestra Sportive “Adem Jashari”**

Në Palestrën Sportive “Adem Jashari”, janë realizuar stërvitjet e rregullta të klubeve, ndeshjet miqësore dhe aktivitete të tjera sportive, nuk ka pasur asnjë ndërprerje të aktiviteteve gjatë kësaj periudhe.

➤ **Biblioteka e Qytetit**

Që nga data 14 Qershor 2022, tashmë kemi funksionalizimin e objektit të Bibliotekës së Qytetit, ku përveç orarit të rregullt të punës, Biblioteka e Qytetit ka qenë e hapur deri në ora 23:00. Njëkohësisht, kemi bashkëpunuar me dashamirës të librit: mësimdhënës, nxënës, shkrimtar , në mënyrë që të kemi ngritje të vetëdijes rreth lexushmërisë.

- Është bërë pasurimi me 50 tituj librash nga shkrimtari z.Jusuf Buxhovi.
- Është bërë pasurimi me një sërë titujsh nga shkrimtari z.Betim Bregovina, duke përfshirë vepra me shkronja të zmadhuara dhe të formatit brajt për persona me vështirësi në të pamurit.
- Është bërë pasurimi me mbi 400 tituj librash nga MKRS-ja.

Në nderim të të rënëve për liri e shtet ndërtim, Drejtoria për Kulturë ka organizuar:

- Ceremoni të homazheve për nder të Epopesë së UÇK-së, 5-6 dhe 7 Mars, pranë “Pllakës Përkujtimore të Dëshmorëve” në Sheshin e qytetit dhe në Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz.
- Ceremoni të homazheve në nderim të “Dëshmoreve të familjes Rama, Martirëve të familjes Halimi dhe Haliti”.
- Ceremoni të homazheve në nderim të të rënëve të familjes Morina, pranë Pllakës përkujtimore në Milloshevë.
- Ceremoni të homazheve në nderim të “Dëshmorit Ferit Curri”, pranë lapidarit në fshatin Mazgit.

- Ceremoni të homazheve në nderim të “Dëshmorit Fejzullah Grajçevci”, pranë Pllakës Përkujtimore në fshatin Graboc.
- Ceremoni të homazheve në nderim të “Dëshmorit Murat Krasniqi”, në Stanoc.
- Ceremoni të homazheve pranë “Pllakës Përkujtimore të Dëshmorëve”, në fshatin Siboc.
- Ceremoni të homazheve pranë në nderim të “Dëshmorit Hasan Hasani”, pranë varrit në fshatin Mazgit.
- Ceremoni të homazheve te “Martirët e familjes Aliu”, pranë Pllakës Përkujtimore në fshatin Milloshevë.
- Ceremoni të homazheve për “Dëshmoret e rënë në Betejën e Hades”.
- Ceremoni të homazheve në nderim të “Dëshomirt Avdullah Qerkezi”.
- Ceremoni të homazheve në nderim të “Dëshmorit Faik Mjeku”, pranë Pllakës Përkujtimore në fshatin Graboc.
- Ceremoni të homazheve në nderim të “Dëshmorit Nuhi Kelmendi”, pranë varrit në fshatin Hamidi.
- Ceremoni të homazheve në nderim të “Heroit të Kombit Xhavit Haziri”, pranë Shtatores së Heroit të Kombit, të Shtëpia e Kulturës “Xhavit Haziri”.
- Ceremoni të homazheve në nderim të “Dëshmorit Isuf Shalaku”, pranë Pllakës Përkujtimore në Dardhishtë.
- Ceremoni të homazheve në nderim të “Heroit të Kombit Fahri Fazliu”, pranë bustit të Heroit në Obiliq.

Shënim: Gjatë këtij viti të punës, janë ndërmarrë edhe veprime të tjera, janë shqyrtuar me afat kohor kërkesat e palëve, janë diskutuar dhe komentuar aktivitete dhe ide të ndryshme që i përkasin sektorit të tashëgimisë, janë realizuar vizita në teren në bashkëpunim me Inspektoratin e Trashëgimisë Kulturore të MKRS-së, janë realizuar raporte të shumta përmbledhese për

infrastrukturën fizike sportive, kulturore dhe rinore sipas kërkeses së Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, janë realizuar takime me akteret të shumtë të nivelit lokal e qendror, duke përfshirë u.d sekretarin e përgjithshëm të MKRS-së, takime me përfaqësuesit e KFOR-it LMT K9 zviceran, u.d drejtorin e Teatrit Dodona, drejtorin e Baletit Kombëtarë të Kosovës, drejtoret komunal të sektorit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit nga Komuna e Fushë Kosovës dhe Podujevës.

DREJTORIA E ARSIMIT

Drejtoria e Arsimit gjatë vitit 2022, punët dhe detyrat i ka kryer në bazë të Planit të Punës për vitin 2022. Janë mbajtur takimet e rregullta me Bordin e Drejtorëve Komunal, drejtorët e institucioneve arsimore, Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, punëtorët e DA-së dhe takimet e shumta me OJQ-të për projektet e arsimit. Monitorimet në Institucionit arsimore.

Nga nëpunësit e DA-së janë hartuar planet e punës për vitin 2022 dhe 2023. Gjatë muajit janar 2022 janë kryer vlerësimet e punëtorëve për vitin 2021 në Sistemin e Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNJ), ku nota mesatare e vlerësimit të nëpunësve për detyrat dhe aktivitetet është 4.22.

Zvillimi i procesit mësimor

Nga data 03.01.2022 deri më 15.01.2022 kam vizituar të gjitha shkollat e mesme, fillore dhe çerdhen bashkë me shefin për arsimin fillor dhe të mesëm z. Rexhep Zeka, ku gjatë kontrollimit janë vërejtur disa mungesa si p.sh.: të niveli i nxemjeve, mungesa e inventarit shkollor dhe disa probleme në aspektin fizik.

Më 11 janar 2022 në Institucionet Arsimore ka filluar periudha e dytë e vitit shkollor 2021-2022, e cila do të përfundojë me 31 mars 2022. Gjatë periudhës së parë gjashtë institucione arsimore në janar – shkurt 2022 për shkak të pandemisë nga Covid - 19 kanë punuar me skenarin c, në distancë, vetëm nga pesë ditë. Këto IA janë :IP”Rrita jonë” në Obiliq; SHFMU”Hasan Prishtina “ në Milloshevë ;

“Naim Frashëri “ në Breznicë(niveli 6-9); “Pandeli Sotiri “ në Plemetin (niveli 1-5); Gjinnazi “17 Shkurti “ në Obiliq dhe SHMLP”Ismail Dumoshi “në Obiliq .

Periudha e dytë dhe e tretë e vitit shkollor 2021-2022 janë mbajtur në kushte normale (pa pandemi nga Covid-19) dhe gjatë këtyre periudhave, të shtuneve janë zëvendësuar ditët e humbura nga shtatori 2021, për shkak të covid-19.

Gjatë periudhës së parë 2022 janë bërë pagesat për nxënës të SHFMU ,nxënës me nevoja të veçanta, për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe bursave të nxënësve për shkollat e mesme të larta dhe studentëve të niveit baçelor e master për vitin shkollor dhe akademik 2021-2022 .Janë bërë pagesat për:

Kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit për 24 nxënës me nevoja të veçanta në vlerë prej **19,440.00 €**

Bursa për 62 nxënës të SHML në vlerë prej **11,160.00 €**

Bursa për(92 studentë në nivelin baçelordhe një në master) në vlerë prej **52,900.00 €**

Kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit për 726 nxënës të SHFMU dhe SHML në vlerë prej **98,124.00€**.

Gjatë muajit maj 2022 janë paguar edhe **88.095 €** për bursat e studentëve dhe kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit për:bursë për një nxënës të SHML,53 studentë të nivelit bahçelor,44 studentë në nivelin master , një në doktoraturë dhe 29 nxënës janë ndihmuar me mjete për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit .

Fillimin i vitit të ri shkollor 2022-2023

Drejtoria e Arsimit në bashkëpunim me drejtorët e Institucioneve Arsimore me kohë kanë bërë përgatitjet për fillimin e vitit shkollor2022-2023.Mirëpo, ky vit shkollor nuk ka filluar me një shtator si zakonisht, sepse që nga data 25.08.2022, punëtorët e arsimit kanë filluar grevën të thirrur nga SBASHK-u, të cilën e kanë ndërprerë me 30 shtator 2022.Pagat e tyre nga Ministria e Financave nuk janë ekzekutuar deri më 10.10.2022.MASHTI ka marrë vendim për zëvendësimin e 22 orëve për muajin shtator sipas vendimit nr. 01/B,2592,datë 04.10.2022.Mirëpo, edhe pse në shkolla është punuar të shtuneve për zëvendësimin e ditëve të grevës , shumë nga prindërit nuk i kanë dërguar fëmijët në shkolla.Andej, është punuar pjesërisht.

Viti i ri shkollor 2022-2023 për shkak të grevës së punëtorëve të arsimit ka filluar me 3 tetor 2022, me 4376 nxënës ,prej tyre 3654 shqiptarë ,269 serbë,186 ashkali,266 romë dhe 1 boshnjak.Në mesin e këtyre nxënësve janë 266 parashkollorë dhe 77 fëmijë në IP në kopsht dhe çerdhe.

MASHTI-i ka bërë ndryshime në Udhëzimin Administrativ Nr.05/2022 për Kalendarin e Vitit Shkollor 2022-2023,ku janë hequr tri periudhat dhe nga ky vit shkollor do të punohet përsëri me dy gjysmëvjetora.

Numri i punëtorve të arsimit në dhjetor 2022 është 402 punëtorë, prej tyre 10 drejtorë,2 zëvendës drejtor, 332 mësues,1 administratë ,53 punëtorë teknikë,2 bibliotekarë dhe 2 vozitës.Numëri i punëtorëve ndryshon gati çdo muaj për shkak të pushimeve të lehonisë dhe pushimeve tjera.

Drejtoria e Arsimit për mbarëvajtje të vitit shkollor ka kryer këto detyra:Përgatitjen e objekteve shkollore;Ndarja e mjeteve higjienike për IA;ndarja e materialit pedagogjik për IA;furnizimi me dru dhe pelet për IA është bërë në korrik 2022;ndarja e librave shkollor falas nga MASHTI për nivelin 1 dhe 2.

Më 24.08.2022 është bërë dezinfektim, deinsektim dhe deratizim (DDD) i IA ,i cili projekt është realizuar nga Drejtoria për Shëndetësi e Mirëqenie Sociale.

Më 24.08.2022 nga Ekipi Komunal për Parandalim, Reagim ndaj Braktisjes dhe Mosregjistrimit të nxënësve në arsimin parauniversitar EPRBM në Plemetin është mbajtur fushata “**Arsimi për të gjithë**”në mënyrë që prindërit e komunitetit ashkali,rom dhe egjiptian ta rrisin vetëdijen që fëmijët e tyre të shkojnë në shkollë të rregullt dhe mos të ketë fëmijë, nxënës që nuk regjistrohen për parashkollor dhe klasë të parë dhe mos të ketëbraktisje në shkolla.

Panifikimi i projekteve kapitale pëvitiin 2022

Janë përgatitur planet e prokurimit për vitin 2022 ,ku në bashkëpunim me DA dhe IA janë përcaktuar këto projekte :

Nr.	Shkolla	Vendi	Projekti	Rel izi mi	Vlera
-----	---------	-------	----------	------------------	-------

				ng a DA
1	“Ismail Dumoshi”	Obiliq	Paisja e punëtorive të degëve të ndryshme si : Makineri, Elektro, Ekonomi në SHMLP " Ismail Dumoshi" Obiliq	DA 45,000.00
2	“Ismail Dumoshi”	Obiliq	Paisja e minipunëtorive të degëve të ndryshme si : Makineri, Elektro, Ekonomi etj në SHMLP " Ismail Dumoshi" Obiliq	DA 5,000.00
3	“Migjeni “ “Fazli Grajqevci” “Dr. Ibrahim Rugova “	Sibovc Lajthishtë Mazgit i Epërm dhe i Poshtëm	Paisja e shkollave me kabinete të shkencave (Fizikë,Kimi dhe Biologji)	DA 25,000.00
4	Të gjitha institucionet arsimore		Projekti renovimi i objekteve shkollore	DA 55,000.00
5			Projekti vendosja e kamerave dhe riparimi i tyre ekzistuese nëpër shkolla	DA 18.000.00
6	“Abdurrahmon Gërguri “	Dardhishtë	Përgaditja e projektit ndërtimi i sallave të edukatës fizike	DA 62,000.00

7	Të gjitha institucionet arsimore	Projekti për inventar nëpër shkolla si (karriga, banka,tabela, inventar për sallë, zyre të drejtorëve dhe inventar tëbibliotekave për shkolla duke përfshirë tavolina, karrika dhe rafte për libra).	DA	32,101.00
8	<u>“Isamil Dumoshi “dhe “Dr. Ibrahim Rugova “</u>	Digjitalizimi i objekteve shkollore që përfshinë (Projektor, llaptop, perde për projektor, etj.)	DA	20,000.00
9		Paisja e bibliotekave të shkollave me tituj të librave në bazë të planprogrameve mësimore.	DA	10,000.00
10	Të gjitha institucionet arsimore	Furnizimi i shkollave me material didaktik.	DA	15,000.00
Gjithsej				287,101.00

Projektet kapitale gjatë vitit 2022 :

- Blerja e paisjeve për kabinete në shkollat e Komunës së Obiliqit
(për kabinete të fizikës , kimisë ,me acide dhe biologjisë për paralelet e ndara të SHFMU:”Dr. Ibrhim Rugova “ në Mazgit të Epërm dhe të Poshtëm,”Migjeni “ në Soboc dhe “Fazli Grajqevci “ në Lajthishtë .
- Inventar shkollor për Institucionet Arsimore
- Projekti për mjete higjenike për IA

- Projekti për Dezinfektim, Deinsektim dhe Dderatizim (DDD) të IA ,i cili është realizuar nga DSHMS.
- Vendosija e kamerave në IA , e realizuar nga DSHPE
- Ndërtimi i sallës së edukatës fizike në SHFMU”Dr. Ibrahim Rugova “ në paralelen në Mazgit të Poshtëm, me sipërfaqe bruto 554.775 m²(faza e parë)
- Ndërtimin e sallës së edukatës fizike në SHFMU”Abdurrahmon Gërguri “ në Dardhishtë,me sipërfaqe bruto 872.5 m²(faza e parë)
- Paisjet e dy punëtorive për energjetikë dhe makineri në SHMLP”Ismail Dumoshi “ në Obiliq
- Renovimi i shkollave dhe blerja e paisjeve
- Loptop për SHMLP”Ismail Dumoshi” në Obiliq
- Inventari (pjesa e parë) për shkollat e Obiliqit, donacion nga Shoqata humanitare “KIF Liria “ në Suedi , ku DA ka participuar me mjete për transport sipas marrëveshjes me KK në Obiliq
- Inventari (pjesa e dytë)për shkollat e Obiliqit, donacion nga Shoqata humanitare “KIF Liria “ në Suedi , ku DA ka participuar me mjete për transport sipas marrëveshjes me KK në Obiliq dhjetor 2022
- Transporti për bartjen e nxënësëve (nga zona e interesit nacional)Shipitullë-Graboc i Poshtëm e anasjelltas dhe Hde-Palaj e anasjelltas

Më 20.09.2022 u vu gurthemeli për ndërtimin e sallës së edukatës fizike në SHFMU”Dr. Ibrahim Rugova “ në paralelen në Mazgit të Poshtëm

Më 23.09.2022 u vu gurthemeli për ndërtimin e sallës së edukatës fizike në SHFMU”Abdurrahmon Gërguri “ në Dardhishtë.

Projektet nga donatorë :

- Renovimi i SHFMU”Dr. Ibrahim Rugova “në Obiliq, donacion nga Ambasada Amerikane në Kosovë (projekti ka filluar të realizohet nga qershori 2022), vlera e projektit është mbi 250,000.00 \$.

- Rregullimi i klasës me nevoja të veçanta (mjetet didaktike, teknologjike në SHFMU”Dr. Ibrahim Rugova “ në Obiliq , donacin nga Asociacioni i Komunave dhe NALAS(Asociacioni i Komunave të Evropës Juglindore), vlera 3,000.00 €
- Qendra për Arsimin e Kosovës KEC “Moralet “në hyrje të SHFMU”Dr. Ibrahim Rugova “ në Obiliq dhe trajnimet e mësimdhënësve nga artistë profesionl , 2,000.00 €
- Projekti nga VORA “Zëri i romve dhe ashkalive” në SHFMU “Dr. Ibrahim Rugova” në Obiliq, ku nxënësit e kësaj shkolle kanë vizatuar disa murale.
- Renovimi i sallës së edukatës fizike dhe disa klasëve në SHFMU”Dr. Ibrahim Rugova “në Obiliq nga Ambasada Japoneze, vlera e projektit është 67,122.00 €

Vlenë të theksohet se të gjitha këto projekte për SHFMU”Dr. Ibrahim Rugova”në Obiliq janë fituar me punën dhe përkushtimin e drejtoreshës Shyhrete Gashi, për punën e saj DA e falenderon.

Konkurset e rekrutimet 2022

Gjatë vitit 2022 nga Drejtoria e Arsimit janë publikuar 42 konkurse të rregullta dhe 5rishpallje për vende të lira të punës për mësimdhënës ,asistente për fëmijët me nevoja të veçanta ,bibliotekar ,drejtor dhe punëtorë teknikë.Një konkurs është anuluar për mësimdhënës të biologjisë në SHFMU”Dr. Ibrahim Rugova “ në Obiliq .Nga komisionet për rekrutim janë mbajtur intervistat , testet me shkrim dhe intervistat me gojë .Pas vlerësimeve komisionet kanë përzgjedhur 27 mësimdhënës dhe tre punëtorë teknikë,sepse 7 konkurse të publikuara gjatë vitit 2022 do të shqyrtohen në janar dhe shkurt 2023.

Nëdisa konkurse të publikuar është vërejtur mungesa e kandidatëve të kualifikuar sipas UA nr.05, 08/2021 për disa vende për mësimdhënës si : asistentë për fëmijët me nevoja të veçanta ,matematikë, fizikë dhe TIK.

Më 28.03.2022 është zgjedhur drejtore Shyhrete Gashi në SHFMU”Dr. Ibrahim Rugova “ në Obiliq duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr.106/2020 për vlerësimin e performancës së drejtorit dhe zëvendës drejtorit të institucionit publik-arsimor parauniversitar, Ligjit të Arsimit në Komunitet e Republikës së Kosovës, Nr.03/L068 dhe në Ligjin e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës me Nr.04/L-032.

Mbështetur në vendimet e Drejtorisë së Arsimit me nr.-X-1046, datë 22.12.2021 dhe vendimin me plotësim ndryshime Nr.-X-02 , datë 06.01.2022 . Vetëvlerësimi nga drejtoresha e shkollës , Vlerësimi nga Drejtoria e Arsimit në Obiliq dhe Vlerësimi nga SIA- Prishtinë.

Shqyrtimi i kërkesave të DA-së në intranet :

Në intranet gjatë vitit 2022, në DA janë pranuar **2511** kërkesa, ankesa dhe fatura për pagesat e projekteve të realizuara të IA, për komunalitet dhe për çerdhe për ushqim e pije , prej tyre janë miratuar 1978, të refuzuar 488, të anuluar 6 , të hedhura poshtë 6, transferuara (ceduara) 5, pezulluara 5 dhe në proces janë 23 kërkesa, kryesisht për konkurset e publikuar deri më 06.01.2023 për mësimdhënës të matematikës në SHFMU” Migjeni “ në Siboc, paralelja e ndarë në Graboc të Epërm, mësuese klase në SHFMU” Pandeli Sotiri “ në Obiliq, paralelja në Plemetin dhe për pozitën për drejtor në SHFMU” Naim Frashëri “ në Breznicë.

Subvencionet e DA për vitin shkollor dhe akademik 2022-2023

Drejtoria e Arsimit ka publikuar tri konkurse sipas Rregullores për ndarjen e bursave, kompensimit dhe shpenzimeve të udhëtimit dhe aktivitet jashtëshkollor Nr.-I-104, datë 31.08.2020. Konkursët janë publikuar për: Kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit për nxënës për vitin shkollor 2022-2023, Konkursin për bursa të nxënësve për SHML me sukses të shkëlqyeshëm për vitin shkollor 2022-2023 dhe Konkursin për bursa për studentë për vitin akademik 2022-2023 për tri nivele: studimet themelore-bachelor, master dhe doktoraturë. Për të gjitha kategoritë janë planifikuar mjetet në vlerë prej **280,365.00 euro**.

Për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit kanë konkurruar 902 nxënës dhe kanë përfituar 711 nxënës, vlera e pagesës është **95.985.00 €**, (711x135 €).

Për 28 nxënës me nevoja të veçanta, vlera e pagesës është **19,620.00 €**

Për bursa të SHML kanë konkurruar 73 nxënës me sukses të shkëlqyeshëm dhe kanë përfituar 57 nxënës, vlera e pagesës është **10,260.00 euro** (57x180 euro)

Për bursa të studentëve të nivelit bachelor kanë konkurruar 220 studentë, por kanë përfituar 167 studentë, vlera e pagesës është **100,500.00 euro**

Për bursa të studentëve në nivelin master kanë konkurruar 71 studentë dhe kanë përfituar 54 studentë, shuma **54,000 euro** (54x1000)

Për nivelit e doktraturës ka konkurruar një studente, por nuk ka përfituar, sepse nuk i ka plotësuar kriteret e konkursit.

Për të gjitha kategoritë për subvencione në DA kanë konkurruar 1295 kandidatë dhe kanë përfituar 1017 nxënës e studentë të dy niveleve. Në mesin e atyre që nuk kanë përfituar janë 278 nxënës e studentë, të cilët nuk i kanë plotësuar kriteret e konkurseve.

Studenti më i dalluar me notë mesatare 9.65 është Genti Veseli, nga Fakulteti Filozofik, drejtimi histori, i cili ka fituar çmimin “Adem Preniqi” dhe ka marrë shpërblimin 1000 €.

Trajnimet e mësimdhënësve :

Gjatë muajit janar është kryer vlerësimi i dosjeve të mësimdhënësve për zbatimin e kurrikulës, të cilët në shtator 2021 kanë kryer trajnimin për zbatimin e kurrikulës. Në MASHTI janë dërguar propozimet e IA për trajnimet e mësimdhënësve sipas kërkesave të tyre. Karitasi Zvicren, ka mbajtur punëtori për klasët me parafillor, ku kanë marrë pjesë dy zyrtare të DA-së.

Trajnimet me OJQ “Autizmi Flet” janë mbajtur në SHFMU Dr. Ibrahim Rugova në Obiliq, ku nga IA i kanë ndjekur trajnimet 35 mësimdhënës. Trajnimet për kurrikulë i kanë ndjekur edhe 13 mësimdhënës. Në fushën gjuhët dhe komunikimi janë 2, matematikë 2, programi fillor 4, edukatore me parafillor 1, jeta dhe puna 1, artet 2 dhe edukata fizike, sportet dhe shëndetësia 1.

Garat e Diturisë 2022

Janë mbajtur garat e fizikës dhe matematikë në nivel të shkollave dhe komunës dhe fituesit e tyre kanë marrë pjesë në garat në nivel të Republikës së Kosovës.

Takimet e punës të Këshillit Komunal të Prindërve dhe Ekipet për Parandalim Reagim ndaj Braktisjes dhe Mosregjimit të fëmijëve në shkolla :

Takime dhe organizime të ndryshme

Më 03.03 2022 ka mbajtur takimin e rregullt Këshilli i Prindërve Komunal, ku më pas është mbajtur takim me DA lidhur me kërkesat e tyre.

Më 24.03.2022 ka mbajtur takimin e radhës Ekipi për Parandalim, Reagim ndaj Braktisjes dhe Mosregjistrimit të nxënësve në arsimin parauniversitar, ku sipas raporteve të shkollave 11 nxënës të SHFMU janë në prag të braktisjes ,dy nga gjimnazi, ndërsa nga SHMLP e kanë braktisur mësimin 9 nxënës.Të gjitha rastet janë dërguar në Qendren e Punës Sociale QPS në Obiliq, ku psikologja e kësaj qendre do të na ndihmojë për trajtimet e tyre.Në fund të periudhës së tretë mësimin e kanë braktisur 18 nxënës,16 meshkuj e 2 femra.Në SHFMU janë 4 nxënës ,3 meshkuj dhe 1 femër, ndërsa në SHML janë 14 nxënës, meshkuj 13 dhe femra 1 ,prej tyre shqiptar janë 17dhe 1 ashkali .

Është shënuar 7 Marsi-Dita e Mësuesit, ku është ndarë edhe çmimi “Mësimdhënës i dalluar” përmësimdhënësin e TIK-ut **Nusret Zeka**,nga SHFMU“Dr.Ibrahim Rugova”në Obiliq, i cili nga komisioni komunal i drejtorëve të shkollave është përzgjedhur nga komuna për të konkurruar për çmimin“Shaban Jashari “në MASHTI ;mësuesi **Xhevat Mehmeti** ,nga SHFMU “Hasan Prishtina“në Milloshevë;mësimdhënësja e fizikës **Fatbardha Dedinca**,nga SHFMU“Pandeli Sotiri”në Obiliq;mësimdhënësja e gjeografisë **Zethane Lumnica**,nga SHFMU“Naim Frashëri“në Breznicë;mësimdhënësja e gjuhës shqipe **Valbona Mushkolaj**, nga SHFMU“Fazli Graiçevci“ në Hade;mësimdhënësja e gjuhës shqipe **Afrore Aliu-Mjeku**,nga SHFMU“Migjeni”në Siboc;mësimdhënësja e matematikës **Makfirete Kurteshi**, nga SHFMU”Abdurrahmon Gërguri “ në Dardhishtë;mësimdhënësi i gjeografisë **Sami Restelica** nga Gjimnazi “17 Shkurti “ në Obiliq dhe mësimdhënësi i praktikës profesionale dhe koordinator i cilësisë,**Bejtë Cela** nga SHMLP“Ismail Dumoshi “ në Obiliq.

Gjatë muajit mars kanë filluar përgatitjet për Testin e Arritshmërisë 2022, i cili është mbajtur në dy qendra te SHFMU”Dr. Ibrahim Rugova “ në Obiliq dhe “Pandeli Sotiri “ në Obiliq.Kësaj radhe MASHTI-i për herë të parë Testin e Arritshmërisë e ka ndarë në dy pjesë , ku pjesa e parë e testit u mbajt më 4 qershor 2022 dhe pjesa e dytë më 14 qershor 2022.

Janë bërë parapërgatitjet për mbajtjen e Testit PISA 2022.

Planifikimi për regjistrimin e nxënësve për klasën e parë për vitin shkollor 2022-2023

Drejtoria e Arsimit në bazë të planifikimeve të shkollave fillore të mesme të ulta ka bërë planifikimin për paralelet e klasëve të para dhe numrin e nxënësve për vitin shkollor 2022-2023,

ku janë planifikuar 23 paralele me 384 nxënës .Prej tyre me mësim në gjuhën shqipe 19 paralele me 323 nxënës, ndërsa me mësim në gjuhën serbe janë 4 paralele me 61 nxënës .Planifikimet janë përgatitur për këto shkolla:

Nr.	Shkollat	Vendi	Numri i paraleleve	Numri i nxënësëve	Sqarime:Shkollat amë dhe paralelet e ndara
1.	“Dr. Ibrahim Rugova”	Obiliq	6	127	1=22 nxënës - Obiliq 2=23 nxënës - Obiliq 3=23 nxënës - Obiliq 4= 23 nxënës - Obiliq 5= 23 nxënës -Mazgit i Epërm 6=13 nxënës -Mazgit i Poshtëm
2.	“Hasan Prishtina”	Millosevë	3	70	1=28 nxënës - Millosevë 2=28 nxënës -Millosevë 3=14 nxënës - Raskovë
3.	“Pandeli Sotiri “	Obiliq	2	38	1= 20 nxënës-Obiliq 2=18 nxënës - Plemetin
4.	“Naim Frashëri”	Breznicë	2	36	1= 25 nxënës -Breznicë 2=11 nxënës - Kozaricë
5	“Fazli Graiçevci “	Hade	3	18	1 = 4 nxënës- Hade 2 = 11 nxënës- Lajthishtë 3 = 3 nxënës- Palaj
6.	“Migjeni “	Siboc	2	18	1=14 nxënës -Siboc 2= 4 nxënës -Graboc
7.	“Abdurrahman Gërguri “	Dardhishtë	1	16	
8.	“Sveti Sava “	Plemetin	2	36	

9.	“Dositelj Obradoviq”	Palaj	1	6	
10.	“Milan Rakiq”	Babimovc	1	19	
Gjithsej :			23	384	

- Planifikimi për klasë të dhjetë në SHMLP për vitin shkollor 2022-2023 janë planifikuar 10 paralele me 272 nxënës

Gjimnazi “ 17 Shkurti “ në Obiliq

Nr.	Drejtimi	Numri i paraleleve	Numri i nxënësve
1.	Gjimnazi Natyror	2	64
2.	Gjimnazi shoqëror	2	64
Gjithsej:		4	128

- SHMLP “ Ismail Dumoshi “ në Obili

Nr.	Drejtimi	Profili	Nr.i paraleleve	Nr.i nxënësve	Vitet e shkollimit
1.	Elektroteknikë	Informatikë	1	24	2+1
		Energjetikë	2	48	2+1
2.	Ekonomi	Kontabilitet	1	24	2+1
		Banka dhe financa	1	24	2+1
3.	Kimi-Teknologji	Xehtari	1	24	2+1
Gjithsej:			6	144	2+1

Më 27.06.2022 nga DA është publikuar konkursi për afatin e qershorit për regjistrimin e nxënësve në klasë të dhjetë përvitin shkollor 2022-2023, ku në Gjimnazin “17 Shkurti “ në Obiliq janë regjistruar 71 nxënës,33 në drejtimin shoqëror dhe 38 në drejtimin natyror.Kanë mbetur të lira edhe 57 vende.

Në SHMLP”Isamil Dumoshi “në Obiliq janë regjistruar 89 nxënës në klasë të dhjetë dhe kanë mbetur vende të lira edhe për 55 nxënës.

Në drejtimin elaktroteknikë janë regjistruar 52 nxënës ,kanë mbetur vende të lira edhe 20.Në kimi-teknologji janë regjistruar 14 nxënës kanë mbetur edhe 10 vende të lira .Në banka dhe financa janë regjistruar 14 nxënës ,kanë mbetur të lira edhe 10 vende . Në kontabilitet janë regjistruar 9 nxënës dhe të lira kanë mbetur edhe 15 vende.

Më 22.08.2022 është publikuar konkursi për afatin e gushtit për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të për vitin shkollor 2022-2023

Në SHMLP”Ismail Dumoshi” në Obiliq janë regjistruar 27 nxënës ,pra në të dy afatet janë regjistruar 116 nxënës.Nuk janë plotësuar edhe 28 vende në xehtari, energjetikë, banka dhe financa dhe kontabilitet .Vetën në drejtimin e informatikës është plotësuar planifikimi .

në Gjimnazin “17 Shkurti “ në Obiliq në afatin e gushtit janë regjistruar 29 nxënës komplet në të dy afatet janë regjistruar 100 nxënës. Nuk janë plotësuar 28 vende.

Vlerësimi i jashtëm për nxënës për vitin shkollor 2021-2022 :

Janë mbatur:

Testi Pisa 2022, ku kanë marrë pjesë nxënës të moshave 15-16 vjeç nga disa shkolla.

Testi PIRLS 2022 me disa klasë të katërta nga disa shkolla

Testi i Aritshmërisë 2022 ,me klasët e nënta,ku kanë marrë pjesë 386 nxënës,prej tyre 42 nga Shkolla Amerikan School of Kosova.Pjesa e parë u mbajt më 04.06.2022, ndërsa pjesa e dytë u mbajt më 14.06.2022.

Testi i Maturës Shtetërore 2022 ,me klasët e dymbëdhjeta, afati i qershorit u mbajt më 18.06.2022, ku do të marrin pjesë 290 nxënës të SHML,prej tyre 67 nga American School of Kosova.Afati i gushtit për Testin e Maturës Shtetërore 2022 u mbajt më 27 gusht 2022.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
 Suksesi i nxënësve në fund të gjysmëvjetorit të dytë 2021/22
 Arsimi fillor (1-5)
 Komuna **OBILIQ**

Klasi	Nr. pa	Nr. nx	Suksesi pozitiv									Gjithsej me				Të pa not			Numri i mungesave		
			Shkëlqyesh		Sh. mirë		Mirë		Mjaftueshë		Gjithsej me nota pozitive		Nr	%	Nr	%	Të arsy	Të pa	Gjithsej		
			Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%									
1	18	310	218	70.32	57	18.39	28	9.03	6	1.94	309	99.68					3723	1235	4958		
2	18	295	189	64.07	56	18.98	36	12.20	14	4.75	295	100.00					3963	791	4754		
3	19	321	178	55.45	69	21.50	58	18.07	10	3.12	315	98.13	6	1.87			4941	560	5501		
4	19	362	187	51.66	86	23.76	66	18.23	22	6.08	359	99.17	3	0.83			4533	1044	5577		
5	19	318	157	49.37	86	27.04	53	16.67	21	6.60	317	99.69	1	0.31			6580	2187	8767		
GJ	93	1606	929	57.85	354	22.04	241	15.01	73	4.55	1595	99.32	10	0.62			23740	5817	29557		

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
 Suksesi i nxënësve në fund të gjysmëvjetorit të dytë 2021/22
 Arsimi i mesëm i ulët (10-12)
 Komuna **Obiliq**

Klasi	Nr. pa	Nr. nx	Suksesi pozitiv									Suksesi i pamjaftueshëm									MUNGESAT			NOTA MESATARE		
			Shkëlqyesh		Sh. mirë		Mirë		Mjaftueshë		Gjithsej me no		Me 1 notë të		Me 2 nota		Me 3 e më sh		Gjithsej me not		Të pa notu	Të arsy	Të paars		Gjithsej	
			Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%						
10	9	221	29	13.12	42	19.00	57	25.79	16	7.24	144	65.16	24	10.86	31	14.03	2	0.90	4	1.81	20	9.05	2165	1734	3899	2.42
11	12	223	31	13.90	28	12.56	78	34.98	43	19.3	180	80.72	12	5.381	20	8.97	0	0.00	8	3.59	11	4.93	3177	1646	4823	2.77
12	10	218	31	14.22	24	11.01	67	30.73	95.1	43.6	200	91.74	6	2.752	1	0.46	0	0.00	7	3.21	10	4.59	7241	1888	6636	2.97
GJ	31	662	91	13.75	94	14.20	202	30.51	154	23.3	524	79.15	42	6.344	52	7.85	2	0.30	19	2.87	41	6.19	12583	5268	15358	2.72

DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale gjatë muajve janar- dhjetor 2022 në kuadër të përgjegjësisë të veta ka kryer punë dhe detyra të shumta duke përfshirë edhe menaxhimin me situatën e krijuar me Pandeminë COVID 19.

Takim me organizatën Islamic Relief Kosova ,ku është diskutuar për vazhdimësinë në ngritjen e kapaciteteve në fushën e shëndetësisë,në theks të veçantë temë diskutimi ka qenë ndërtimi i katit të dytë dhe të tretë në QKMF-Obiliq .

Takime me fondacionin e Katarit dhe OJQ-në “Qëndresa Kosovare” lidhur me donacionet e mundshme.

Rëntgeni digjital donacion nga shteti i Katarit dhe shoqata “Qëndresa Kosovar”.

Shtatë aparate të oksigjenit donacion nga shoqata Islamic Relief Kosova.

37 proteza të gjirit donacion për gratë e komunës së Obiliqit.

Një veturë donacion nga UNICEF në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë, veturë e cila ka për qëllim promovimin e shëndetit tek shtatëzanat dhe për fëmijët e moshës deri në tre vjet.

Memorandum bashkëpunimi në mes Kryetarit të Komunës dhe Qendrës për mbrojtjen e gruas dhe fëmijës,për mbulimin e shpenzimeve për strehimoren në Prishtinë në periudhën tri (3) vjeçare 2023,2024,2025.

Marrëveshje bashkëpunimi e lidhur në mes Kolegjit Alma Mater Europaea Campus Collage – Shkolla e Mesme e Mjekësisë “Rezonanca” dhe Komuna e Obiliqit për bashkëpunim në fushën e shëndetësisë,shkencë,arsimit,ku përfshihet edhe aspekti i punës praktike në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Obiliq ,nga ana e studentëve të këtij kolegji.

Marrëveshje bashkëpunimi në mes Islamic Relief Kosova dhe Komuna e Obiliqit, ku kybashkëpunimavanconofrimin e shërbimevemjekësore për qytetarëtanëpërmesangazhimit të 18profesionistëve shëndetësorë në projektin “Kujdesishtëpiak për lehonat, kujdesi për personat e moshës të tretë dhe me aftësi të kufizuar”.

Takime të rregulta me KFOR-in, në fokus ngritja e cilësisë shëndetësore me prioritet të veçantë në shërbimin e emergjencësi dhe mbështetjen e ligjerata dhe trajnime.

Rreth Pandemisë COVID 19,i gjithë personeli shëndetësorë si dhe stafi mbështetës kanë kryer detyrat dhe misionin e vet duke ofruar ndihmë mjekësore të gjithë pacientëve në kushte ambulatore, teren, në shtëpi dhe në çdo vend tjetër ku është kërkuar, dhe sipas nevojës transportin e pacientëve në klinikat e QKUK-së dhe anasjelltas.

Gjatë vitit 2022 nga personeli shëndetësorë kanë qenë njëzetë e gjashtë (26) të infektuar me virusin COVID19.

Që nga fillimi i Pandemisë 16 mars 2020 deri me datë 31.12.2022 janë testuar 7774 persona,

nga ta:

Gjithsej të testuar	7774
Kanë rezultuar pozitiv	4761
Të shëruar	4699
Kanë rezultuar negativ	3025
Të vdekur	62
Raste aktive	0

Të gjitha familjet e vetë izoluara janë kontaktuar nga Epidemiologia jonë. Janë rekomanduar për masat e vetë izolimit si dhe ju janë përsërit masat mbrojtëse të cilat duhen të ju përmbahen po ashtu të kërkojnë në mënyrë urgjente ndihmë mjekësore nëse kanë ndonjë shqetësim apo përkeqësim të gjendjes shëndetësore. Po ashtu që nga rasti i parë i paraqitur pozitiv me COVID 19 është ofruar mbështetje logjistike për të gjitha familjet e vet izoluara nga Kryetari i Komunës së Obiliqit.

Vaksinimi është realizuar sipas planit të vaksinimit të komunitetit për vaksinim.

Vaksinimi prej datës 15.11.2021 ka kaluar prej QVC “Xhavit Haziri” në QKMF –Obiliq në shërbimin e vaksinimit, pra vaksinimi me vaksinat kundër COVID 19 ,tani bëhet në QKMF-Obiliq.

Nga IKSHPK vazhdimisht jemi furnizuar me vaksinat kundër COVID 19 të llojit PFIZER.

Sasia e vaksinave të dhëna nga 07.04.2021 deri më 31.12.2022 në QKMF-Obiliq

LLOJI I VAKSINËS	DOZA	SASIA
AstraZeneca	doza e parë	1457
Astra Zeneca	doza e dytë	1352
Pfaizer	doza e parë	10963

Pfaizer	doza e dytë	10035
Pfaizer	doza e tretë	1234
Pfaizer	doza e katërt	13
Gjithsej		25054

Vaksinat e dhëna kundër gripit sezonal për vitin 2022 janë :953 .

AKTIVITETET-EVP NE KOMUNITETIN ROM,ASHKALI,EGJIPTAS – Sa i përket vaksinimit në teren organizuar nga QKMF, UNICEF, Balcan Sun Flowers në këtë periudhë u vaksinuan gjithsej 68 fëmijë.

Me vaksinim do vazhdohet edhe në muajt e ardhshëm, deri në përbushjen e objektivave të përcaktuara për imunizim të popullatës në masë, sipas rekomandimeve nga Komiteti për imunizim.

AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA

Këshilli drejtues i QKMF-së ka vazhduar me takimet ditore rreth rrjedhës së punës ,marrjen e tës ,marrjen e të gjitha masave për ngritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore ,mbajtjes së disiplinës ,orarit të punës.

Ka vazhduar organizimi i punës pa ndërprerje në ambulanten COVID 19 për ofrimin e shërbimeve shëndetësore të pacientëve të rezultuar pozitiv me virusin Corona ku është zbatuar orari i plotë,edhe përkundër mungesës së madhe të personelit shëndetësor arriti ti plotësojë kërkesat e qytetarëve.

Njoftim i vazhdueshëm rreth riorganizimit dhe rrezikshmërisë së përhapjes së virusit COVID19.

Shërbime shëndetësore, cilësore 24/7.

Gatishmëri e organizuar në ekipe mjekësore për transportimin e pacientëve të dyshuar dhe pozitiv me COVID 19.

Sigurimi i autoambulancës vetëm për rastet e infektuara me virus.

Mbështetje dhe asistencë me ekipe mjekësore në Aeroportin e Prishtinës.

Vizita të vazhdueshme monitoruese të gjitha njësive të QKMF-së.

Vizita në shtëpi për nënat shtatëzana dhe fëmijët deri në moshën tre vjeqare.

Furnizim me material shpenzues mjekësor.

Furnizim me material për shërbime laboratorike.

Furnizim me material ampular,stomatologjik,radiologjik dhe gjinekologjik.

Pranimi i testeve antigjene në QKMF.

Takime të vazhdueshme me menaxhmentin e QKMF-së.

Vaksinimi i rregullt për fëmijët e grup moshave të caktuara sipas kalendarit të vaksinimit si dhe vaksinimi i nxënësve.

Identifikimi i nevojave për përmirësimin e shërbimeve shëndetësore në kuadër të KPSH-së.

Identifikimi i nevojave për lehtësimin e punës së përditshme të personelit.

Dezinfektimi i QKMF-së, QMF, AMF .

Ndërprejja e pushimeve vjetore si dhe rritja e kritereve për pushime mjekësore.

Përgatitje teknike dhe administrative për hapjen e konkurseve.

Përgatitje e specifikave për procedura prokurimi.

Përmirësimi i infrastrukturës së institucioneve të KPSH, Inventarizimi.

Ekipet mjekësore të QKMF-së kanë asistuar dhe mbështetur aktivitetet kulturo-sportive.

Takime të përditshme me qytetarë.

Janë kryer punët e përditshme tekniko- administrative (fatura, kërkesa, etj.

Pranimi i kërkesave për nevoja sociale dhe shëndetësore Janar–Dhjetor 2022:

Të aprovuara	322
Të refuzuara	145
Gjithsej	467

Gjatë vitit 2022 janë pranuar 331 kërkesa të lehonave:

Të aprovuara	249
Të refuzuara	12
Në proces	70

Gjatë periudhës Janar - Dhjetor të vitit 2022 nga DSHMS janë iniciuar procedurat e prokurimit për projekte dhe shërbime tjera për nevojat e QKMF-së dhe QPS-së:

Furnizim me material higjenik	4,000.00 €
Realizim I projektit DDD	28,000.00 €
Furnizim me Oksigjen	2,000.00 €
Asgjësimit i barnave me afat të skaduar dhe mbetjeve mjekësore	8,874.00 €
Blerja e autoambulancave/veturave për nevoja të DSHMS,QPS	40,000.00 €
Pajisje mjekësore për QKMF	30,000.00 €
Renovim i objekteve në QKMF,QMF,AMF	5,000.00 €
Furnizim me material ampular në QKMF,QMF,AMF	15,000.00 €

RAPORTI I SHPENZIMEVE

RAPORT VJETOR(JANAR-DHJETOR 2022)

MALLRA DHE SHERBIME	SHPENZIM
Material gjinekologjik-radiologjik	2,930.00€
Material ampullar	5,991.15€
Material laboratorik	50,153.10€
Material administrativ	308.30€

Furnizim me material stomatologjik	17,493.25€
Furnizim me material higjienik	2,441.50€
Karburante për vetura	13,863.54€
Mirëmbajtja e dozimetrave	260.00 €
Mirëmbajtja e objekteve	2,705.65€
Vendime gjyqësore	7,966.85€
Servisim dhe mirëmbajtja	2,819.00€
Kryerja e procedurave doganore	300.00€
Shpenzimet internet	116.87€
Shërbime me aparat fotokopjues	115.31€
Regjistrimi i automjetit	465.00€
Furnizim me Oksigjen	2,000.00€
Dezinfektim,Deratizim,Dezinsektim Hapësinor	15,618.49€
Mirëmbajtja e automjetit	1,907.00€
Paga pas pensionimit	1,977.00€
Mirëmbajtja e parqeve	340.00€
Avans për para të imta	1,000.00€
Naftë për ngrohje qendrore	4,436.10 €
Shërbimet e autolarjes	516.82 €
Sigurim i automjetit	80.69 €

SHPENZIMET KOMUNALE**SHPENZIM**

Rrymë elektrike	23,262.64 €
Ujë	5,335.87€
Telefon	901.49€

INVESTIMET KAPITALE**SHPENZIM**

Renovim i objekteve në QKMF,QMF,AMF	3,850.60 €
Blerja e autoambulantave/veturave	37,780.00€
Paisje mjekësore për QKMF	29,750.00€

QKMF

Gjatë kësaj kohe Këshilli Drejtues i QKMF-së ka vazhduar me takimet ditore rreth rrjedhës së punës, marrjen e të gjitha masave për ngritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore, disiplinës, orarit të punës etj.

Në QKMF gjatë vitit 2022 janë trajtuar një numër i madh i pacientëve dhe janë ofruar një numër i konsiderueshëm i shërbimeve (shih tabelën)

NUMRI I PACIENTËVE DHE NUMRI I SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE

Nr.	QENDRA KRYESORE E MJEKËSIS	Numri i pacientëve	Numri i shërbimeve
-----	----------------------------	--------------------	--------------------

	FAMILJARE		mjekësore
1.	QKMF Obiliq	105911	275370
2.	QMF Milloshevë	6004	12765
3.	QMF Plemetin	2034	8176
4.	AMF Siboc	2576	8370
5.	AMF Breznicë	1989	4615
6.	AMF Babimoc	2736	8355
	TOTALI:	115250	317651

REFERIMET

(Janar – Dhjetor 2022)

QKMF -OBILIQ		Nr. i ref. <u>KONSUL TIME</u> në kujdesin tretësor	Nr. i ref. <u>DIA GNOS..k</u> ujd tretësor	Nr i ref. <u>QENDRA EMERGJ ENTE</u>	Gjithsej Udhëzime për Kujdesin tretësor	Nr. i përgjithshëm i vizitave mjekës..	Përqindja (%) e të referuarve në kujdesin tretësor	
	Njësia	Departamenti						
1	QKMF Obiliq	Mjekësi Familjare	5984	552	179	6715	46106	14.5 %
2	QKMF Obiliq	Emergjencia	192	0		1704	12009	14.1 %

					607			
3	QKMF Obiliq	Pediatria	1533	147	5	1715	7473	22.9 %
4	QKMF Obiliq	Gjinekologjia	214	0	0	214	2074	10.3 %
5	QKMF Obiliq	Shëndeti oral	52	357	0	443	3731	11.8 %
6	QMF Milloshevë	Mjekësi Familjare	810	80	36	967	5593	17.2 %
7	QMF Milloshevë	Shëndeti Oral	14	37	0	51	411	12.4 %
8	AMF Plemetin	Mjekësi familjare	4	15	0	19	2034	0.93 %

9	AMF Breznice	Mjekësi Familjare	240	9	9	276	1989	13.8 %
10	AMF Siboc	Mjekësi Familjare	298	39	4	349	2576	13.5 %
11	AMF Babimoc	Mjekësi familjare	736	55	0	791	2736	28.9 %
			10077	1291	840	13244	86732	15.2 %

Në tabelën e mëposhtme janë të dhënat për Sëmundjet masive jo infektive për muajin JANAR–DHJETOR 2022.

Të sëmundjeve masive jo infektive,

1.F00,F04,F05 ,F09,F20,F30,F31,F32.3,F33,F22,F29,F84,G71(shëndetit mental)

2.E10-E14,(sëmundjes së sheqerit)

3.I00-.I02,I20,I21,I24,I25(sëmundjeve kardiovaskulare)

4.N05(nefropatit)N03,N04,N05,N10,N18

5.J42,J45,J47 ,(sistemit respirator)

6.D65-D69,C-(sëmundje malinje),

Sëmundjet	Numri
I10	178
I20, I21, I24, I25	7
E10-E14	149
J42, J45, J47	12
N03, N04, N05, N10, N18	3
F00-F48	4
Sëmundjet malinje	11
Numri i referimeve në nivelin sekondar	10077
Numri i referimeve në diagnostikë	1291
Gjithsej pacientë	86732

Gjatë vitit 2022 janë dorëzuar gjithsej fletëparaqitje:

Sëmundje masovike jo ngjitëse	339
Sëmundje malinje	11

Raportimet ditore

Sëmundjet e traktit Respirator	9527
Sëmundjet e qarkullimit të gjakut	4985

RAPORTIMI I SËMUNDJEVE NGJITËSE

Nga sëmundjet ngjitëse Janar-Dhjetor 2022 janë raportuar nga mjekë keto sëmundje:

Nr.	Sëmundja	Raste
1.	Pneumonia	116
2.	Diare	668
3.	Variqellë	90
4.	Dyshim në grip	343
5.	Dyshim ne Naisseria gonorrhoea	1
6.	Dyshim ne tularemi	1

QKMF-OBILIQ 01.01.2022-31.12.2022

Raport i numrit të pacientëve sipas shërbimit nga Web Aplikacioni –QKMF

Njësi-Qendra kryesore e mjekësisë familjare	1880
Gjinekologjia	4592
Laboratori	38062
Mjekësia Familjare	5308
Pediatria	160
Rentgen	3483
Shëndeti Oral	2032

SHËRBIMET SHËNDETËSORE TË OFRUARA NË QKMF**DEPARTAMENTI I MJEKËSISË FAMILJARE**

Nr.	Spektori i Mjekësisë Familjare	Nr.i shërbimeve
1.	Numri i pacientëve të vizituar	46106
	Gjithsej shërbime	68273

Nr.	Raport rreth referimeve në mjekësinë familjare QKMF	Nr.i shërbimeve
1.	Numri i pacientëve të referuar	3014
2.	Numri i pacientëve si vizita të caktuara Z-76	3424
3.	Numri i pacientëve të referuar në diagnostikë	499
4.	Totali i pacientëve të referuar në kujdes dytësor dhe tretësor	6769
5.	Numri i pacientëve të referuar në Laboratorin e QKMF	5099
6.	Numri i pacientëve të referuar në Rëntgen + Ultrasonografi QKMF	1949
7.	Totali i pacientëve të referuar në diagnostikë QKMF	4195

Nr.	Këshillimorja për personat me Diabet Dhe Hipertension	Nr.i shërbimeve

1.	Nr. i pacientëve	803
	Gjithsej shërbime	2167

Nr.	Vizitat shtëpiake për Nënë dhe Fëmijët Deri Në Tri Vjet (Takime virtuale)	Nr.i shërbimeve
1.	Nr. i vizitave në shtëpi	989
2.	Nr. i fëmijëve të përfshirë në vizitë	1202
3.	Nr. i shtatzënave të përfshirë në vizitë	387
4.	Nr. i rasteve të Komunitetit Rom Ashkalinj të përfshirë në vizitë	926
5.	Puna në grupe “Klasat për Nëna”	2597

SEKTORI I KUJDESIT EMERGJENT

Nr.	Kujdesi Emergjent	Nr.i shërbimeve
1.	Numri i pacientëve të vizituar	12009
	Gjithsej shërbime	37531

SEKTORI I SHËNDETIT PUBLIK

Nr.	Njësia e SISH	Nr.i shërbimeve
1.	Numri i pacientëve të regjistruar	13779

Nr. Njësia e Vaksinimit dhe Imunizimit**Nr.i shërbimeve**

1. Numri i pacienteve ne qender dhe teren

5334

Nr.	Njësia e Vaksinimit dhe Imunizimit	Nr.i shërbimeve
1.	Dhënia e vaksinave	7301
2.	Shërbime tjera	2483
	Gjithsej shërbime	15118

SEKTORI I SHËNDETIT ORAL**Nr. Shëndeti Oral****Nr.i shërbimeve**

1. Numri i pacientëve

3731

Gjithsej shërbime

16111

SEKTORI KONSULTATIV

Nr.	Njësia e Pediatriisë	Nr.i shërbimeve
1.	Numri i pacientëve të vizituar	7473
	Gjithsej shërbime	7761

Nr.	Njësia e Gjinekologjisë	Nr. i shërbimeve
1.	Numri i pacientëve të vizituar	2074
	Gjithsej shërbime	3847

SEKTORI I DIAGNOSTIKËS

Nr.	Laboratori	Nr. i shërbimeve
1.	Numri i pacientëve	11671
	Totali i analizave të punuara	104269

	RTG	Nr. i shërbimeve
1.	Nr. i pacientëve	2281
	Gjithsej shërbime	5296

Nr.	Ultrasonografi	Nr. i shërbimeve
1	Nr. i pacientëve	4
	Gjithsej shërbime	8

Nr.	Barnatorja në QKMF,QMF,AMF	Nr. i shërbimeve

	Gjithsej pacientë	7401
	Gjithsej receta	12008
	Gjithsej shërbime	Fëmijë 2291 Të rritur 5110

MJEKËSIA FAMILJARE NË TEREN

Nr.	QMF Milloshevë	Nr. i shërbimeve
1.	Numri i pacientëve të vizituar	5323
	Gjithsej shërbime	11534

Qëllimi i shpalljes me Interes të përgjithshëm publik për objektet të cilat gjenden në parcelën e lartëcekur është se këto objekte teknikisht janë në gjendje jo të mirë po ashtu janë edhe jashtë funksionit për veprimtarinë e destinuar dhe të njëjtat paraqesin rrezik për banorët e asaj zone dhe kalimtarët e rastit .

Gjatë Vitit Janar-Dhjetor 2022 kemi pas gjithësejt 1388 - kërkesa për lëndë të ndryshme dhe ate:

1	<i>Kontrata të Shitblerjes</i>	226
2	<i>Kontrata për ndarjen e paluajtshmërisë</i>	10
3	<i>Aktvendime të Trashëgimisë</i>	56
4	<i>Regjistrim i Hipotekës</i>	44
5	<i>Fshirje e Hipotekës</i>	34
6	<i>Kontrata të (Faljes)Dhurim</i>	133
7	<i>Parcelizim (Ndarje)</i>	117
8	<i>Bashkim</i>	37
9	<i>Kthim i Kufijve</i>	00
10	<i>Regjistrim i Objektivit</i>	104
11	<i>Regjister i Kordinatave</i>	117
12	<i>Regjistrim i Masës së Përkohshme</i>	2
13	<i>Modifikim për Person</i>	163
14	<i>Vendim Gjyqësor</i>	8
15	<i>Lirim nga Masa e Përkohshme me vendim të Gjykatës</i>	1
16	<i>Kontrata të Këmbimit (Ndrimit)</i>	5
17	<i>Parcelizim dhe rregullim i kufirit</i>	6
18	<i>Vendim Përfundimtar</i>	25
19	<i>Historiat i Pronës</i>	4
20	<i>Modifikim i Hipotekës</i>	3

21	<i>Qiramarrje për 99 vite</i>	5
22	<i>Vendim për mbajtjen e Përjetshme</i>	1
23	<i>Lirim nga Përmbaruesi</i>	1
24	<i>Azhurnim i gjendjes në Grafik</i>	00
25	<i>Dhënie në Shfrytëzim KK Obiliq</i>	00
26	<i>Regjistrim i ndërtesës</i>	00
27	<i>Regjistrim i Barrës Tatimore</i>	2
28	<i>Lirim i Barrës Tatimore</i>	5
29	<i>Marrëveshje për Ndërmjetësim</i>	31
30	<i>Ankesa</i>	5

	<i>Cert.palujtshmërisë</i>	<i>Kopje Plani</i>	<i>Cert.gjendje pronësore</i>
<i>Kërkesa</i>	1745	1295	573

Të realizuara	1694x4	1248x4	131x3
Procedurë	0	0	0
Me bllok	1	1	0
Të lirume	50	46	442
totali	6776€	4992€	393€
Totali i përgjithshëm	12,161€		

Te Hyrat Gjatë Vitit Janar –Dhjetor 2022

Gjeodezi Pronë dhe Kadastër janë: 45,544 € + 12,161€ = 57,705€ .

-Numri i Bartjes së Pronës në emër të dy Bashkëshortëve ka qenë 25 ;

-Numri i Bartjes së Pronës në emër të Burrave 314 dhe;

- Numri i Bartjes së Pronës në emër të Grave 31 .

-SEKTORI I KADASTRIT-

- Si pik nisje Sektori i Kadastrit kujdeset për respektimin e ligjeve dhe mban përgjegjësi në ligjet e Kadastrit dhe udhëzimeve administrative të nxjerra nga AKK, dhe së bashku me Agjencinë Kadastrale të Kosovës krijojnë metoda në avansimin e metodave të punës.

- Gjatë këtij viti kemi punuar në realizimin e të gjitha kërkesave për qytetarët e Komunës, varësisht prej llojit dhe natyrës së kërkesave të qytetarëve.

- Zhvillimin e procedurave të regjistrimit , sipas detyrës zyrtare dhe kërkesës së palëve;

- Korrigjimin e regjistrimit (SIKTK-së) sipas procedurave dhe zbatimin e të gjitha dispozitave ligjore në fuqi;

- Regjistrimin e pronave te palujtshme dhe regjistrimin e pronave komunale;
- Azhurimin e pronave ,në bazë të dokumentacionit të lëshuara nga Gjykatat, Noterët, Përmbaruesit si dhe organet përgjegjëse, Vendimet e Kuvendit, Vendimet nga AKK si dhe vendime tjera etj;
- Zbatimin e procedurave rreth transaksioneve të pronave private dhe shoqërore në SIKTK-së
- Shqyrtimin dhe kryerjen e procedurave administrative për rikthimin e palujtshmërisë ish-pronarit, evidentimin dhe shlyerjen e masave të përkohshme sipas aktvendimit të gjykatës kompetente;
- Udhëheqjen me kadastrë etazhë të banesave ,ndërtesave , pjesëve të ndërtesave si dhe ngastrat kadastrale në të cilat janë ndërtuar banesat;
- Regjistrimin dhe çregjistrimin e hipotekave ; Aktvendimeve mbi regjistrimin e servituteve, regjistrimin e barrave tatimore;
- Lëshimin e certifikatave personave që nuk kanë patundëshmëri, çertifikatave mbi të drejtat e pronës së palujtshme si dhe kopje planit;
- Mirmbajtjen, korigjimin dhe harmonizimin e evidencave të vendbanimeve ,fshatrave ,shesheve,rrugëve dhe numrat e objekteve dhe ndërtesave;
- Nxerrjen e aktvendimeve për miratimin dhe ndarjen e parcelave, Legalizimin e ndërtesave bashkimin e parcelave modifikimin e atributive të parcelave, ndërtesave pjesëve të ndërtesave apo refuzim të kërkesave;
- Nxerrjen e konkluzioneve për plotësimin e kërkesave të pakompletuara;
- Përgaditjen e projektprogramit të punës për nevojat e Drejtorisë dhe raportin e punës;
- Punë të tjera në pajtim me dispozitat ligjore(shpalljet publike, kërkesat për nevojat e Kuvendit, të gjykatave dhe institucioneve tjera).
- Zhvillimin dhe organizimin e sistemeve kadastrale, rikonstruimin e informatave kadastrale në formë digjitale , modelin e sistemit informatik për tokën dhe pronën;
- Regjistrimin e ndarjeve të parcelave dhe modifikimin e atributive të parcelave, ndërtesave dhe pjesëve të ndërtesave.
- Kryerjen e punëve profesionale , të cilat dalin nga shërbimi gjeodezik (ndryshimet e bëra gjatë matjeve nga Hartat e Kosovës dhe bartjen e tyre në programin e SIKTK-së.
- Kryerjen e shërbimeve për shënimet e digjitalizuara (dhënien e kordinatave për teren);
- Si dhe Shërbime profesionale dhe shërbime të tjera ,për subjekte dhe institucione të ndryshme;
- Si dhe për fund kemi marr pjesë në trajnime, seminare të ndryshme për zhvillimin e njohurive që të jemi sa më transparent në kryerjen e shërbimeve ndaj qytetarëve të Komunës.
- Në përfundim të këtij raporti për vitin 2022 konstatojmë se kemi arrit t'i përfundojmë varësisht prej natyrës së lëndëve, Kontrata shitblerje, Kontrata Falje, Kontrata për ndarjen fizike, Regjistrim të Hipotekave,Fshirje

të Hipotekave, Aktvendime nga MMPH-ja, Vendime të Ndërmjetësuesëve, Aktvendime të Trashëgimisë, Aktvendime të gjykatave, Masa të sigurisë nga Gjykata, Regjistrim të barrëve tatimore, ndarje të parcelave, Legalizimin e ndërtesave, Bashkimin e parcelave, modifikimin e attributeve të parcelave, ndërtesave pjesë të ndërtesave apo refuzim të kërkesave Vendime të ndryshme, Kërkesa të ndryshme, Çertifikata mbi të Drejtat e Pronës se Paluajtshme, Kopje Plani, Certifikata që nuk posedojnë Pronë duke ardhur në përfundim se gjatë vitit kemi realizuar gjithsejtë 4747 kërkesa.

-SEKTORI I GJEODEZISË-

Raporti përmban një përmbledhje në vijë të trasha të punëve gjatë vitit 2022. Në raport do të përfshihen punët e përfunduara nga sektori në aspektin profesional sipas kërkesave të parashtruara nga ana e drejtorive të KK Obiliq të cilat lidhen drejtpërdrejt me punë profesionale në terren e që janë situacione të ndryshme për nevojat e projektimit, matje të parcelave – kufijeve për ndërtimin dhe planifikimin e rrugëve, elaboratet e shpronësimit dhe identifikime të ndryshme me matje.

Në cilësinë e anëtarit të komisionit për caktimin e kushteve ndërtimore është punuar shumë në vitin 2022 pasi që natyra e punës kërkon dalje në terren në vendngjarje dhe në rastet kur punët kanë filluar realizojmë matje gjeodezike për të përcaktuar pozicionin e sakt të objektit. Pas vendshiqimit të terrenit përpilohet raporti si dhe në rast të matjeve bëhet përpunimi i të dhënave në formë të skicës duke i krahasur të dhënat me gjendjen në kadastrë mbi pozicionin e objektit.

Pasqyra e lendeve të përfunduara në kuadër të mirëmbajtjes së rregullt të kadastrit do të paraqitet me një tabelë të veçantë dhe do të bashkohet këtij raporti ndërsa ky raport me shkrim do të përfshijë vetëm punët dhe shërbimet që janë kryer sipas kërkesave të Drejtorive brenda Komunes.

Ne cilesin e anetarit te komisionit per caktimin e kushteve ndertimore eshte punuar ne gjithesejt 54 lende gjate vitit 2022,ne disa prej lendeve jane bere matjet per percaktimin e pozicionit te objekteve dhe jane punuar skicat se bashku me raportin e komisionit.

Raporti permban punet nga lemia e puneve inxhinjerike gjeodezike per projekte te ndryshme komunale ndersa punet ne lemin e mirembajtjes se rregullt te kadastrit do ti paraqesim ne forme tabelare per qdo zone kadastrale si dhe totali i lendeve te perfunduara ne vitin 2022.

Gjate vitit 2022 eshte punuar shume ne legalizimin e objekteve sipas ligjit per legalizim,objektet te cilat marrin Vendimin per Çertifikate te Legalizimit rexhistrohen ne pjesen grafike dhe tekstuale te Kadastrit,ne kete proces jane legalizuar objekte ne baze te Vendimit per Certificate te Legalizimit gjithesejt sipas zonave kadastrale me sa vijon:

- zk Babimoc.....5 (Pese) objekte
- zk Bakshi.....4 (kater) objekte
- zk Breznic.....1 (nje) objekte
- zk Grabovc I Eperm.....6 (gjashte) objekte
- zk Krushevc.....1 (nje) objekte
- zk Mazgit.....6 (gjashte) objekte
- zk Millosheve.....15 (pesembedhete) objekte
- zk Obiliq.....46 (dyzetegjashte) objekte
- zk Plemetin.....8 (gjashte) objekte
- zk Raskove.....1 (nje) objekte

Gjithesejt **93 objekte** te rexhistruara ne kadaster ne procedure te legalizimit. Ndersa ne procedure te rregullt ne baze te lejes ndertimore dhe aktvendimit per certificate te perdorimit jane rexhistruar gjithesejt 15 objekte

Pasqyra e puneve sipas zonave

Ne zk Obiliq jane bere matjet te qendra tregtare per te konstatuar siperfaqet e teresishme te objekteve brenda te cilave ka njesi te ndara ne lokale,per te gjitha objektet jane punuar skicat ndaras ne baze te njesive sipas etazhave matjet e gabariteve te objekteve gjithesej 4 (kater)jane bere me instrument

gjeodezik GPS Trimble R-8 duke shfrytezur metodat matematikore te percaktimit te pikave me ane te rrateve,ndersa njesit e objekteve jane matur me metershirit.

Me kerkesen e Drejtorise se Infrastruktures jane bere matjet e situacionit gjeodezik te stadiumit ndihmes per futboll per te mundesur projektimin ne zgjerimin dhe modernizimin e stadiumit ndihmes kjo eshte bere ne bashkpunim me perfaqesuesit e Federates se Futbollit te Kosoves.

Gjithashte ne zk Obiliq te Subotiqet jane bere matjet e kanalizimit per nevoja te projektimit kersa e bere nga ana e Drejtorise se Infrastruktures.

Matje te terenit per nevoja te rregullimit te kanalizimit te lokacioni Xhamia e Qytetit Obiliq.

Ne Llazareve me kerkesen e drejtorise se Infrastruktures jane bere matje te situacionit te terenit ne pronen komunale per hartimin e projektit te fushes sportive,gjithashtu jane bere matjet ne percaktimin e kufijeve te rruges te zona industrial Llazarev.Me kerkesen e Komues eshte punuar ne bashkimin dhe ndarjen e parcelave te zona e biznesit 2.Matjet jane bere me instrument gjeodezik GPS Trimble ndersa ndryshimet jane rexhisruar ne pjesen grafike te kadastrit Hartat e Kosoves dhe ne pjesen tekstuale Sistemi Informativ I Tokave te Kosoves.

Ne zk C Vodica jane bere matjet e kanalizimit ne gjatesi 600 per nevoja te Drejtorise se Infrastruktures te lumi Sitnica dhe prrocka e fshatit C Vodice,keto matje jane bere per mundesi te rregullimit te shkarkimit te kanalizimit ne lumin Sitnica.

Ne Mazgit jane bere disa matje ne percaktimin e kufijeve te rrugeve me kerkesen e drejtorise se infrastruktures.

Me kerkesen e paleve jane bere matjet e gjendjes faktike te parcelave tabela 159 zone e komasacionit studimi eshte bere duke krahasuar gjendjen faktike me gjendjen ne kadaster.Lidhur me kete qeshtje jane mbajtur disa takime me qytetere pronare te parcelave ne studim.

Ne Millosheve matjet e rruges qe shpie nga obiliqi i vjeter ne Millosheve

Ne Plemetin jane bere matje ne cilesin e anetarit te komisionit per kushte ndertimore,gjithashtu pa pase kerkese nga drejtoria e onfrastruktures per matje te parcelave te sitnica per nevoja te ndertimit te ures per komunitetin e fshatit Plemetin.Ne kete qeshtje ka pase disa dalje ne teern me kerkese te Drejtorise se Infrastruktures.

Ne zënk Bakshi janë bere matjet ne percaktimin e kufijeve te rruges per nevoja te punimit te rruges nga ana e Drejtorise se Infrastruktures.

Te gjitha punet e pershkruara me larte kerkojne pune pregaditore ne zyre dhe pune ne perpunimin e te dhenave ne formen digjitale te cilat marrin kohe te konsiderushme ne finalizim e situacioneve dhe skicave varesisht prej natyres se punes.

Jane mbajtur shume takime ne lidhje me hartimin e Hartes Zhvillimore Komunale ne te ciliet takime kane marre pjese perfaqsesit e kompanis implementuse te projektit dhe aneteret e komisionit nga Drejtorite Komunale.

Me kerkesen e paleve janë bere shume studime te parcelave kryesisht per aresye te mungeses se shenimeve kadastrale te pjeses grafike

Gjate viti 2022 ka pase mjaftë kerkesa zyrtare nga palet per matje kadastrale kryesisht ne percaktimin e kufijeve te rruges gjate punimit te rruges.

Pune ne cilesin e anetarit te komisionit per pranimin teknik te projekteve komunale.

Ne pjesen grafike te kadastrit te gjitha kerkesat – lendet qe dorezohen per regjistrim te ndarjeve te parcelave,bashkimt te parcelave,rexhistrimit te objekteve,perkufizit te kufijeve te parcelave,rexhistrim te shpronesit ne baze te vendimeve perfundimtare i nenshtrohen kontrrolit para se te behet rexhistrimi ne pjesen grafike dhe ate tekstuale.

Gjithashtu ne mungese te stafit per legalizim te objekteve siaps ligjit per legalizimin e objektev sektori yne bene kontrollimin e lendeve para regjistrimit ne aplikacionin Hartat e Kosoves dhe SIKTK.

Ne cilesin e aneterit te komisionit per caktimin e kushteve ndertimore gjate vitit 2022 ka pase gjithesejt **54** lende te cilat janë shqyrtuar brenda afatit te parapare me ligj.

RAPORTI VJETOR 2022

Pasqyra vjetore e lendeve nga Rexhistri i Fleteparaqitjes 2022						
Zona Kadastrale	Ndarje	Bashkim	Shpronsim	Korigjim Kufirit	Ndertesa	Total

Babimoc	11	3	1	-	5	20
Bakshi	1	-	-	-	4	5
Breznica	3	2	-	-	1	6
Caravodic	2	1	-	-	-	3
Graboc i Eperm	1	1	-	-	6	8
Hade	3	1	-	-	-	4
Hamidi	1	-	-	-	-	1
Kryeshevc	12	3	-	1	1	17
Leshkoshiq	1	-	-	-	-	1
Llazarevë	3	2	2	-	-	7
Millosevë	11	2	-	1	18	32
Mazgit	14	5	3	2	8	32
Obiliq	30	8	-	2	56	96
Plemetin	7	2	-	-	8	17
Raskovë	4	-	-	-	1	5
Sibovc	11	7	-	-	-	18
Shipitullë	2	-	-	-	-	2
Total	117	37	6	6	108	274

-SEKTORI I URBANIZMIT-

-Gjatë vitit 2022 sektori i **urbanizmit** në kuadër të DPUPK ka qenë i ngarkuar me punë të natyrave të ndryshme që kanë qenë të paraparë me planprogram si ato në zgjidhjen e kërkesave të palëve, përgjegjësit brenda Komunës, pjesmarrjet në takime jashtë komunës, pastaj trajnimet e ndryshme, e shumë punë të tjera të lidhur me këtë sektor, ku të gjitha këto fushëveprime janë përmbyllur me sukses gjatë tërë vitit.

-Plotësimi i formularëve të performancës për vitin 2022, e cila përsëritet qdo fundvit, kërkesë e MAPL.

-Pjesmarrja në trajnimin për Planifikim Hapësinor e organizuar nga GIZ dhe Asociacioni i Komunave lidhur me aplikimin si dhe analizën në zbatimin e Ligjit dhe Udhëzimeve Administrative në fushën e Planifikimit Hapësinor, ku ne si sektor së bashku me komunat tjera kemi takime të përherëshme që një periudh të gjatë kohore në mënyrë që proceëdura Ligjore të zbatohet në përpikmëri.

-Së bashku me USAID-in kemi arritur që ndër të parat komuna të kemi transparencë në publikimin e lejeve ndërtimore në faqen zyrtare të Komunës respektivisht në kuadër të DPUPK-së.

-Takim dhe Komunikime të përherëshme me USAID lidhur me procedurat e trajtimit të lëndëve për legalizim të objekteve pa leje si dhe njohja me programin për regjistrimin e lendeve në sistem për procedurat e legalizimit të objekteve, kemi mbështetjen nga Usaid sepse është bërë memorandum bashkëpunimi ndërmjet kryetarit dhe USAID pasi kemi dalë me performancë shumë të mirë në si sektor lidhur me aplikimin e këtij Ligji si dhe trajtimin e lëndëve të legalizimit.

-Puna e vazhdueshme në Hartimin e Planit Zhvillimor të Komunës, takimet me kompanit e ndryshme, takimet me komision, me grupet e interes, një punë intensive me përgjegjësi maksimale. Me vërejtjet në dokumentin e PZHK-së nga MMPHI ,takimeve të njëpasnjëshme me stafin e MMPH-në, me sekretarin e përhershëm, me Ministrin e MMPHI-së duke u munduar t'i harmonizojmë idet tona me interesat e përbashkëta në jetësimin e këtij dokumenti që është obligim nga Ligji i Planifikimit Hapësinor në përputhshmëri të plotë me rregullativën ligjore dhe Normat e Planifikimit.

Përmes këtij Plani Zhvillimor Komunal jemi munduar të përcaktojmë vizionin, parimet, objektivat dhe prioritetet e zhvillimit strategjik mbi të cilat do të bazohet hartimi i Hartës Zonale të Komunës.

Ky dokument i planifikimit hapësinor bazohet në parime të qarta duke bërë promovimin e interesave të përbashkëta të qytetarëve të Komunës sonë, duke mbrojtur burimet natyrore, trashëgiminë kulturore dhe përkrahur zhvillim të qëndrueshëm të të gjitha sferave.

Në kuadër të këtij projekti Komuna e Obiliqit ka formuar komision profesional të përbërë nga anëtarë të të gjitha drejtorive të KK Obiliqit si dhe duke kyqur edhe akterët tjerë që janë të atakuar me këtë projekt të cilët kanë dhënë kontributin e tyre shumë të qmueshëm mirëpo barrën kryesore e ka bartuar DPUPK-ja .

Si kompani konsulente në hartimin e këtij dokumenti përmes procedurave të prokurimit kemi pasur kompanin konsulente “INSI”, ku së bashku kemi bërë një punë mjaft voluminoze dhe produktive në mënyrë që ky projekt në të ardhmen të jetë i zbatueshëm në praktikë dhe t’i plotësoj të gjitha kriteret e nevojshme për zhvillimin e komunës së Obiliqit e cila është një nga komunat me ambientin dhe reliefin më specifik të Republikës së Kosovës duke pasur parasysh KEK që shfrytëzon një % të madhe të territorit të komunës së Obiliqit, zona me interes nacional, komasacionin, si dhe shumë akter të tjerë që përfshihen në komunën tonë.

Për realizimin e këtij projekti kemi filluar me punë nga maji i vitit 2019 (me shumë pauza siq ishte koha e Pandemis covid2019) duke vazhduar me takime të njëpasnjëshme me të gjithë akterët të kyqur direct apo indirect me interes të përbashkët duke harmonizuar projektet e përbashkëta në planin zhvillimor të Komunës 2022-2030 e duke kaluar nëpër çdo fazë të përcaktuar me ligjin e planifikimit hapësinor Nr.04/L-174.


Po e fillojmë në mënyrë kronologjike me prezentimin e tabelës së mbajtjeve të gjitha takimeve lidhur me PZHK-në:

Vendi i Takimit	Data	Numri i pjesëmarrësve	Qëllimi i Takimeve
Zyra e Kryetarit	23.05.2019	15	Kryetari dhe ekzekutivi
Kuvendi Komunal	28.05.2019	18	Njoftimi me procedurat për hartimin e PZHK
Kuvendi Komunal	12.06.2019	16	Njoftimi edhe i akteret tjerë kyq në hartimin e PZHK
Kuvendi Komunal	05.10.2019	20	Njoftimi i komisionit me detyrat e punës

Kuvendi Komunal i Obiliqit	23.12.2019	26	Prezentimi I profilit të Komunës
Zyra e kryetarit	22.01.2020		Kryetari dhe ekzekutivi
Kuvendi Komunal i Obiliqit	28.01.2020	26	Prezentimi I skenarëve të zhvillimit
Zyrat e KOSTT	05.02.2020	8	Harmonizimi I interesave dhe projekteve të përbashkëta në të ardhmen
INFRAKOS	05.02.2020	10	Harmonizimi I interesave dhe projekteve të përbashkëta në të ardhmen
KEK	06.02.2020	8	Harmonizimi I interesave dhe projekteve të përbashkëta në të ardhmen
KEDS	10.02.2020	8	Harmonizimi I interesave dhe projekteve të përbashkëta në të ardhmen
Breznicë	18.02.2020	8	Takim me qytetarë për hartimin e PZHK-së
Babimoc	18.02.2020	8	Takim me qytetarë për hartimin e PZHK-së
Milloshëvë	18.02.2020	12	Takim me qytetarë për hartimin e PZHK-së
Raskovë,Bakshi	18.02.2020	6	Takim me qytetarë për hartimin e PZHK-së
Mazgiti ulët, Mazgit I lartë, Llazarevë,Dardhishtë	19.02.2020	9	Takim me qytetarë për hartimin e PZHK-së
Kuvendi komunal I Obiliqit	21.02.2020	18	Takim me qytetarë për hartimin e PZHK-së, qytetarët e Obiliqit të ri, Obiliqi I vjetër

			dhe Plemetin
Hade, Palaj,Lajthishtë, Siboc,Hamidi,Shipitullë, Graboc	25.02.2020	12	Takim me qytetarë për hartimin e PZHK-së
Kuvendi Komunal i Obiliqit	19.05.2020	14	Takim me kryetarin dhe drejtorët lidhur me njoftimin e punës rreth PZHK dhe prezentimi i Vizionimit
Hotel “Amazona” Babimoc	12.06.2020	31	ËSH I Vizionimit
Hotel “Amazona” Babimoc	13.06.2020	28	ËSH I Vizionimit
Halla sportive “Adem Jashari” Obiliq	15.07.2020	25	VSM

Takime me përfaqësuesit e kompanisë konsultente “INSI” para Kryetarit të komunës dhe ekzekutivit komunal së bashku me kordinatorin e projektit dhe menaxherin e projektit janë diskutuar për hapat dhe procedurat që duhet të kalohet për realizimin e duhur të këtij plani.



Pastaj është mbajtur takimi i grupit punues për hartimin e Planit Zhvillimor nën udhëheqje të Drejtorit të DPUKP-së, Arben Berisha Koordinator.

Ky takim kishte për qëllim prezantimin dhe kordinimin e grupit punues për hapat e mëtutjeshëm të hartimit dhe realizimit të Planit Zhvillimor.





Takimi i radhës është mbajtur me të gjithë anëtarët e Komisionit, përfaqësuesit e kompanisë "INSI" si dhe të gjithë akterët tjerë të kyqur direkt apo indirekt në hartimin e Planit Zhvillimor të Komunës së Obiliqit, duke shkëmbyer përvojat dhe duke marrë detyrat dhe përgjegjësitë të gjithë anëtarët pjesmarrës të projektit.



Në kuadër të procesit të hartimit të PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL TË OBILIQIT Komuna e Obiliqit përmes njoftimit publik ka ftuar qytetarët të marrin pjesë në procesin e hartimit të profilit komunal.

Takim është mbajtur me qëllimi të informohej publiku se çka përmban një Plan Zhvillimor Komunal dhe si do kyçen akterët në proces.



Republika e Kosovës
 Republika Kosovo - Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada Government



Komuna Obiliq - Opština Obiliq - Municipality Obiliq
 Drejtoria për Planifikim Urban, Prindje dhe Kadarë

NJOFTIMI PUBLIK

Në kuadër të procesit të hartimit të PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL TË OBILIQIT

Pelencë të marrëni pjesë në diskutimet publike

nësin fillimisht të procesit të hartimit të PLANIT KOMUNAL

Komuna e Obiliqit, Drejtoria për Planifikim Urban, Kadarë dhe Prindje në bashkëpunim me të gjitha institucionet tjera komunale dhe nën-përfshirjen profesionale cilësive të kompanisë "DIP" hartues të planit dhe Teknologji, Prindje, kanë filluar punën për hartimin e Planit Zvillimor Komunal të Obiliqit. Ky është një dokument themelor i rëndësishëm për komunën e Obiliqit ashtu si dhe për të gjithë qytetarët, përfaqësuesit e shoqërisë civile, institucionet e shtetit qendror dhe lokal në këtë prezentim dhe diskutim publik për Planin e Komunes, ku do prezantohet vetëm dokumenti fillestar i cili përmban informata digjitale dhe nismë të prezantimit gjendjen aktuale komunale. Në këtë prezentim të parë publik do prezantohet kështu ligjvënës dhe procesi për të cilat edhe mund të diskutohet.

Talëni ka për qëllim informimin e publikut, por edhe të diskutohet nëse ka përdorim të Plan Zvillimor Komunal dhe si do llogarë shpirtit të punës.

Ky Plan përfillimisht të gjithë territorin e Komunës së Obiliqit, nënë shtetë sipë qytetit e Obiliqit, por edhe të gjitha zonat rurale.

Për informata shkurtrë, mund të lajmëroheni në Drejtoria e Planifikimit Urban, Kadarë dhe Prindje.

Talëni shtetë në shtet të komendit komunal të Obiliqit me datë **08 Nëntor të vitit 2022, ora 14:00**.

Numeri kontaktues (Drejtoria): 044 256042

o mail adresë për kontakt në Drejtoria: Arben.Berisha@obiliq.gov.net, Arshita.Berisha@obiliq.gov.net

Më repretë Komuna e Obiliqit, dhe "DIP"





Në këtë takim ishin pjesmarrës përveq stafit punues dhe anëtarëve të MMPH-së edhe qytetarë të Komunës së Obiliqit.

Qytetarët patën kërkesa të ndryshme, lidhur me mbrojtjen nga ndotja e ambientit, pastaj kërkuan që të parashihen projekte kapitale mvarësisht vendeve se nga vinin, poashtu edhe shqetësimet në dislokimin e banorëve nga Zona e Interesit Ekonomik.

U njoftuan banorët se do të bëhet maksimumi në mënyrë që të bëjmë zgjedhje në kërkesat e banorëve së bashku me akterët e tjerë që influencojnë në komunën tonë, pasi kemi pasur prezent edhe përfaqësuesin e Ministrisë së Ambientit, e poashtu edhe përfaqësuesit e KOSST-it, KEDS-it, KEK-ut, INFRAKOS-IT, të cilët janë akterë kyq në harmonizimin e interesave të përbashkëta.





Grupi punues i Planit Zhvillimor Komunal mbajti takimin e radhës ku bënë prezentimin e skenarëve të Zhvillimit të komunës, ku puna është bërë me përkushtim nga grupi punues i këtij plani i udhëhequr nga drejtori i DPUKP-së, Arben Berisha, pjesmarrës ishin edhe akterët kryesor që operojnë në Komunën tonë, si KEK-u, KEDS-I, KOSST-I, INFRAKOS-I, përfaqësues të “IBER-LEPENCIT”, bizneset dhe OJQ-të e Komunës së Obiliqit, të cilëve iu është prezantuar pjesa konceptuale e fazës së skenareve të zhvillimit të qytetit të Obiliqit.

Pjesmarrësit e operatorëve paraqitën projektet e veta që parashihen në Komunën tonë, duke kërkuar që të përfillen kërkesat e tyre në mënyrë që të mos bien ndesh në të ardhmen me Planin Zhvillimor të Komunës së Obiliqit



Pastaj është bërë njoftimi public lidhur me takimet që do të mbahen nëpër të gjitha lokalitetet, respektivisht tërë teritorine Komunës së Obiliqit që do të mbulohet me Planin Zhvillimor.



NJOFTIM PUBLIK

Në kuadër të procesit të hartimit të PLANIT DITËVJETOR KOMUNAL TE OSHARIT
 Për vitin të ardhshëm për vitin 2022

me qëllim të përcaktimit të NEJESHËRIVE TE DITËVJETORIT TE KOMUNALIT

Komuna e Prishtinës, Drejtoria për Planifikim Urban, Kërkim dhe Promovim të Shtetit në të gjithë territorin të komunës dhe në përfshirje profesionale të kompanisë "DIP" bashkë me kompaninë e teknologjive të informacionit "Pulsnet", kanë filluar procesin e hartimit të Planit Ditëvjetor Komunal të Osharit. Ky plan i ri do të përcaktojë nevojat dhe prioritetet për Komunën e Prishtinës në të gjithë aspektet, përfshirë punën dhe shërbimet, veprimet dhe veprimet që duhen të bëhen në tërësi dhe në detaje publike të Komunitetit të Komunitetit, ku do të përcaktohet dokumenti i cilësorisë së shërbimit dhe cilësorisë së punës që duhet të ofrohet në tërësi dhe në detaje publike të Komunitetit të Komunitetit. Në këtë proces informata digjitale dhe burime të punës që përfshihen në shërbimet komonale. Në këtë proces do të përcaktohet cilësoria dhe cilësoria e shërbimit të Komunitetit të Komunitetit dhe cilësoria e shërbimit të Komunitetit të Komunitetit.

Talenti ka për qëllim informimin e publikit, për efekt të diskutimit dhe të përcaktimit të Planit Ditëvjetor Komunal dhe të cilësorisë së shërbimit të Komunitetit të Komunitetit.

Ky plan përfshin të gjithë territorin e Komunitetit të Komunitetit, meqë është qyteti i Prishtinës, për efekt të cilësorisë së shërbimit të Komunitetit të Komunitetit.

Për informata shtesë, mund të kontaktoni në Drejtoria të Planifikimit Urban, Kërkim dhe Promovim.

Talenti do të mbahet në këto vende:

DATA 18.02.2022

- BRESNICE/NOVARICE
- SHKOLLA FILLORE "NAIM FRASHËRI" BRESNICE - ORA 14⁰⁰**
- BILIMIRI/LEKAVOVI, BAKHURJANACI
- SHKOLLA E KULTURISË "E ADIL SHIBI" - ORA 16⁰⁰**

DATA 19.02.2022

- MAZGËT LLAZARIVË
- SHKOLLA FILLORE "OSMAN RAHMANI" MAZGËT LLAZARIVË - ORA 13⁰⁰**
- DARRËSHITË
- SHKOLLA FILLORE "ABDULLAH GJORGJI" DARRËSHITË - ORA 13⁰⁰**

DATA 20.02.2020	
-LAJTIHITË, HARRDUSHOC, DALAJJADIT	
SIBKCELA PËLACRE "MIGJIST" -SIBOC	-ORA 140'
-SIBTULLË, GRABOC	
SIBKCELA PËLACRE "MIGJIST" -GRABOC	-ORA 100'
DATA 21.02.2020	
ORILAQ, ORILAQ I VETËR, PLEMEDIN	
SALLA E KUVENDIT -ORILAQ	ORA -1400'

Shërbimi Kontaktues i Drejtorisë: 044 238062

e-mail adresa për kontakt me Drejtues: Arben.Berisha@rko.gov.net, Merita.Streha@rko.gov.net

Me respekt Komuna e Obiliqit, "1991"

DREJTUES I DEPUTË -
 ARBEN BERISHA



Takimi I parë është mbajtur në **fshatin Brezhticë**.

Në këtë takim morën pjesë edhe banorët e fshatit Kozaricë. Qyetarëve të këtyre fshatëve i është prezentuar planifikimi që është bërë në Planin Zhvillimor të Komunës për teritorin e tyre

Aty morën pjesë një numër i konsiderueshëm i banorëve, duke shprehur brengat dhe kërkesat e tyre.

Si zonë kryesisht malore, banorët kërkojnë që në fshatin Kozaricë të parashihet një park rekreativ në mënyrë që kjo pjesë të shrytëzohet për rekreacion dhe turizëm, poashtu kërkojnë që të kenë qasje përmes një lidhje me sistemin e ujitjes në mënyrë që të mund të ujisin tokat bujqësore.



Është mbajtur edhe takimi në **fshatin Milloshevë**, ku në këtë takim ishin pjesëmarrës edhe banorët e fshatit Babimoc, Raskovë dhe Bakshi.

Si pjesë ku kalon magjistralja Prishtinë-Mitrovicë, banorët e ketij lokaliteti kërkuan që rreth magjistrales të parshihet më shumë zonë komerciale në mënyrë që të kemi zhvillim të bizneseve, që t'iu mundësohet qytetarëve hapja e vendeve të punës, pasi dihet se komuna jonë është një komunë e varfër, në bazë të kësaj të ulet niveli I varfërisë. Kërkesë e banorëve të fshatit Bakshi ishte që të parashihet rregullimi I rrugës e cila ka dalje diku në fshatin Bërnice, është në një gjendje të rëndë.

Ata kërkuan rregullimin e kësaj rruge në mënyrë që të bëhet lidhja përmes saj me komunën e Prishtinës.



Kanë vazhduar të mbahen takimet me qytetarë, është mbajtur diskutimi publik me banorët e fshatrave **Mazgit, Llazarevë dhe Dardhishtë**, takimet u zhvilluan sipas agjendave të planifikuara nga Drejtoria e DPUKP-së për diskutim publik me qytetarët, takime këto që do zhvillohen edhe në lokalitetet tjera të Komunës së Obiliqit.

Brengë kryesore e këtyre banorëve ishte sistemi I ujitjes si dhe Komesacioni, ku qytetarët nuk kanë mundësi ndërtimi edhe pse objektet ekzistojnë në parcelat që janë nën masën e Komesacionit, kërkuan që atyer tui mundësohet ndonjë zgjidhje në këtë aspect.

Problem tjetër ishte edhe sigurimi I lokacionit për zgjerim të varrezave, ku nuk ka sipërfaqe të mjaftueshme.

Këtyre iu kumtua nga DPUPK-ja, që ne si staf i Komunës do të mundohemi të bëjmë zgjidhje, mirëpo sa i përket masës së Komesacionit, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është ajo që e ka kompetencë këtë qështje.



Pastaj ka vazhduar diskutimi publik me qytetarët e **Obiliqit, Obiliqi i vjetër dhe Plemetinit.**

Banorët u interesuan për të gjitha fushat e parapara në skenaret e Zhvillimit, ku në veqanti u theksua për mbrojtjen nga ndotja, prezencën e termocentraleve, sistemin e ngrohjes, planifikim sa më shumë të sipërfaqeve të gjelbra, hapësira të veqanta për grumbullimin e mbeturinave, e shumë këkesa të tjera.

Banorët u informuan për çdo sferë si dhe kompetencat e Komunës në realizimin e kërkesave të tyre.



Në kuadër të procesit të hartimit të Planit Zhvillimor Komunal, vazhduan të mbahen takimet me qytetarë e fshatit **Grabovc i epërm, Hade, Shipitullë, Hamidi, Palaj, Sibofc, Lajthishtë.**

Pasi që e dimë se kjo pjesë me Vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës është shpallur Zonë e Interesit të Veçantë Ekonomik që nga viti 2004, problemet dhe kërkesat e banorëve ishin të shumta.

Problem kryesor ishte qështja e banimit, ku që nga ajo kohë banorëve nuk I është lejuar ndërtimi e as nuk është bërë zhvendosja e popullatës, ku ata kanë mbetur në gjendje të mjerueshme, pastaj kanë problem me infrastruktur teknkie, sociale, publike.

Interesimi I tyre për përgjigje konkrete ishte I madh, drejtori I DPUPK-së iu tregoj se do të mundohemi që në bazë të planit të prezentuar nga KEK-u afatgjatë, afatmesëm dhe afatshkurt do të mundohemi që ta shfrytëzojmë këtë fakt dhe t’iu mundesohet banorëve ndërtimi I objekteve të banimit për atë pjesë ku zhvendosja hynë në Planin afatgjatë dhe afatmesëm.

E pas kësaj do të parashihet edhe rregullimi i rrjetit infrastrukturor.



Në kuadër të hartimit të Planit Zhvillimor Komunal, Kryetari i Komunës së Obiliqit, Xhafer Gashi, ishte pjesë e punimeve që u zhvillohen nën organizimin e drejtorisë së DPUKP-së me grupet punuese të

drejtorive komunale, kompaninë projektuese INSI, përfaqesues nga ministrinë dhe kompanitë që operojnë në komunën tonë.



Të nderuar!

Floheni që të merrni pjesë në punëtorin e organizuar nga Drejtoria e PUPK të Komunës së Obiliqit për Draft Planin Zhvillimor Komunal të Komunës së Obiliqit 2020-2028.

Punëtorja do të jetë dy ditore dhe do të mbahet në hotel "Amazona" në fshatin Babimoc, ditën e enjtë -data 11.06.2020 dhe ditën e premte- data 12.06.2020.

Pjesmarrja e juaj është obligative, sepse do të jeni kontribues me rëndësi të veçantë që ky Plan të jetë sa më i zbatueshëm dhe funksional për të mirën e Komunës sonë.

Me respekt!

Qershor 2020

Obiliq

Drejtori IDPUPK-së


Arben Berisha



Punëtorja "PZHK e Obiliqit" - Program

Dita 1	Koha	Aktiviteti	Formati
E Enjte 11 Gershor	09:00 - 09:30	Regjistrimi	Komuna
	09:30 - 09:40	Fjala hyrëse	Komuna dhe MIMPH
	09:40 - 10:10	Prezantimi i scenarioneve	Komuna
	10:10 - 11:00	Punëtorja e Vizionimit	Grupi Punues 1 dhe 2
	11:00 - 11:15	Paузë për kafë	
	11:15 - 12:00	Punëtorja e Vizionimit	Grupi Punues 1 dhe 2
	12:00 - 12:00	Dreka	
E Enjte 11 Gershor	12:00 - 12:00	Sesion Plenar- Prezantimi i Vizionit	Grupi Punues 1 dhe 2
	12:00 - 14:00	Diskutimi i Qëllimeve, Objektivave dhe Prioriteteve Strategjike për fushën e zhvillimit ekonomik	Grupi Punues 1
	12:30 - 14:00	Diskutimi i Qëllimeve, Objektivave dhe Prioriteteve Strategjike për fushën e infrastrukturës teknike	Grupi Punues 2
	14:00 - 14:30	Diskutimi i Qëllimeve, Objektivave dhe Prioriteteve Strategjike për fushën e infrastrukturës së transportit	Grupi Punues 1
	14:00 - 14:30	Diskutimi i Qëllimeve, Objektivave dhe Prioriteteve Strategjike për fushën e infrastrukturës publike dhe sociale	Grupi Punues 2
	14:30 - 15:00	Paузë për kafë	
	15:00 - 15:50	Sesion Plenar - Prezantim i diskutimeve dhe përfundimeve	Grupi Punues 1 dhe 2
15:50 - 16:00	Përshkrimi i detyrave për ditën e ardhme	Të gjithë	

Dita 2	Koha	Aktiviteti	Formati
E Premte 12 Qershor	09:00 - 09:30	Diskutimi i Qëllimeve, Objektivave dhe Prioriteteve Strategjike për fushën e Mjedisit dhe sipërfaqeve me rrezikshmëri	Grupi Punues 1
	09:00 - 09:30	Diskutimi i Qëllimeve, Objektivave dhe Prioriteteve Strategjike për fushën e Aseteve Turistike dhe Trashëgimisë kulturore dhe natyrore	Grupi Punues 2
	09:30 - 10:00	Diskutimi i Qëllimeve, Objektivave dhe Prioriteteve Strategjike për fushën e Vendbanimeve dhe Banimit	Grupi Punues 1
	09:30 - 10:00	Diskutimi i Qëllimeve, Objektivave dhe Prioriteteve Strategjike për fushën e Shfrytëzimit të Tokës	Grupi Punues 2
	10:30 - 11:00	Prezantimi i Konceptit Zhvillimor Hapësinor	Grupi Punues 1 dhe 2
	11:00 - 11:15	Paузë për kafe	
	11:15 - 12:00	Prezantimi i Koncepteve hapësinore tematike	Grupi Punues 1 dhe 2
12:00 - 13:00	Dreka		
E Premte 12 Qershor	13:00 - 13:45	Identifikimi i projekteve kapitale	Grupi Punues 1 dhe 2
	13:45 - 15:00	Plani i Veprimit	Grupi Punues 1 dhe 3
	15:00 - 15:15	Paузë për kafe	
	15:15 - 15:40	Sesion Plenar - Prezantim i rezultateve dhe rekomandimeve	Grupi Punues 1 dhe 3
	15:40 - 16:00	Përmblyrja e punëtorisë dhe fotografi e përbashkët	Të gjithë





Pas një pune intenzive Komuna e Obiliqit ka marrë vendimin për pëlqim mjedisor për Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Planin Zhvillimor të Komunës së Obiliqit me nr. Reference 20/3413/MEA nga Ministri I Ministrisë I Ekonomisë dhe Ambientit.

Me këtë vendim na është hapur rruga që të vazhdojmë në finalizimin e draft dokumentit të PZHK-së.

Janë finalizuar punët në **Profilin e Komunës** me saktësi dhe precizitet të gjitha karakteristikat e përgjithëshme të komunës në të gjitha fushat si në demografi, ekonomi, infrastruktur teknike, infrastruktura e transportit dhe transporti public, infrastruktura publike dhe sociale, mjedisi dhe sipërfaqet me rrezikshmëri, asetet e trashëgimisë kulturore, natyrore dhe turistike, vendbanimet, vendbanimet joformale dhe ndërtimet pa leje, banimi dhe shfrytëzimi I tokës.

Pas përfundimit të **Profilin të Komunës** kemi vazhduar në kapitullin tjetër **VLERËSIMIN E GJENDJES** që I është kushtuar rëndësi e veçantë pasi komuna e Obiliqit është një ndër komunat më specifike të Republikës së Kosovës.

Në këtë kapitull jemi fokusuar në pikat më të rëndësishme strategjike, vlenë të ceket analiza që I është bërë zhvillimeve demografike pasi është shumë e domosdoshme për planifikim adekuat të zonës duke aluduar në kërkesat e popullësisë dhe interesin e zonës për zhvillim socio-ekonomik në të ardhmen, pra si

prike **Trendet dhe Prognozat Demografike**. Pastaj kemi vazhduar me vlerësimin e gjendjes së **Zhvillimit Ekonomik** duke përfshirë çdo detaj si në fushat e cekura në profil.

Kemi vazhduar me **kapacitetet njerëzore dhe financiare të Komunës** ku janë bërë parashikime dhe supozime në bazë të të dhënave që i kemi poseduar dhe kemi marrë përmes burimeve të ndryshme.

KORNIZA E PLANIFIKIMIT HAPËSINOR

Korniza e Planifikimit hapësinor është pjesa kryesore e PZHK-së, përshkak se paraqet zhvillimin hapësinor të tërë territorit të komunës së Obiliqit për 8 (tete) vitet e ardhshme, gjegjësisht formulon strukturën dhe organizimin hapësinor për zhvillim të ardhshëm.

Vizioni është faza e parë në zhvillim, ku qëllimi I tij është të formuloj imazhin e të ardhmes dhe një model që komuna e Obiliqit duhet ta arrijë gjatë viteve të ardhshme, dmth i kemi kushtuar kësaj pike rëndësi të veçantë.

Komuna e Obiliqit është një qendër e vogël ekonomike por me një barrë shumë të madhe industriale, atë të prodhimit të 97% të rrymës elektrike të Kosovës, prandaj Obiliqi nuk është vetëm një Komunë por është një qendër rajonale industrial, ku gjithashtu shtrihen mihjet sipërfaqësore që janë vlerë e jashtëzakonshme për ekonominë në sektorin e energjisë në Kosovë. Në bazë të kësaj dhe specifikave të cilat rëndojnë mbi komunën e Obiliqit, *komuna jonë gëzon status të veçantë duke u paisur nga Kuvendi i Republikës së Kosovës Ligjin për Obiliqin*.

Duke marrë parasysh këtë fakt gjatë hartimit të PZHK-së që territori i Komunës së Obiliqit është zhvilluar në 10 vitet e fundit dhe që duhet të zhvillohet në vitet e ardhshme duke u bazuar në vizionin e dhënë për këtë regjion sipas Planit Hapësinor të Kosovës, që e identifikon regjionin si:

“Porti i Kosovës” – Hapësira e kaltër- administrative, shërbyese, tregtare, agro-industriale, turistike – paraqet pjesën veriore të Kosovës të përbërë nga komunat: Prishtina si qendër kryesore dhe kryeqendër e Kosovës, Obiliqi, Podujeva, Fushë Kosova, Lipjani, Drenasi dhe Shtime që gravitojnë në qytetin e Prishtinës.

Të gjitha anlizat gjatë hartimit të këtij plani, vlerësimet, trendet, projekksionet, prognozat dhe konkluzionet kanë rezultuar se Obiliqi duhet të zhvillohet në mënyrë të qëndrueshme duke planifikuar zhvillimin e zonave të banimit, industriale, ekonomike, sociale, mjedisore rekreative turistike që të jenë pozitive për mirëqenien e qytetarëve të komunës së obiliqit.

Qëllimet dhe objektivat e veqanta janë të mbështetura në hulumtimin e gjërë dhe vlerësimin e gjendjes ekzistuese.

Grupi punues së bashku me të gjithë akterët qoftë drejtpërdrejt që janë të kyqur në realizimin e PZHK-së qofshin edhe ata indirekt ka marrë pjesë në punëtorinë e realizuar më datën 19 dhe 20 qershor 2020 është mbajtur punëtori dyditore lidhur me vizionin dhe objektivat e PZHK-së.


Në këtë takim në bazë të hulumtimeve dhe vlersimit u propozuan **SKENARËT HAPËSINOR** .

Skenarët janë metodë e planifikimit strategjik, me qëllim të analizimit të zhvillimit të mundshëm në të ardhmen duke paraqitur elemente që ndihmojnë në realizim.

Kemi propozuar tre skenar:

SKENARI 1- Skenari kryesor nga PZHK e kaluar

Skenari 1 i propozuar është replikim I konceptit të përvetësuar të PZHK-së 2010. Integrimi i konceptit të PZHK-së 2010-2020 përmes Skenarit të parështë piknisje e mundëshme e zhvillimit hapësinor të komunës, si vazhdimësi e zhvillimit të deritanishëm.




Harta 60. Skenari sipas PZH-K-së në fuqi

SKENARI II –

Bazohet në dy koncepte kryesore të përzgjedhura:

- atë të zhvillimit kompakt dhe përmblendhës zhvillohet në disa drejtime.

Përkrah zonës urbane si qendër e rendit të lartë, krijohet edhe dy qendra sekondare atë të Millosheviç dhe Hades së Re, si dhe disa qendra të rendit të ulët.



⁵⁰ Hade e Re nënkupton vendbanimin e ri në pjesën lindore të Zonës Kadastrale Obiliq

SKENARI III- skenari ipërzgjedhur

Nga të tre skenarët e propozuar skenari III u vendos të merret si mëi zbatueshmi dhe më funksional.

Në këtë skenar është paraparë që komuna të zhvillohet në disa drejtime.

Brenda këtij skenari kemi bërë zgjidhje në përgjithësi për zonat të cilat kanë qenë problem shumëi madh për të vazhduar tutje për zhvillimin e komunës.

- Zona me Interes të veçantë ekonomik (Palaj, Mirash , Lajthishtë , Hade, Siboc dhe Shipitullë);
- Zona- perimetri i sigurisë rreth termocentraleve;
- Zona-perimetri i sigurisë rreth stabilimenteve të KOSTT-it ;
- Komasacioni;
- Zgjerimi i zhvillimit ekonomik në Komunën e Obiliqit .

➤ **Zona me Interes të veçantë ekonomik (Palaj, Mirash , Lajthishtë , Hade, Siboc dhe Shipitullë)**

-Parashihet që zhvillimet në kuadër të kësaj **zonetë zhvendosjes dhe të mihjeve** të zhvillohen në bazë të etapave të zhvillimit të mihjeve sipërfaqësore duke u bazuar në Planin Zhvillimor të KEK-ut , si dhe duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ nga MMPH-ja – **nr.24/2015** neni 12 parag.3.4 që lejon vetëm shfrytëzimet e përkohshme, e tëra kjo do të bëhet në përputhshmëri me planifikim në kuadër të planit zhvillimor të KEK-ut për eksploitim të mihjeve.

➤ **Zona- perimetri i sigurisë rreth termocentraleve**

Bazuar në zhvillimet e deritashme të qytetit ne nuk mund të mbajmë distancën deri në 850 m largësi dhe në bashkupim me KEK-un kemi kërkuar që aty ku është masa e sigurisë KEK-u të fillojë me procesin e shpronësimeve për pronarët e paluajtshmërive dhe të zhvendoset rrethoja e sigurisë aty ku KEK-u parasheh .

➤ **Zona-perimetri i sigurisë rreth stabilimenteve të KOSTT-it**

Bazuar në zhvillimet e deritashme të qytetit ne nuk mund të mbajmë distancën deri në 850 m largësi dhe në bashkupim me KOSTT-in kemi kërkuar që aty ku është masa e sigurisë KOSTT-i të fillojë me procesin e shpronësimeve për pronarët e paluajtshmërive dhe të zhvendoset rrethoja e sigurisë aty ku KOSTT-i parasheh .

➤ **Komasacioni**

Në sipërfaqet e tokave që ndodhen brenda sistemit të Komasionit janë zhvilluar lagje të tëra banimi në prona të veta përgjatë viteve, të mbipopulluara dhe e vërshuar me ndërtime. Në Planin Zhvillimor Komunal janë vendosur zhvillime konform të ndërtimeve dhe zhvillimeve në toka komosative që kanë ndodhur nëpër vite, komasacioni është proces i pa përfunduar dhe në këtë drejtim zhvillimet janë trajtuar si toka në pritje (duke pritur trajtim nga niveli qeveritar për komasacionin në tërë Kosovën), por komuna e Obiliqit nuk e konsideron as të arsyeshëm e as të qëndrueshëm këtë për mos hyrje në kufijtë ndërtimor të kësaj sipërfaqeje për arsyet se 70 % e tokës është interes nacional, procesi i komasionit legalisht nuk ka përfunduar dhe nuk ka prodhuar efekte, dhe komuna e Obiliqit shtrihet në tokën e kufizuar për ndërtim dhe si të vetmet alternativa i sheh këto toka edhe se janë të ndotura, si dhe duke u bazuar në **LIGJIN PER LEGALIZIM**.

➤ **Zgjerimi i zhvillimit ekonomik në Komunën e Obiliqit**

Arsyetimet sipas së cilave Komuna e Obiliqit gjatë hartimit të Planit Zhvillimor të komunës mund të krijoj kufijë ndërtimor sipas nevojave të shfrytëzimit të lokacionev më specifike brenda sipërfaqes së Komunës pasi që kjo vijë konsiderohet si arteria kryesore për zhvillimin e komunës po ashtu konsiderohet si pikë strategjike për komunën tonë për shkak se është epiqendër e Republikës së Kosovës duke llogaritur Autoudhën , Hekurudhën që parashihet rivitalizimi i saj në vitet e ardhshme po ashtu parashihet si pikë ndalese për ngarkim dhe shkarkim të mallrave .

Magjistranja Prishtinë – Mitrovicë që është një koridor shumë i vlefshëm zhvillimor si dhe kyqja e unazes së kryeqytetit në të ardhmen janë benefite shtesë dhe një arsyeshmëri e fortë për zhvillimin e bizneseve për komunën tonë .

Në skenarin e përzgjedhur janë marrë parasysh të gjitha fushat duke filluar nga banimi, ndotja, energjia, ekonomia, ambient, është prekur çdo segmenti pikave duke u munduar të bëjmë zgjidhje sa më adekuate që PZHK të jetë sa më funksional dhe i zbatueshëm nga qytetarët tanë.

Për hartimin e planit zhvillimor 2022-2030 si referencë kemi marrë si në vijim:

- PZHK aktual që parashih disa nga zhvillimet aktuale ;

-Planin Hapësinor të mihjeve të zonës së veçantë ekonomike ;

-Planin zhvillimor të KEK-ut , KOSTT-it, Infracosit, Ibër Lepenc , Ujësjellsin Rajonal

“Prishtina”, KEDS-in si dhe operatorët e ndryshëm ekonomik të cilët operojnë në komunën tonë .

Si përparsi dhe bazë e fortë e këtij plani zhvillimor konsiderohet Ligji për Obiliqin i cili na ka dhënë zgjidhjen për shumë problematika të cilat veq u cek më lartë e të cilat e kanë përcjellur Komunën e Obiliqit për gjatë gjithë këtyre viteve që po lëmë pas .

Më poshtë në pika të shkurtëra po elaborojmë disa nga pikat kryesore të këtij ligji të cilat kanë qenë mbështetëse për komunën në mënyrë që tu ofrojmë zgjidhje adekuate .

• **LIGJI NR. 05/L-044 për zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit dhe rreth tij, Neni**

4. Shpallja e zonës së rrezikuar si zonë me status të veçantë mjedisor

1. Komuna e Obiliqit shpallet si zonë me status të veçantë mjedisor në Republikën e Kosovës.

2. Komuna e Obiliqit përfshin tërësinë territoriale ashtu siç përcaktohet me zonën kadastrale të Komunës.


3. Në zonën me status të veçantë mjedisor përfshihen edhe vendbanimet e komunave fqinje të cilat përfshihen brenda rrezes së zonës me rrezikshmëri mjedisore.

Neni 5. Zona e rrezikuar mjedisore

1. Zona e rrezikuar mjedisore përfshinë rrezen në distancë ajrore deri pesëmijë (5.000) metra nga pika në mes dy termocentraleve në Obiliq.
2. Komuna në bashkëpunim me Ministrinë, përcakton prioritetet për investime brenda zonave të përcaktuara, në bazë të shkallës së ndotjes.

Neni 10. Subjektet përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji


1. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është autoriteti përgjegjës për sigurimin e zbatimit të këtij ligji në fushën e mjedisit dhe planifikimit hapësinor.
4. Komuna e Obiliqit është autoriteti kryesor lokal, përgjegjës për zbatimin e dispozitave të këtij ligji.




Konceptin e zhvillimit hapësinor e kemi bazuar në planifikimet e shpërndarjes hapësinore të zhvillimeve dhe funksioneve për të arritur qëllimet dhe objektivat e përcaktuara për arritjen e vizionit, përmes një zhvillimi të balancuar dhe të qëndrueshëm hapësinor të Komunës duke i vënë në funksion të zhvillimit të gjitha potencialet e saja konkurruese.

Andaj përmes këtij koncepti jemi munduar të krijojmë kushte për zhvillim të qëndrueshëm, që zbërthehet në:

- Administratë profesionalisht efikase dhe të decentralizuar;
- Mbrojtje efikase e tokës bujqësore dhe stimulimi - zhvillim i sektorit të bujqësisë;
- Rritja dhe shfrytëzimi racional i pyjeve dhe kullosave;
- Infrastrukturë adekuate me qasje të mirë;
- Vendbanime kompakte dhe planifikimi për vendbanimet që do të zhvendosen;
- Ekonomi të zhvilluar dhe të balancuar dhe;
- Mjedis të pastër dhe atraktiv.



Harta 63 Koncepti kryesor për zhvillim të ardhshëm hapësinor të komunës së Obiliqit



Harta 64 koncepti kryesor për zhvillim të ardhshëm hapësinor të zonës urbane .

ZHVILLIMET E PLANIFIKUARA SIPAS FUSHAVE

Zhvillimi i mëtutjeshëm duhet të sigurojë jetesë të mirë në mbarë Komunën e Obiliqit , duke trajtuar skenarin e përzgjedhur (skenari i 3-të) për zhvillimin hapësinor.Kushtet e barabarta të jetesës dhe punës duhet të arrihen dhe të ruhen në çdo pjesë të komunës së Obiliqit .Ruajtja dhe arritja e efikasitetit në gjithë territorin , sigurimi i aktivizimit dhe promovimit të zhvillimit të vazhdueshëm të potencialit ekzistues është thelbësor .Andaj një menaxhim efikas i hapësirës është i duhur për vëzhgimin dhe rritjen e sigurisë së hapësirave të ndryshme të strukturuar .

Ndër zhvillimet kryesore të planifikuara sipas fushave vlenë ceket:

-Zhvillimi ekonomik – Komuna e Obiliqit ka si pikësynim të zhvillojë dhe shtojë sektorët ekonomik si p.sh. Industrinë prodhuese dhe përpunuese , turizmin , ndërtimtarinë, prodhimtarinë, tregtinë, akomodimin etj .të cilat në mënyrë të hollësishme janë të detajuara në projekt planin zhvillimor të komunës së obiliqit 2022– 2030 .

Korniza e zhvillimit të qëndrueshëm bujqësor në Obiliq

Prodhimi i qëndrueshëm bujqësor është shfaqur si një nevojë për të gjetur mënyrat e prodhimit bujqësor që nuk degradojnë resurset natyrore dhe që në të njëjtën kohë sjellin prodhime bujqësore dhe të ardhura të larta.

Bujqësia është një nga sektorët më të rëndësishëm në ekonominë e Obiliqit, e cila do të mbështet edhe më tej në këtë koncept , me kushtet e e planifikuara do të ofroj një kontribut të konsiderueshëm në ekonomi dhe stabilitetin social .

Pastaj kemi prekur edhe fushën e **Energjisë dhe telekomunikacionit,infrastruktura e transportit,Infrastruktura publike dhe sociale,mbrojtja e trashëgimisë kulturore, mjedisi dhe sipërfaqet me rrezikshmëri, vendbanimet, banimin, shfrytëzimin e tokës, etj.**

Mbrenda kufijëve të teritorit të komunës sonë janë paraparë dy projekte të mëdha që janë bashkëfinancim I qeverisë me bankën botërore, **Panelet solare në Shkabaj dhe Parku I Gjelhër në Dardhishtë**. Këto janë projekte të mëdha që niveli qendror së bashku me neve si komunë kemi arritur marrëveshje për lejimin e ndërtimit të paneleve solare që është interes I qeverisë, në mënyrë që në të ardhmen qeveria të jetë e hapur për ofrimin e ndihmës për neve si komunë në projektet e radhës.





Niveli qendror ka qenë përherë i hapur dhe bashkëpunues me Komunën tonë.

Pas takimeve të përherëshme dhe bashkëpunimit me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës pasi kjo Ministri është përgjegjëse që ky Plan të jetë i zbatueshëm në praktik me sygjerimet, komentet e poashtu edhe vërejtjet dhe rekomandimet, duke respektuar rregullativën ligjore, pastaj të gjitha ministritë vegëz që kanë lidhje të drejtpërdrejtë në zbatueshmërinë e këtij plani, e shumë aktor të tjerë kemi ardhur në përfundim që ky Plan të marrë vendimin për pëlqim për hapjen e shqyrtimit publik.

Me datë 01.11.2022 është marrë pëlqimi i vendimit për hapjen e shqyrtimit publik të draft dokumentit të Planifikimit Hapësinor-PZHK 2022-2030 .



Republika e Kosovës
 Republika Kosovo-Republic of Kosovo
 Qeveria - Flade - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruktura
 Ministarstvo Zaštitne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
 Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretariatit të Përgjithshëm - Kanslleria Gjenerale e Sekretarit të Përgjithshëm

DATA:	01.11.2022
REFERENCË:	
FËRZATË:	Ashen Barisha, Drejtor i Departamentit për Planifikimin Urban, Prind dhe Kadeastrë - Komuna e Ohriqit
CC:	Xhuliu Gashi, Kryetar i Komandës së Ohriqit
FËRMI/PËRVEJTYBROGJI:	
NGA/ODRYBOM:	Servisi i Punëve, Zhvendosja e Mbrojtjes së Përgjithshme i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruktura (MMPIH)
TEMA/SUBJEKTI/SUBJECT:	Vendosja për përfundim për hapjen e shqyrtimit publik të Projektit "Planifikimi Komunal të Ohriqit 2022-2030"

I shëruar z. Barisha,

Bazuar në Ligjin Nr.04/L-174 Për Planifikimin Hapësinor nën 11 (paragrafi 1.5, në paragrafi 1.9.1) Komuna e Ohriqit ka dorëzuar në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruktura me datë 16.08.2022 me numër të protokollit 4621/22, kërkesën "për marrjen e përfundimit për hapjen e shqyrtimit publik të Projektit "Planifikimi Komunal të Ohriqit 2022-2030".

Sipas nenit 9 (paragrafi 2 në paragrafi 2.3), Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruktura është përgjegjës për vlerësimin e përputhshmërisë së Projektit "Planifikimi Komunal të Ohriqit 2022-2030" me "Planin Hapësinor të Kosovës - Ilustrimja e Zhvillimit Hapësinor 2019-2020" dhe me Udhëzimin Administrativ MMPIH-Nr.08/2017 Për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor.

Faqe1nga2

Duke u bazuar në nenin 20 të Ligjit Nr.04/L-174 Për Planifikimin Hapësinor dhe në nenin 7 të Udhëzimit Administrativ MMPIH-Nr. 08/2017 për Përgjegjësinë e Autoriteteve të Planifikimit Hapësinor si dhe Parimet dhe Procedurat për Përcaktimin e Publikimit të Planifikimit Hapësinor, Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruktura është përgjegjës për marrjen e vendimit për përfundim të Komandës së Ohriqit sipas procedurës për Përcaktimin e Autoriteteve të Planifikimit Hapësinor si dhe Parimet dhe Procedurat për Përcaktimin e Publikimit të Planifikimit Hapësinor, Mandatit të Hapjes së Shqyrtimit Publik.

Më respekt,



Faqe2nga2

Më datën 03.11.2022 Drejtoria e Planifikim Urban, Pronës dhe Kadastrit iu ka drejtuar Kryesueses së Kuvendit përmes kryetarit, për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme për të hapur shqyrtimin publik për draft dokumentin Planin Zhvillimor të Komunës.

Seanca e mbledhjes së KK Obiliq është mbajtur me datën 11.11.2022. Asambleistëve i'u është dërguar materiali në USB dhe përmes emaileve, në mënyrë që të jenë të informuar për punën e deritanishme që është bërë rreth hartimit të këtij dokumenti.

Të gjithë asambleistët pa dallim ishin për hapjen e shqyrtimit publik dhe kështu votuan të gjithë për marrjen e vendimit për hapjen e shqyrtimit publik.





1-150 Data 11.11.2022



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obiliq - Municipality Assembly Obiliq

Në mbështetje të neneve 12.2, shkronja(d) , nenit 12.1, nenit 17 shkronja (b), nenit 58 shkronja (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Republikës të Kosovës nr. 03/L-40(Gazeta Zyrtare nr.28 të dt.04.06.2008), neni 15 dhe 20 i Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor, neni 7, 8,10,11,12,13,14 dhe 15 i Udhëzimit Administrativ MMPH -NR 05/2014 për përgjegjësitë e autoriteteve të Planifikimit Hapësinor si dhe parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut në planifikim hapësinor, neneve 14 , 44.1, 47.3 dhe 72 pika 1.8 e Statutit të Komunës së Obiliqit Nr.1-34 dt.25.04.2016, si dhe nenit 39 të Rregullores së punës së Kuvendit , Kuvendi komunal pas shqyrtimit të Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës nr.-II-1523, të datës 03.11.2022 dhe kërkesës së DPUPK-së nr. V-1400, të datës 03.11.2022 në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur më datën 11.11.2022 mori këtë:

VENDIM

Për hapjen e shqyrtimit publik të Draft dokumentit të Planifikimit Hapësinor- Plani Zhvillimor i Komunës së Obiliqit 2022-2030

Neni 1

Aprovohet Vendimi për hapjen e shqyrtimit publik të draft dokumentit të Planifikimit Hapësinor - Plani Zhvillimor i Komunës së Obiliqit. 2022-2030.

Neni 2

Qëllimi i paraqitjes së këtij Vendimi për hapjen e shqyrtimit publik të draft dokumentit të Planifikimit Hapësinor - Plani Zhvillimor i Komunës së Obiliqit 2022-2030 të cekur si në nenin 1 të këtij Vendimi është që dokumenti të jetë i hapur për publikun ku ftohen qytetarët , ekspertët dhe palët e interesit për të parashtruar komentet apo sugjerimet para finalizimit të dokumentit të planifikimit hapësinor- draft dokumentit Plani Zhvillimor i Komunës së Obiliqit. Autoriteti i Planifikimit përkrahësisht Komuna e Obiliqit siguron dhe inkurajon pjesëmarrjen publike transparente në procesin e planifikimit duke ofruar qasje publike në çdo fushë të zhvillimit hapësinor në tërë territorin e Komunës të planifikuar në këtë dokument , në të dhëna, harta, grafikone dhe çdo kërkesë që e parashtrorjnë palët e interesit lidhur me këtë dokument.

- 2.1. Ekspozimi i projektit "Plani Zhvillimor i Komunës së Obiliqit 2022-2030" parashihet të bëhet në sallën e Kuvendit të Komunës.
- 2.2. Për të promovuar gjithë përfshirjen dhe transparencën parashihen të mbahen prezantime shitesë sipas planit të organizimit të aktiviteteve gjatë kohës së shqyrtimit publik.
- 2.3. Për të gjitha prezantimet publike parashihet të mbahet procesverbal.
- 2.4. Shqyrtimi publik i projekti "Plani Zhvillimor Komunal i Obiliqit 2022-2030" do të zgjasë 30 (tridhjetë) ditë sipas procedurave të përcaktuara me ligj.

2.5. Shpallja e shqyrtimit publik të projektit "Plani Zhvillimor Komunal 2022-2030" do të bëhet 8 (tetë) ditë para hapjes së tij përmes mjeteve të informimit publik, faqes zyrtare të Komunës dhe në media televizive publike.

2.6. Projekti "Plani Zhvillimor i Komunës së Obiliqit 2022-2030" do të jetë i qashtëm për publikun në formë të shtypur dhe elektronike.

Neni 3

3.1. Ky projekt do t'i nënshtrohet vërejtjeve, komenteve dhe sugjerimeve të publikut para se të finalizohet.

3.2. Të gjitha vërejtjet, komentet dhe sugjerimet që paraqiten nga publiku me gojë gjatë diskutimeve, me shkrim në librin e vërejtjeve apo përmes adresës elektronike, brenda afatit kohor të përcaktuar, përfshihen në raportin mbi shqyrtimin Publik.

Neni 4

Shqyrtimi i projektit "Plani Zhvillimor i komunës së Obiliqit 2022-2030" do të organizohet nga Komuna e Obiliqit në suaza të Kompetencave të përcaktuara me Ligj.

Neni 5

5.1. Me këtë vendim duhet të parashihet sigurimi i kushteve teknike dhe financiare që nevojiten gjatë kohës së shqyrtimit Publik të projektit "Plani Zhvillimor Komunal i Obiliqit 2022-2030".

Neni 6

Pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi Drejtorja e Planifikimit Urban, Kadastër dhe Pronë në pajtim me dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor dhe Udhëzimit Administrativ MMPH -NR 05/2014 për përgjegjësitë e autoriteteve të Planifikimit Hapësinor si dhe parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut në planifikim hapësinor do të bëjë hapjen e shqyrtimit publik të Draft dokumentit të Planifikimit Hapësinor- Plani Zhvillimor i Komunës së Obiliqit.

Neni 7

Për zbatimin e këtij Vendimi obligohet Drejtorja e Planifikimit Urban, Kadastër dhe Pronë.

Neni 8

Ky Vendim hyn në fuqi (15) pesëmbëdhjetë ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të MAPL-së dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në Web faqen zyrtare të Komunës .

T'i dërgohet

- Kryetarit
- Nënkyetarit
- Kryesueses
- Antarëve të KK
- MAPL
- DPUPK
- Arkivit



Ky vendim është dërguar për konfirmimin e ligjshmërisë në Ministria e Administratës dhe Pushtetit Lokal.

Më datën 07.12.2022 Komunës së Obiliqit i është dhënë e drejta e hapjes së shqyrtimit publik të PZHK-së përmes vlerësimit të ligjshmërisë së aktit nga ana e MMPHI-së.



01
1005/2/22
11.12.22
KOSOVINE

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësior dhe Infrastruktura
Ministertve Zivote Sredine, Prostruarng Planuarngja i Infrastruktura
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Për:	Shaher Gashi, Kryetar i Komunës së Obiliqit Vlora Mjekaj Kabashi, Kryesore e Kuvendit të Komunës së Obiliqit
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL Venera Çekeli, Zëvendësuese e Sekretarit të Përgjithshëm të MAPL Nënia për Administrimin e Dokumenteve të MAPL
Përmas:	Liburn Aliu, Ministër i MMPH Berret Spahiu, Zëvendësues Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH
Nga:	Florije Kika, Drejtor e Departamentit Ligjor Nr.VL-234/22 Datë: 21.11.2022
Zyrtarët përgjegjës:	1.Zyrtari konfirmues: Sabije Rama, Udhëheqëse e Divizionit për vlerësimin ligjor Mbështetjen e Zbatimit të Legjislacionit, të 2.Zyrtari hartues: Mbështetjen Ligjore dhe të bashkëpunimit vlerësimin ligjor Ndërinstitucional në Fushën e Legjislacionit
Lënda:	Vlerësimi i ligjshmërisë së aktit
Lloji i aktit:	Vendimi Nr.L-150 për hapjen e shqyrtimit publik të Draft-Dokumentit të Planifikimit Hapësior- Planit Zhvillimor i Komunës së Obiliqit 2022-2030, miratuar nga KK Obiliq

Inderuari Kryetar Gashi,
I nderuara Mjekaj Kabashi,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësior dhe Infrastruktura, pajtim me Rregulloren (QRR) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRR) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, ka pranuar nga MAPL, Vendimin Nr.L-150 për hapjen e shqyrtimit publik të Draft-Dokumentit të Planifikimit Hapësior- Planit Zhvillimor i Komunës së Obiliqit 2022-2030, miratuar nga KK Obiliq, datë 11.11.2022.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësior dhe Infrastruktura, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim me Nenin 4 të Rregullores (QRR) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRR) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave:

KONFIRMON

Vendimi Nr.L-150 për hapjen e shqyrtimit publik të Draft-Dokumentit të Planifikimit Hapësior- Planit Zhvillimor i Komunës së Obiliqit 2022-2030, miratuar nga KK Obiliq, datë 11.11.2022.

Asyrtimi

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësior dhe Infrastruktura, pas shqyrtimit të përmbajtjes së Vendimit Nr.L-150 për hapjen e shqyrtimit publik të Draft-Dokumentit të Planifikimit Hapësior- Planit Zhvillimor i Komunës së Obiliqit 2022-2030, miratuar nga KK Obiliq, konstatohet se akti në fjalë pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi, gjegjësisht Ligjin Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësior.

Asnjë, si i tillë rëndim prashon shikim juridik.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësior dhe Infrastruktura, mbështet dispozicionin e Komunës së Obiliqit dhe MAPL-it, për çfarëdo aspekti të mbështetjes së lartë me këtë vlerësim.



Kështu më datën 11.12.2022 kryetari i Komunës së Obiliqit shpallë njoftimin për Shqyrtim Publik të Propozim Planit Zhvillimor të Komunës së Obiliqit 2022-2030 i cili do të zgjas nga data 16.12.2022-16.01.2023.

Kurse prezantimi i dokumentit do të bëhet më datën 23.12.2022.

Drejtorja e Planifikimit Urban, Pronës dhe Kadastrit është angazhuar në maksimum të shpërndajë njoftimin në të gjitha vendet e frekuentuara nga banorët në qytet, fshatra, nëpër institucione arsimore, institucione fetare, stacione të autobusëve, në çdo kënd, në mënyrë që qytetarët të jenë të informuar rreth përmbajtjes së këtij projekti mjaft të rëndësishëm për zhvillimin e komunës në të gjitha aspektet.



NJOFTIM

Komuna e Obiliqit njofton të gjithë qytetarët, se me datën 23.12.2022 në ora 14:00 në sallën e Kuvendit Komunal të Komunës së Obiliqit, do të mbahet debat publik për: "Propozim Planin Zhvillimor Komunal 2023-2030"

Në debat publik ftohen të marrin pjesë: Qytetarët, përfaqësuesit e lagjeve, përfaqësuesit e OJQ-ve, përfaqësuesit e komuniteteve, të rinjtë, gratë, pensionistë, studentët, komuniteti i biznesit, përfaqësuesit e institucioneve të ndryshme, përfaqësuesit e ndërmarrjeve publike, anëtarët/e të Kuvendit Komunal Obiliq, përfaqësuesit e partive politike, përfaqësuesit e mediave,

Komentet, vërejtjet dhe sygjerimet e juaja mund t'i dorzoni në mënyrën fizike në Drejtorinë për Planifikim Urban, Pronë dhe Kadastër apo përmes formës elektronike në Email: urbanizmiobiliq@rks-gov.net dhe Arben.berisha@rks-gov.net

Zyra për informim, Obiliq.



Shpallja e këtij Njoftimi është bërë duke shfrytëzuar edhe formën elektronike, ndërsa dokumentin e ka postuar në faqen zyrtare të komunës dhe dokumenti është ekspozuar në formë fizike në hollët e Komunës.

Komuna e Obiliqit- Faqja Zyrtare
19h · 🌐

NJOFTIM

Komuna e Obiliqit njofton të gjithë qytetarët, se me datë 23.12.2022 në ora 14:00 në sallën e Kuvendit Komunal të Komunës së Obiliqit, do të mbahet debat publik për: **"PROPOZIM PLANIN ZHVILLIMOR KOMUNAL 2022-2030"**

Në debat publik ftohen të marrin pjesë: Qytetarët e Komunës së Obiliqit, përfaqësuesit e O/Q-ve, përfaqësuesit e komuniteteve, komuniteti i biznesit, përfaqësuesit e institucionave të ndryshme, përfaqësuesit e ndërmarrjeve publike, anëtarët/e të Kuvendit Komunal Obiliq, punonjësit e komunës, përfaqësuesit e partive politike, përfaqësuesit e mediave.

Kopjen fizike të Dokumentit mund ta gjeni në ueb faqen e Komunës: <https://kk.rks-gov.net/.../Plani-Zhvillimor-Komunal-2022...> si dhe do të jenë të ekspozuara hartat në hollat e objektit të komunës.

Kërkesat, komentet dhe sugjerimet, mund t'i dërgoni në: urbanizmiobiliq@rks-gov.net dhe arben.berisha@rks-gov.net.

Ju mirëpresim!
Zyra për informim, Obiliq.




Shënim qytetarë të ndëruar

Komuna e Obiliqit njofton të gjithë qytetarët, se do të mbahet debat publik për: **"Propozim Planin Zhvillimor Komunal 2022-2030"**

Në debat publik, ftohen të marrin pjesë: qytetarët e Komunës së Obiliqit, përfaqësuesit e O/Q-ve, përfaqësuesit e komuniteteve, komuniteti i biznesit, përfaqësuesit e institucionave të ndryshme, përfaqësuesit e ndërmarrjeve publike, anëtarët/e të Kuvendit Komunal Obiliq, punonjësit e komunës, përfaqësuesit e partive politike, përfaqësuesit e mediave.

Kopjen fizike të Dokumentit mund ta gjeni në ueb faqen e Komunës si dhe do të jenë të ekspozuara hartat në hollat e objektit të komunës.

Kërkesat, komentet dhe sugjerimet, mund t'i dërgoni në: urbanizmiobiliq@rks-gov.net dhe arben.berisha@rks-gov.net.

Ju mirëpresim!

👍 20 🗨️ 2 shares

👍 Like 🗨️ Comment

Drejtorja e Planifikimit Urban, Kadastrit dhe Pronës është angazhuar në maksimum që për të gjithë qytetarët të jetë e hapur gjatë tërë muajit sa do të jetë PZHK në shqyrtim publik.

Ka pregaditur fletoren e cila ka qenë në tavolinën në hyrje të komunës, formularët në zyrën pritëse, formularët në zyrën e urbanizmit ku qytetarët në ata formular dhe në fletore do të mund të paraqesin vërejtjet, sygerimet dhe komuntet lidhur me këtë dokument.

Këta formular kane mundur t'i shkarkojn edhe nga ëeb faqja e Komunës te vegza njoftimet dhe konkurset.

Formularët kanë pasur mundësi t'i dërgohen zyrës së Urbanizmit për shqyrtim zyrtarisht përmes zyrës pritëse apo në dy email adresat të cilat janë prezentuar në njoftim të shqyrtimit publik.







Per realizimin e ketij dokumenti të planifikimit hapësinor i cili siq u cek edhe më lartë është dokument bazik për zhvillimin e Komunës tonë për 8 vitet e ardhshme:

Falenderojmë Kryetarin e komunës z.Xhafer Gashi i cili për gjatë gjithë këtij procesi me plotë autoritetin e tij na ka ofruar përkrahje të vazhdueshme neve si drejtori në veqanti dhe si ekip e komunës në përgjithësi,

Po ashtu falenderojmë komisionin komunal i cili ka kontribuar në mbledhjen dhe ofrimin e të dhënave,

Falenderojmë Kompaninë konsulente “INSI” e cila me një staf profesional ka punuar me përkushtim të madh në jetësimin e këtij dokumenti,

Po ashtu një falenderim shkon edhe për anëtarët e stafit të MMPHI-së të cilët kanë dhënë kontribut të jashtëzakonshëm duke i kuptuar problemet dhe specifikat e komunës së Obiliqit.

Ky projekt dokument ka qenë në shpallje nga dt.16.12.2022 deri me dt. 16.01.2023 , për komentet, vërejtjet dhe sygjerime.

Së bashku kemi ardh deri të finalizimi i këtij plani multifunksional I cili shprejsojmë që me punën tone me bashkëpunimin e te gjithëve kemi arritur t'i plotësojmë të gjitha kërkesat dhe nevojat e qytetarëve të komunës sonë.

Ky plan do të jetë në fuqi për tetë (8) vitet e ardhëshme.

-Përveq Planit Zhvillimor është punuar së bashku me kompanin konsulente dhe komisionin e Komunës për hartimin Hartën Zonale të Komunës së Obiliqit, kemi pasur katër takime dhe jemi duke u harmonizuar me dokumentin e Planit Zhvillimor të Komunës i cili është në fazat përfundimtare.

-Kemi paisur palët me dokumente në mënyrë që t'iu mundësohet aplikimi në Ministrinë e Bujqësisë për përfitim të granteve qeveritare e poashtu edhe bashkëpunimi me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale lidhur me kërkesat e tyre për ndërtimin e shtëpive për të rikthyerit dhe për minoritete.

-Takim me auditorë, lidhur me procedurat e paisjes me leje ndërtimore për vitin 2022-ashtu siq është vepruar çdo vit.

-Si dhe shumë punë të tjera që janë të lidhura me sektorin e urbanizmit, duke cekur edhe konsultimet me palë lidhur me punët që I takojnë natyrës së punës ton

-Kjo ka qenë një përmbledhje e shkurtër e punëve të sektorit të urbanizmit gjatë vitit 2022.

Më poshtë do të cekim lëndët që janë të lidhura me të hyrat në sektorin tonë.

- 47 vendime për kushte ndërtimore,
- 39 vendime për leje ndërtimore,
- 16 leje përdorimi,
- 0 leje rrënimi,
- 10 vendime për refuzim,
- 13 pelqim ,
- 24 përgjigjëje palëve,
- 46 njoftime për qytetarë në kërkesat e ndryshme.
- 83 vendime të legalizimit të objekteve për kategorin e parë
- 0 vendime të legalizimit të objekteve për kategorin e dytë.

- 42 vendime të legalizimit për listë të pritjes.

Të hyrat nga lejet ndërtimore : 116 559.01 euro
 Të hyrat nga legalizimi I objektev: 10 168.08 euro

T O T A L 126 727.09 EURO

Andaj mbi bazën e gjithë asaj që u cek më lartë si të hyra nga Drejtoria e Planifikim Urban , Pronë dhe Kadastër gjatë vitit 2021 janë realizuar si në vijim :

Sektori i Urbanizmit :	126 727.09 €
Sektorët - Gjeodezi Pronë dhe Kadastër :	57,705 €
Totali :	266975 €

Njësia e Burimeve Njerëzore

Duke u mbështetur në planifikimin e burimeve njerëzore si dhe planin e punës për vitin 2022 Njësia e Burimeve Njerëzore ka për qëllim zbatimin e planit të punës.

Plani i punës për vitin 2022 përmban bazën ligjore, strukturën organizative të Njesisë së Burimeve Njerëzore (NJBNJ), detyrat, përgjegjësit objektivat të cilat realizohen përmes aktiviteteve, indikatorëve, përgjegjësve dhe afateve kohore. Kjo mundëson zbatimin më të lehtë të këtij plani dhe monitorimin e tij.

Gjatë vitit /2022 kemi zhvilluar këto procedura :

1.Planifikimi i burimeve njerëzore për vitin 2023

Numri i vendeve të punës në administratën komunale të planifikuar me buxhet për vitin 2022 në Komunën e Obiliqit është 148.

Komuna e Obiliqit është komunë multi-etnike e cila përbëhet nga : shqiptarët, serbet , boshnjakët, romët etj.

Numri aktual i punëtorëve në administratën komunale është 135 prej tyre 69 femra dhe 66 meshkuj.

Nëpunës në shërbimin civil janë gjithsej 116, prej tyre femra 63, meshkuj 53 . Shqiptar në shërbim civil janë 104 prej tyre femra 55, meshkuj 49 . Serb në shërbimin civil janë 10 prej tyre femra 7 , meshkuj 3 . Boshnjak në shërbimin civil 1-femer .Rom në shërbimin civil 1-mashkuj.

Të zgjedhur politik janë 14 prej tyre femra 5, meshkuj 9 / shqiptar 13, serb 1.

Nëpunës i kabinetit të Kryetarit të Komunës janë 5 prej tyre femra 1, meshkuj 4/ shqiptar 5.

13 pozita të lira janë në procedurë të rekrutimit .

2.Rekrutim – Pranim nga jashtë :

- Zyrtar për kthim të qëndrueshëm e emëruar Labeara Mjeku.
- Zyrtar për shërbim sociale i emëruar Shaban Halimi.
- Zyrtar për arkiv , i emëruar Besart Berisha ,
- Zyrtar për shërbim me qytetar dy pozita të emëruar Visar Aliu dhe IbadeteHasani.
- Zyrtar për bibliotekë në procedurë
- Zyrtar për kthim të qëndrueshëm në procedurë.
- Zyrtar për buxhet dhe financa , në procedurë.
- Zyrtar administrativ, në procedurë.
- Zyrtar i lartë për menaxhimin e projekteve, në procedurë.

3.Rekrutime / Lëvizje brenda kategorisë :

- Zyrtar për gjendje civile / i emëruar Fitim Mjeku .
- Zyrtar për shërbim me qytetar, i emëruar Amir Hashani.
- Zyrtarë për taksë komunale , në procedurë.

4. Ngritje në detyrë

Udhëheqës i sektorit për siguri dhe emergjencë, në procedurë.

5. Emërimi i ekspertëve në procedurë të rekrutimit :

- Nexhmedin Krasniqi ekspert në procedurën e rekrutimit për një pozitë.
- Vjollca Dibra Ibrahim i ekspert në procedurën e rekrutimit për tri pozita .
- Milot Krasniqi ekspert në procedurën e rekrutimit për dy pozita .
- Vedat Bajrami ekspert në procedurën e rekrutimit për një pozitë .
- VeselUsajekspert në procedurën e rekrutimit për një pozitë .

6. Autorizim për zëvendësim

- Arta Alajkryerja e detyrave si Menaxhere e Prokurimit nga data 21.04.2022deri me dt.20.10.2022.
- Blerina Haziraj kryerja e detyrave si Menaxhere e Prokurimit nga data 24.12.2022 deri në caktimin e zyrtarit përgjegjës për prokurim (Marrëveshje mes AQP dhe Komunës) ,

7.Transferime të përkohshme
- 12 zyrtar për gjashtë muaj .

8.Transferim i përhershëm
- një transferim

9.Transferim për shkak të ristrukturimit
-12 zyrtar

10. Pensionim :

-Shaban Krasniqi i pensionuar me dt.21.03.2022.

-Ramadan Halimi i pensionuar me dt.21.04.2022.

-HamletCakolli i pensionuar me dt.25.08.2022.

- Bedrije Mjekiqi pensionimi parakohshëm me dt.01.02.2022 dhe arritja e pensionimit moshë 65 vite me dt. 23.12.2022,

Pagesë e një page me rastin e pensionimit për të gjithë të pensionuarit ..

11.Ndërprerje e marrëdhënies së punës /

- Vdekje e nëpunësit civil MersidaLimaj .

-Ndërprerje e punës me vetë dëshirë , Kaltrina Spahiu, RatomirRistic, Naim Shalaku .

12.Emërimet nga organi me i lartë administrativ :

-dymbëshjet (12) drejtor

- pesë (5) nëpunës të kabinetit

13.Ankesë e brendshme :

- Njëzet e një (21) ankesa të paraqitura në NJBNJ .

14Ankesa në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës

- pesëmbëdhjetë (15) ankesa në SKPM .

15.Vendime të SKPM /:

- pesë (5) ankesa të refuzuara

-pesë (5) ankesa të aprovuara

16.Komisioni Disiplinor :

-Gjashtë lëndë, katër lëndë të përfunduara , dy lëndë në procedurë.

17.Pushime :

- Janar / 25 zyrtar pushime vjetore, 6 zyrtar pushime mjekësorë , 7 zyrt.Covid 19.
- Shkurt/ 15 zyrtar pushime vjetore, 7 zyrtar pushime mjekësorë, 1 zyrtar covid .
- Mars/ 12 zyrtar pushime vjetore , dy zyrtar pushim mjekësorë .
- Prill / 18 zyrtar pushim vjetor, 4 zyrtar pushim mjekësorë .
- Maj / 19 zyrtar pushim vjetor, 7 zyrtar pushim mjekësorë.
- Qershor / 45 zyrtar pushim vjetore , 8 zyrtar pushim mjekësorë , 1 pushim rast vdekje .
- Kthim nga pushimi i lehonisë - dy zyrtare .
- Korrik / 24 zyrtar pushim vjetor, 4 zyrtar pushim mjekësorë , 7 zyrtar Covid 19.
- Gusht / 44 zyrtar pushim vjetor, 7 zyrtar pushim mjekësorë , 1 zyrtar pushim për martesë, 3 zyrtar Covid 19.
- Shator /25 zyrtar pushim vjetor, 9 zyrtar pushim mjekësor .
- Tetor / 10 zyrtar pushim vjetor, 7 zyrtar pushimmjekësorë .
- Nëntor / 9 zyrtar pushim vjetor, 10 zyrtar pushimmjekësorë, 1 zyrtar pushim pa pagesë.
- Dhjetor / 29 zyrtar pushim vjetor, 13 zyrtar pushim mjekësor , 2 zyrtar pushim pa pagesë.

18.Punë jashtë orarit dhe pagesa për punë jashtë orarit :

- Janar / tetë zyrtarë.
- Shkurt / tetë zyrtarë
- Mars / 16 zyrtarë.
- Prill / 16 zyrtarë.
- Maj / 32 zyrtarë
- Qershor / 35 zyrtarë .
- Korrik / 24 zyrtar
- Gusht / 22 zyrtar
- Shator /25 zyrtar
- Tetor / 21 zyrtar
- Nëntor / 53 zyrtar
- Dhjetor /54 zyrtar

19.Udhëtime zyrtare dhe pagesa të mëditjeve

- Nëntëmbëdhjetë (19) zyrtar

20.Pagesë për shpërblime jubilarë

- tre (3) zyrtar

21.**Listat e pagave** për administratë, shëndetësi dhe arsim / printimi nga sistemi i pagesave, nënshkrimi nga të gjithë të punësuarit, kontrollimi dhe barazimi me DBF për administratën komunale

22.Ndryshimet në lista të pagave .

- Janar / 68 formular për ndryshime .
- Shkurt /38 formular për ndryshime.
- Mars / 48 formular për ndryshime .
- Prill / 1 formular për ndryshime , 1 për largim, 16 retroaktiv dhe lista e deputetëve 25 anëtar.
- Maj / 1 formular për ndryshime, 2 punëtor i ri, 1 për largim, 19 retroaktiv dhe lista e deputetëve 41 anëtar, 1 transferim bankar .
- Qershor /2 formular për ndryshime, 1 punëtor i ri, 28 retroaktiv dhe lista e deputetëve 25 anëtar
- Korrik / 3 formular për ndryshime, 54 retroaktiv dhe lista e deputetëve 41 anëtar, 1 formular për punëtor të ri , 3 formular për transfer bankar, konfirmimi i mjeteve buxhetore .
- Gusht / 2 formular për ndryshime, 1 për largim, 30 formuar retroaktiv dhe lista e deputetëve 25 anëtar, konfirmimi i mjeteve buxhetore.
- Shator /1 formular për largim, 24 formuar retroaktiv , lista e deputetëve 25 anëtar, 1 formular për transfer bankar, konfirmimi i mjeteve buxhetore.
- Tetor / 1 formular për ndryshime, 37 retroaktiv dhe lista e deputetëve 41 anëtar, 2 formular për transfer bankar, konfirmimi i mjeteve buxhetore .
- Nëntor/ 2 formular për ndryshime, 53 formuar retroaktiv dhe lista e deputetëve 41 anëtar, 1 formular për punëtor të ri, konfirmimi i mjeteve buxhetore.
- Dhjetor /2 formular për largim, 59 formuar retroaktiv , lista e deputetëve 25 anëtar, 2 formular për punëtor të ri, konfirmimi i mjeteve buxhetore.

23.Evidentimi i pagesave në Administratën Tatimore :

- Shkurt / dy pagesa për mësimin jo formal.
- Mars/ katër pagesa , dy mësim jo formal, dy pagesa për ekspertë
- Prill / dy pagesa për mësimin jo formal, një pagesë për ekspertin .
- Maj / dy pagesa për mësimin jo formal.
- Korrik / dy pagesa për mësimin jo formal.
- Gusht / dy pagesa për mësimin jo formal.
- Tetor / dy pagesa për ekspertë .
- Nëntor /dy pagesa për ekspertë.
- Dhjetor / një pagesë për ekspertë.

24.Auditim nga auditori i jashtëm 07.10.2022 dorëzimi i dokumenteve :

Lista e rekrutimeve, lehonave , pensioneve, pushime pa pagës, Statuti i komunës, Rregullorja për organizimin e brendshëm, planifikimi i personelit , plani i trajnimeve.
lënda e konkursit për auditor të brendshëm, lista e pozitave të lira .

25.Auditim nga auditori i brendshëm nga data 02.12.2022 dorëzimi i dokumenteve :

- Planin e personelit Janar – Tetor 2022;
- Raportin/Listën e pranimeve te reja, avancimeve dhe transferimeve te nëpunësve civil Janar Tetor 2022;
- Raporti i ndalesave, shtesave dhe kompensimeve tjera përnëpunësit civil Janar – Tetor 2022;
- Raportin/Listën e nëpunësve civil qe administrojnë nga NjMBNj;
- Strukturën organizative (Organo gramini) te NjMBNj;
- Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve te punës,strukturën organizative (Organo gramini) e Komunës; dhe
- Përshkrimin apo diagramet e proceseve te punës se NjMBNj.

26.Vlerësimi vjetor për vitin 2022 / njoftimi për vlerësimin vjetor për të gjitha drejtoritë .

27.Njoftimi i zyrtarëve të lartë për deklarimin e pasurisë

Zyra ligjore

Shërbimet ligjore të ofruara:

-Këshilla juridike për,

-Kryesuesin e Kuvendit ,për të gjitha drejtoritë komunale ,auditorin e brendshëm,zyrën e personelit, përpilimin e akteve juridike, vendime,procedurat e shpronësimit, si dhe përpilimin e shkresave të ndryshme me kërkesën e kryetarit dhe drejtorive.

- Rregulloret dhe akte tjera komunale të aprovuara në Kuvend sipas propozimeve të drejtorive:
 - 1.Plani komunal për integritet 2023-2026 për komunën e Obiliqit
 - 2.Rregullore për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës në administratën komunale
 - 3.Rregullore për organizimin,funksionimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat vendbanimet dhe lagjet urbane në teritorin e komunës së Obiliqit
 - 4.rregullore për menagjimin e mbeturinave në komunën e obiliqit
 - 5.Rregullore për subvencionimin e energjisë elektrike për banorët e komunës së obiliqit
 - 6.Rregullore për tarifa ngarkesa dhe gjoha komuna
 - 7.programi trevjecar i banimit
 - 8.Rregullore për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimindhemirëmbajtjen etyre
 - 9.Rregullore për fillimindhembarimin e orarit tëpunës së bizneseve në komunën e Obiliqit
 - 10.Rregullore për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike

-Kontrata marrëveshje- -shqyrtimin e te gjitha kontratave dhe marrëveshjeve te ndryshme para nenskrimit nga ana e kryetarit te komunës me interes per komunën:

- 1.Marrëveshje zotimi për realizimin e projektit të ngrohjes diellore „SOLAR 4“KOSOVO
- 2.Marrëveshje për realizimin e koncertit për ditët e diaspores me AMC Corporacion SHPK
- 3.Memorandum bashkëpunimi në mes të komunes së Obiliqit dhe komunës së Lipjanit për dhurimin e pajisjeve mjeksore.

4.Memorandum i Mirëkuptimit midis Zyrës së Këshillit të Evropës në Prishtinë dhe Komunës për projektin ROMACTED 2023-2024;

5.Marrëveshje bashkëpunimi *ndërmjet* Universitetit “UkshinHoti” Prizren dhe komunës së Obiliqit

-Përcjelljen e ligjeve dhe udhëzimeve administrative përmes ueb faqeve të Kuvendit të Republikës Kosovës dhe Qeverisë.

-Këshilla për zbatimin e ligjeve të aprovuara nga Kuvendi i Republikës se Kosoves , njoftimin e drejtorive përgjegjëse per ligjet e reja , ndryshimin dhe amandamentimin e tyre .

-Këshilla për zbatimin e rregulloreve dhe udhëzimeve administrative të cilat vijnë nga niveli qendror-Qeveria

-Pjesmarrje ne takimet e rregullta të kolegjiut të zyrtarëve ligjor në kuadër të Asociacionit të Komunave të Rrepublicës së Kosovës si dhe takime të ndryshme në punën e komisioneve si:

- Rregulloren per sistematizimin e vendeve të punës
- Hartimin e planit për integritet
- Hartimin e kodit të mirësjelljes
- pjesmarrje në komisionin disiplinor
- pjesmarrje në takimet e rregullta të komitetit të auditimit
- hartimin e rregullores per menaxhimin e mbeturinave
- Hartim8in per subvencionimin e energjise elektrike
- Udheheqja e raportimit te performances se komunes gjatë tërë vitit

-Lëndët gjyqësore

Komuna e Obiliqit ka mbi **270 lëndë** në procedurë gjyqësore e disa nga to na përcillen edhe në vitet në vijim ,lëndët – kontestet janë të natyrave të ndryshme si ato pronësore , kompenzim dëmi,konteste të punës etj .

Z.ligjore në bashkëpunim me avokatin ka kryer mbi **250** veprime juridike duke përfshirë ,takimet me ekspert te fushave te ndryshme te caktuar nga ana e gjykates ne zyre dhe ekspertizat në teren ,shkresa,

ushtrimin e padive nga ana e komunes,përgjigje në padi, prapësime ,parashtresa të ndryshme për gjykatë si dhe pjesmarrje në seancat gjyqësore,sigurimin e provave nga ana e drejtorive përgjegjëse për secilën lëndë që i përket atyre dhe çështje tjera që kanë të bëjnë me të gjitha lëndët gjyqësore ne cilësinë e palës paditëse , të paditur si dhe në cilësinë e dëshmitarit.

-Poashtu komuna përmes z.Ligjore ka ushtruar edhe 14 padi për mosrealizimin e kontratave nga operator ekonomik të ndryshëm sipas kërkesës së zyrës së prokurimit përmes z.së kryetarit.

Zyra për Integrim Evropiane

Duke e ditur rëndësinë e procesit të integritimeve evropiane dhe fuqizimit të rrugëtimit të Kosovës drejt këtij procesi, si dhe me qëllim të harmonizimit të veprimeve dhe koordinimit të aktiviteteve ndërmjet Komunave, Ministrisë së Integritimeve Evropiane, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministrisë së Punëve të Brendshme kam kryer raportim të rregullt në tre mujorë, gjashtë mujor, nëntë mujor, një vjetorë si dhe sipas nevojës dhe kërkesës nga Ministrit e linjës raport mujor apo add-hoc raport në koordinim me Kryetarin e Komunës,

Zyra për Integrim Evropian në komunën e Obiliqit bashkëpunon ngushtë me Agjencinë për Integrim Evropian (AIE) për qëllime të bashkërendimit të aktiviteteve në kuadër të procesit të Integritimit Evropian.

Marre pjesë në takimet që organizohen çdo muaj në MAPL rreth të rejave në fushën e integritimeve evropiane,liberalizimin e vizave etj.